



Cikli i dytë i studimeve

“Ndikimi i investimeve publike në rritjen ekonomike”

Kandidati:

Shpresim Qamili

Mentor:

Prof.Asoc.Dr Hyrije Abazi-Alili

Dhjetor, 2019

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
OBJEKTIVAT E STUDIMIT	5
METODOLOGJIA E STUDIMIT	6
KAPITULLI I	6
1.1 Historiku i shkurtër i shtetit	6
1.1.1 Efektet pozitive të ndikimit të shtetit në ekonomi	7
1.1.2 Efektet negative të ndikimit të shtetit në ekonomi	9
1.1.3 Ndërveprimi i shtetit në një ekonomi globale	11
1.2 Mënyra e ndikimit të shtetit në rritjen ekonomike	12
1.2.1 Ndikimi i sistemit tatimor në sektorin privat.....	16
1.2.2 Ndikimi i shpenzimeve publike në sektorin privat	18
1.3 Roli i shtetit në ekonominë në tranzicion	20
KAPITULLI II.....	22
2.1 Shpenzimet publike në infrastrukturë dhe të ardhurat	22
2.1.1 Performanca e aktiviteteve publike dhe efektiviteti	25
2.1.2 Efienca e sektorit publik, mënyrat dhe faktorët	28
2.1.3 Indeksi i efiençës së sektorit publik	31
2.2 Investimet kapitale në infrastrukturë.....	36
2.3 Studime mbi vende të ndryshme	38
2.3.1 Studime të investimeve publike në vendet e zhvilluara	39
2.3.2 Studime të investimeve në vendet në zhvillim	43
KAPITULLI III.....	46
3.1 Analiza e sektorëve dhe të ardhurat buxhetore.....	46
3.1.1 Përshkrim i përgjithshëm i sektorëve.....	46
3.1.2 Analiza e sektorëve	48

3.2 Plani i Investimeve Publike në infrastrukturën rrugore të Maqedonisë ...	51
3.3 Shpronsimet / Koncesionet.....	56
3.4 Partneriteti Publik Privat	57
3.5 Dividendët ekonomik të zhvillimit të infrastrukturës	60
3.6 Çështje politikash dhe rekomandime	63
KAPITULLI IV	65
Ngritja e Hipotezave	65
4.1 Modeli linear (me konstantë).....	66
4.2 Modeli log-log.....	67
4.3 Modeli log-lin	68
4.4 Modeli lin-log	68
4.5 Modeli log-log (me restriksion)	69
4.6 Kurba e Filipsit (modeli reciprok)	70
4.7 Korelacioni	71

BE	Bashkimi European
IFI	International Financial Institution; Instituti Internacional i Financimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IP	Investimet Publike
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KP	Kapitali Publik
PPP	Partneriteti Publik Privat
CRI	Cumulative Reform Index
DEA	Data Envelopment Analzsis
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development
Eurostat	European Statistics
EU8	Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Slovaki, Slloveni
GE	Gouvernement Effectiveness
GFS	Government Finance Statistics
KE	Komuniteti European
OECD	Organizata për Koperim dhe Zhvillim Ekonomik
PSP	Public Sector Performance
PSE	Public Sector Efficiency
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PV	Political Stability and absence of Violence
ZBK	Zyra e Buxhetit të Kongresit

HYRJE

Që nga koha e shkatërrimit të sistemit të vjetër ish republikat filluan fazën e tranzicionit e cila do t'i çonte drejt ekonomisë së lirë të tregut. Ekonomia e centralizuar nuk do të funksiononte më dhe shteti do të duhej të aprovonte ligje të reja dhe një politikë monetare e fiskale që do ti përdorte si instrumenta për të mbajtur ekonominë në balans. Mirëpo pjesëmarrja e shtetit në kapital duhej të ishte e vogël me qëllim që tu lejonte bizneseve private hapesirë. Pra në fillim shteti ishte pronarë i të gjitha kompanive të mëdha dhe shumica e qytetarëve nuk kishin njohuri për pagesën e taksave edhe pse sistemi komunist në vendin tonë nuk ishte totalitar, kishte biznese private por ato ishin shumë pak dhe në nivel familjar. Taksat automatikisht shteti i llogariste dhe i merrte dhe punëtorët e mernin rrogën neto dhe nuk kishin shumë njohuri për to.

Periudha e tranzicionit do të fillonte dhe shteti dalngadalë duhej ti përshtatej ligjeve të ekonomisë së lirë të tregut. Përderisa vazhdonte faza e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore institucionet publike duhej të mbetnin nën administrimin e shtetit siç ishin: arsimimi, shëndetësia, infrastruktura, mbrojtja etj. Sa i përket ndikimit të rolit të shtetit në zhvillimin ekonomik dhe rëndësisë që kanë këto aktivitete në zhvillimin ekonomik të një vendi, kanë qenë gjithmonë objekt studimi nga ekonomistë të ndryshëm. Sektori publik apo aktiviteti shtetëror ka ndryshuar me kalimin e kohës, duke i'u përshtatur trajektore të zhvillimit ekonomik. Në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi edhe në vendet kapitaliste historikisht kanë ekzistuar dy pikëpamje të kundërta që u përkasin dy shkollave të ekonomisë. Secila nga këto pikëpamje argumenton anët pozitive të ndërhyrjes së madhe apo të vogël të shtetit, por në të vërtetë ndarja e tyre është e vështirë. Sot teoritë moderne të financës publike nuk pyeten nëse duhet të ndërhyj shteti apo jo, por kujdesen që kjo ndërhyrje të jetë sa më efiçente dhe të shërbejë për nxitjen e ekonomisë. Në vitet e 50-60 zhvillimi ekonomik paraqiste një sistem kompleks të transformimit social dhe politik të shoqërisë. Ndërsa vitet e 80-90 ekonomistët të cilët merreshin me zhvillimin kombëtar erdhën në përfundim se zhvillimi ishte çështje e drejtpërdrejtë e politikës kombëtare. Ndërmjet këtyre viteve u bë ristrukturimi i sektorit publik për: uljen e efiçencës në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike, alokimin e duhur të shpenzimeve në sektorët prioritarë dhe produktiv, rritjen e efiçencës së sistemit tatimor, ndryshimin e raportit sektor publik - sektor privat duke lehtësuar nivelet e larta të deficitit dhe borxhit publik, rritjen e cilësisë së institucioneve dhe të qeverisjes, etj, këto vazhdojnë të jenë objekt studimi për shumë ekonomistë. Sipas **Heinz Handler**, tri lloje të politikave janë në dispozicion për qeverinë për arritjen e qëllimeve: **shpenzimet publike**, **tatimet** dhe **përshtatja e kornizës gjenerale në të cilën do të inkorporohen vendimet dhe veprimet e agjentëve ekonomik**.¹

1. Heinz Handler, Andreas Knabe, Bertrand Koebel, Margarit Schratzenstaller, Sven WeHke, 2005, WIFO "The Impact of Public Budgets on Overall Productivity"

Ndikimi i sektorit publik në ekonomi jep një alternativë të veçantë edhe në vendet në tranzicion. Roli i shtetit në këtë është i dyfishtë sepse ndihmon në stimulimin e investimeve private me krijimin e kushteve nga ana e shtetit dhe gjithashtu shërben për ecjen përpara të reformave gjithpërfshirëse ekonomike për të mos ngecur pas sistemi i tranzicionit.

Kur bëhet fjalë për investime publike qeveritë duhet të ndërthurin politika fiskale për financimin e këtyre investimeve. Pra këtu lind dilema se cilat nga aktivitetet konkurruese duhet të fitoj më shumë investime, a duhet investuar më shumë në kapitalin human pra në arsim, a duhet investuar më shumë në shëndetesi apo ndoshta në infrastruktur që të mos dekurajohen bizneset private. Këtu gjithmonë ka dilemë edhe në qarqet e mëdha akademike.

Ky punim si objekt studimi do të ketë ndikimin e sektorit publik në nxitjen e ekonomisë në kushtet e krizave në vendet e zhvilluara kapitaliste, si dhe ecurinë dhe ndërhyrjen e shtetit në kohën e tranzicionit për ti dhënë një shtytje ekonomisë së Republikës së Maqedonisë. Do të shohim cili ka qenë kontributi i sektorit publik në zhvillimin ekonomik duke u përqëndruar tek rritja ekonomike.

OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Ky punim po realizon rolin e shtetit në rritjen ekonomike duke e marrë si bazë përfundimin e procesit të tranzicionit në vendin tonë dhe integrimi në strukturat e Bashkimit Europian. Duke u nisur nga ky parim do të përmendim disa nga objektivat që synojmë të arrijmë janë:

- Pikëpamjet teorike sa i përket ndikimit të shtetit në ekonomi, që të mund të shohim cilët janë anët negative dhe cilët janë ato pozitive nga kjo ndërhyrje.
- Vlerësimi i rolit të shtetit në ekonominë në tranzicion duke parë reformat në sektorin publik dhe ato ekonomike.
- Zhvillimi ekonomik duke u arritur në sajë të reformave politike.
- Matjen e performancës dhe efikasitetit të sektorit publik që është një tjetër instrument i cili ndikon dukshëm në cilësinë e shërbimeve dhe të mirave që sektori publik ofron, gjithashtu vlerëson prioritetet që vendos qeveria dhe jep një krahasim të kostove që mbartin qytetarët kundrejt përfitimeve të marra nga aktiviteti i shtetit.
- Analizën e politikës së shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore duke parë përparësitë dhe ngecjet dhe duke pëcaktuar sfidat e politikës fiskale në arritjen e një optimumi fiskal

- Analiza empirike e impaktit të madhësis së shpenzimeve publike në rritjen ekonomike.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Si metoda kërkimi të këtij punimi është përdorur një literaturë e gjerë e cila përbëhet nga materiale studimi të autorëve të huaj, rajonal dhe vendas. Materialet e studimit janë marr nga studiues të huaj dhe rajonal gjithashtu janë përdorur faqet e internetit si dhe kemi përdorur edhe faqet zyrtare të institucioneve të rendësishme siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, OECD, etj.

Fillimisht kemi përdorur historikun dhe debatet e shumta të ekonomistëve të dy shekujve paraprak në lidhje me ndikimin e Investimeve Publike në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Më pas kemi marrë shmbuj të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si dhe përvojave të vendeve të ndryshme në Investimet Publike. Së fundmi jemi koncentruar në të dhënat statistikore të Ministrisë së Financave dhe institucioneve statistikore në lidhje me nivelin e Investimeve Publike në Republikën e Maqedonisë gjithnjë duke e krahasuar me vendet fqinje të rajonit.

Si përfundim kemi përdorur programin STATA12 për të ardhur deri tek rezultatet konkrete dhe për të argumentuar impaktin pozitiv të Investimeve Publike në vendin tonë. Kapitulli katërt kryesisht i kushtohet rezultateve dhe komentimit të tyre në të cilin janë përdorur: modeli linear, log-log, log-lin, lin log, kurba e Filipsit dhe korelacioni. Çdo model e ka spjegimin e vet të qartë dhe të kuptueshëm.

KAPITULLI I

1.1 Historiku i shkurter i shtetit

Zhvillimi i një shteti mvaret nga stadi i ekonomisë së tij. Të gjithë përpjekjet e ekonomistëve në të gjitha kohërat janë munduar që të japin një teori sa më të përafërt që ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi. Mirëpo kjo nuk është e mundur pa një stabilitet politik dhe pa ligje të mirëfillta të përcaktuara që do ti mundësonin ekonomisë së lirë te tregut një zhvillim. Tranzicioni në vendin tonë nuk pati shumë sukses edhe pse u bë disi mirëpo ato pak ndërmarrje që mbetën ende në pronë të shtetit janë joefiçente. Duke e krahasuar me vendet e bashkimit European dhe sipas analizave të FMN-së vendet e ballkanit ende nuk kanë arritur ti dalin krizës së 2000-shit ku shumë vende përëndimore dolën nga kriza. Këtu që nga 2000-ja zhvillimi ka qenë i vogël ndërsa emigrimi për tek shtetet e zhvilluara i madh. Sipas

analizave të FMN-së pothuajse nuk ekziston konkurenca ndërmjet ndërmarrjeve shtetërore e private.

Përpara se të analizojmë zhvillimin ekonomik dhe të konstatojmë se cila pjesë ndikon më shumë, a është shëndetësia, zhvillimi arsimor apo investimet publike ne do të fokusohemi në studimet e deritashme. Gjithsesi që edhe arsimi edhe shëndetësia e kanë rolin e vet në zhvillimin ekonomik kështu që duhet parë se cila nga këto ka impakt më të madh në nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Neve do të drejtohem në studimin e shkollave **Kejnsianiste** e cila mendonte se **rritja ekonomike ndodh e para dhe më pas kjo shkakton në rritjen e investimeve publike**. Dhe shkolla **Neo-klasike** e cila e **sheh infrastrukturën si faktor të prodhimit dhe trajtohet njësoj si forca punëtore dhe kapitali**. Qëllimi i studimit tonë është të testojmë ndikimin që kanë investimet publike në rritjen ekonomike dhe a ndikojnë në rritjen e mirëqenies së popullësisë. Kur u konstatua nga shumë shkencëtarë të ekonomisë se është mirë të ketë ndikim shteti në ekonomi atëherë ato u ndanë në dy grupe të mendimit. **Grupi i parë** ishte ai i cili mendonte se duhej të kishte një ndërhyrje minimale të shtetit në ekonomi dhe **Grupi i dytë** mendonte se duhej të kishte një ndërhyrje më të gjerë të shtetit në ekonomi. Pra shekulli i XIX ndikohet më së shumti nga pikëpamja e ndikimit të vogël të shtetit ndërsa shekullin e XX do ta karakterizojë mendimi i ndikimit më të gjerë të shtetit.

1.1.1. Efektet pozitive të ndikimit të shtetit në ekonomi

Rezultate pozitive të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi do na japin faktet që ka marrëveshje të cilat nuk mund të bëhen në mënyrë private dhe është e patjetërsuashme ndërhyrja e shtetit për të ndërtuar rregullat e tregut. Disa nga këto ndërhyrje pozitive të shteti në ekonomi radhiten:

- E drejta e pronësisë duhet të mbrohet me ligj dhe duhet të ketë institucione të cilat e mbrojnë këtë të drejtë.
- Shteti duhet të ndërtojë konkurrencë lojale dhe ta luftojë monopolin ose të kontrollojë atë me ligje përkatëse duke përmirësuar infrastrukturën dhe adoptuar kushte për konkurrencë duke reduktuar koston e trasaksioneve.
- Shteti duhet të siguroj stabilitet makroekonomik dhe të ndihmojë në shpërndarjen e të ardhurave.
- Shteti duhet të ofrojë shërbime publike dhe të përballet me rastet e jashtëzakonshme të cilat nuk arrihen me marrveshje private.

Një mënyrë të mirë të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi na jep **(Musgrave Stiglitz 2000)**, i cili këto aktivitete i ka klasifikuar në tre linja kryesore: **linja stabilizuese** që ka më tepër karakter makroekonomik për të ndikuar në qëndrueshmërinë dhe ecurinë e zhvillimit ekonomik të një vëndi, **linja e shpërndarjes së burimeve** e cila kryesisht kontrollohet dhe ndikohet nëpërmjet politikës së taksave dhe shpenzimeve dhe është një nga rolet përcaktuese të shtetit në ekonomi, dhe **linja rishpërndarëse** që ka të bëjë me mënyrën sesi ndahen

mallrat dhe shërbimet në një ekonomi duke patur parasysh kriterin e drejtësisë dhe efikasitetit në shpërndarje.

Historikisht pas Luftës së Parë Botërore por më së shumti pas Luftës së Dytë Botërore filloi ndërhyrja e madhe e shtetit në ekonomi kur u paraqitën disbalanca të mëdha në shoqëri që jepte linja të varfërisë dhe pasurisë së skajshme vende vende. Atëherë u paraqitën programe të asistencës sociale, fondet pensionale, pagesa për të papunët dhe efektet rishpërndarëse. Shteti në këtë rast i dyfishoi shpenzimet si një program për balancimin e shoqërisë dhe sigurimin e ekonomisë nga ndonjë krizë e papritur. Pothuaj të gjitha vendet e Evropës i kishin dyfishuar shpenzimet qeveritare pas Luftës së Dytë Botërore. Gjithashtu ndërhyrje tjetër e domosdoshme ishte ndërtimi i projekteve të mëdha të cilat investime firmat private nuk mund ti bënin për shkak të kostove të mëdha dhe mungesës së kuadrove të specializuara të cilat vetëm shteti mund ti siguronte.

Që prej vitit 1990 (**Tanzi, 1997**) shtetet klasifikohen për masën e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, nëpërmjet raportit të shpenzimeve qeveritare ndaj produktit të brendshëm bruto, duke u ndarë në tre grupe; qeveri të madhe me një nivel shpenzimesh mbi 50 përqind të PBB, qeveri mesatare me një nivel shpenzimesh nga 40 – 50 përqind të PBB dhe qeveri të vogla me një nivel shpenzimesh më pak se 40 përqind e PBB.

Tabela 1 Shpenzimet qeveritare si përqindje e GDP, 1920 – 2009 për vëndet kryesore të BE, SHBA-n dhe Japoninë dhe Zelandën e Re

	1920	1937	1960	1970	1980	1985	1990	1995	2000	2004	2009
Austri	14,6	20,6	30,7	37,9	47,2	50,2	49,6	57,2	52,3	50,7	52,3
Belgjikë	22,1	21,8	30,3	40,8	56,1	59,3	52,9	52,8	49,2	49,5	54,2
Danimarkë				40,8	53,1	56,3	56,1	60,3	54,1	55	58,5
Finlandë				29,9	38,7	44,3	46	49,6	49,1	50,4	56
Francë	27,6	29	34,6	37,1	45,4	52	49,7	55,2	52,5	54,5	56
Gjermani	25,1	34,1	32,4	37,7	47,1	46	44,1	49,6	48,2	47,5	47,5
Itali	22,5	24,5	30,1	32,6	43	51,5	53,8	53,4	48	48,4	51,9
Hollandë	13,5	19	33,7	40,1	54,7	56,3	53	51,4	46	48	51,4
Luksemburg				28,9	48,4	44,4		45,5	38,5	46	42,2
Spanjë	8,3	13,2	18,8	20,7	31,5	40,4	42,6	45	40	40,5	45,8
Suedi	10,9	16,5	31	42,1	60	62,9	58,5	67,7	57,4	57	54,9
Zelanda e Re	24,6	25,3	26,9		38,1	39,8	41,3	34,7	36,2	34,2	54,7
Britani e Madhe	26,2	30	32,2	36,9	43,2	44,3	39,2	44,5	39,8	43,6	51,6
SHBA	12,1	19,7	27	31,7	33,1	35,7	35,5	35	32,5	33,8	
Japoni	14,8	25,4	17,5	18,5	31,2	31,4	31,1	36,9	40,9	38,6	

Burimi: AMECO² Database, Eurostat

Duke parë tabelën 1 vërejmë se çdo vit rriten shpenzimet qeveritare mirëpo nëse e marrim dhe analizojmë këtë faktor si një studim në inkubator do të marrim rezultate të gabuara. Me gjithë këtë përpjekje pozitive ka pasur faktor që e kanë renduar rritjen e shpejtë, faktor të cilët vijnë nga vetë proceset politike, burokracia shtetërore e cila ndërmjet administratës së pareformuar minon proceset e investimeve publike duke i ngadalësuar ato dhe duke ia rritur koston atyre.

Qendër e debateve akademike ka qënë të paktën dy dekadat e fundit ndikimi i investimeve publike në infrastrukturë. Kushtu për ngecje të zhvillimit ekonomik në disa shtete nuk është marrë infrastruktura, mirëpo në disa tjera dështimi për të arritur rritjen e nevojshme i është atribuar pa-mjaftueshmërisë së infrastrukturës. Por në kushtet e një krize ekonomike, ku sektori privat redukton aktivitetin e tij, faktori shtet është ai që stimulon ekonominë të reagoj dhe të zhvillohet. Investimet publike kapitale janë ato të cilat mbajnë balansin e ekonomisë nga një ngecje duke intervenuar dhe shpëtuar ekonominë dhe duke i dhënë shtytje që të vazhdojë.

Vlen të përmendet ndikimi social që kanë investimet publike në infrastrukturë në ngritjen e vetëdijes qytetare, ngritjen e mirëqenies së tyre, ngritjen e vlerës së kapitalit privat kur ka një infrastrukturë të zhvilluar dhe fleksibile për qarkullim, redukton shpenzimet e transportit dhe të kohës. Fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i këtij shekulli përdoren formula matematikore kur ndërtohet infrastruktura për të parashikuar numrin e rritjes së popullatës dhe mjeteve transportuese për të llogaritur se sa vite do të kenë kapacitet funksional rrugët dhe kur do të duhet të riparohen dhe të rindërtohen. Pra analiza makroekonomike moderne e sheh infrastrukturën si damarët e një organizmi të cilat duhet të jenë funksional për të qënë vital ekonomia.

1.1.2. Efektet negative të ndikimit të shtetit në ekonomi

Kur nuk kemi interes të ndërhyrjes së kapitalit privat në investime në të cilat në sferën e tyre të interesit ato nuk shohin përfitim atëherë paraqitet nevoja e ndërhyrjes së shtetit. Këto ndërhyrje i kanë edhe kritikët e vet të cilët mendojnë se ndikimi i investimeve mbi produktivitetin është mbivlerësu, kthimi i investimeve është ende i paqartë, rrit borxhin etj. Që nga vitet e 80 disa shtete filluan një periudhë tranzicioni ku u bë i nevojshëm reformimi i sektorit publik. Ja shkaqet e paraqitjes së këtyre reformave:

1. U pa që me shpenzime të larta qeveritare veç sa vinte e shtohet borxhi publik, rritej defiçiti buxhetor, rriteshin taksat dhe nuk kishte studime të qarta se këto investime të larta do të mund të kishin efektivitetin e tyre.
2. Shkaku i largimit të kapitalit dhe të forces intelektuale e punëtore nga vendi shteti u detyrua që të bëjë reforma në sektorin publik dhe të ul taksat.
3. Sistemet joefektive shtetërore të pensioneve dhe sistemet e shendetësisë do të ndryshoheshin me pjesërisht fonde private të sigurimit të cilat një pjesë do të riinvestonin në industri.

4. Gjithashtu shumica e shteteve ishin të detyruara të ndërmerrnin diçka sepse u praqiten shtete të cilat ishin pionere të reformave publike siç ishte Zelanda e Re dhe Kili dhe në të cilat kishte pasur sukses.

Edhe në Shtetet e Bashkuara që nga vitet 50 – 60-ta teoria e **Xhon Keneth Galbrath-it** (John Kenneth Galbraith) e cila teori ishte mbi balancën sociale e titulluar **“Shoqëria e Pasur”** nuk u morr parasush. Megjithatë **David Ashauer** (David Aschauer) doli me mendimin se investimet kapitale publike jo vetëm që jepnin efekte pozitive në produktivitetin privat por edhe në output. Ashauer gjithashtu pohonte se shpenzimet shtesë në kapitalin publik do të rritnin outputin e firmave private për 1 ½. aq sa do të rritet një dollar ekuivalent në kapitalin e vetë firmave aksionere.

Zyra e Buxhetit të Kongresit e hodhi poshtë këtë pohim të Ashauerit sepse të dhënat statistikore nuk ishin të mjaftueshme dhe bindëse. ZBK vërejti se hulumtimet e tjera empirike, duke përfshirë studimet kosto-përfitim zbuluan se prodhimi privat ishte më i përgjegjshëm ndaj investimeve në kapital privat sesa ndaj investimeve në kapital publik. Pati edhe disa studime të tjera në lidhje me pohimet e Ashauer-it mirëpo disa nga studimet zbuluan se efektet e investimeve publike në rritjen ekonomike janë më të vogla se sa deklaronte Ashaueri. **Alicia Munell** (Alicia Munnell, 1990) ish punëtore e Bankës Federale të Bostonit u përpoq me një qasje të ndryshme statistikore për matjen e produktivitetit të shpenzimeve qeveritare. Ajo përdori vlerësimet e produktit shtetëror bruto dhe inputet private të kapitalit për të zhvilluar vlerësimet e rezultateve të kapitalit publik për 48 shtete gjatë periudhës 1970-86. Më pas, ajo përdori të dhënat shtet për shtet për të vlerësuar funksionet e prodhimit, duke konkluduar se dëshmitë duken të mëdha se kapitali publik ka një ndikim pozitiv në prodhimin privat, investimet dhe punësim.

Mirëpo vlerësimet e Munellit ishin më të vogla se ato të bëra nga Ashauer. **Hulten** (1990) vërejti se gjetjet e Munell-it të efekteve më të vogla relative ishin në përputhje me të tjera studime që analizuan të dhënat e shtetit, por gjetjet e saj ndryshonin ndjeshëm nga rezultatet e studimeve që bazoheshin në seritë kohore. **ZBK**(1991) në përmbledhjen e rezultateve të studimeve kosto përfitim, vuri në dukje se ka patur pak mbështetje për pikëpamjen që rritjet në të gjitha programet e kapitalit publik kanë efekte të jashtëzakonshme në prodhimin ekonomik. Përkundrazi ata konkluduan se “analiza kosto-përfitim ka një mendim mjaft të qëndrueshëm të kthimeve të larta për ruajtjen e stokut ekzistues të infrastrukturës fizike, dhe për këtë duke zgjeruar kapacitetet e trafikut dhe autostradës së mbingarkuar urbane si dhe zgjerimin e pistës së komunikacionit ajror”.

Nga kjo nuk mund të vijmë në konkludim që për shkak të stimulit të rritjes ekonomike qeveria do të vazhdonte me investime publike tejmase. Përkundrazi çdo projekt duhet të qëndroj mbi meritat e veta dhe të jetë në gjendje të përballojë analizat e kosto-përfitimit. Megjithatë do të duhej që investimet publike të kishin një impakt më të madh në nxitjen ekonomike.(William E.Cullison).

Shohim se sa e rëndë është bërja e një studimi ku rezultatet e të cilit do të na jepnin shifra të sakta të humbjes apo fitimit kur bëhet fjalë për investime publike të cilat prekin fushën e makroekonomisë dhe të cilat nuk mund të studiohen si fenomen i veçant duke i veçuar faktorët e tjerë që ndikojnë në to. Edhe projektet e mëdha infrastrukturore në Republikën e Maqedonisë kanë po të njejtën situatë të ngecjeve dhe shpenzimeve të mëdha. Si faktor kryesor është korrupsioni, vonesa në disa sektorë të punës sidomos kur ka përmirësime të pjesës së projektit të cilat marrin kohë dhe i shtyjnë afatet e fazave të punës dhe me atë rrisin shpenzimet e nënkontraktorëve të cilat shpenzime kompenzohen nga shteti më vonë, probleme në eksproprijim të pronave ku paraqiten disa raste gjyqësore si dhe problemet e dislokimit të linjave të elektrikut dhe telekomunikimit.

1.1.3. Ndërveprimi i shtetit në një ekonomi globale

Kushtet e tanishme të një ekonomie të vendeve që iu nënshtuan tranzicionit mvaren nga mënyra e reformave fiskale dhe institucionale. Pyetjet të cilat hulumtuesit e ndryshëm i kanë parashtruar në hulumtimet e tyre empirike sa i përket rritjes ekonomike në vendet në tranzicion kanë të bëjnë kryesisht në njohjen e faktorëve kryesor të këndjelljes dhe rritjes së aktivitetit ekonomik dhe në përcaktimin e rëndësisë së tyre relative. Më së shpeshti në analizat empirike janë përdorur analiza e regresionit, të shoqëruara me seritë kohore dhe me specifikacionet të cilat vendosin dinamikën e prodhimit (GDP-së) në raport me variablat shpjeguese duke përfshirë kushtet fillestare, reformat strukturore dhe politikën makroekonomike. Kështu **Sachs (1996)** ndër të parët ka vërtetuar se zhvillimi ekonomik në vitet 1989-1995, ka qenë në korelacion të shprehur pozitiv me sukseshmërinë e reformave të zhvilluara. **De Melo, Denizer dhe Gelb (1996)**, **Selowsky dhe Martin (1997)** më vonë kanë vërtetuar këto rezultatet përmes të ashtuquajturit **“indeks i liberalizimit”** dhe kanë tërhequr vëmendjen se nëpërmjet intenzitetit të reformave të zbatuara, ndikim shumë të madh në rimëkëmbjen e rritjes ekonomike në vendet në tranzicion kanë rrjedha e pandërprerë e reformave si dhe niveli i stabilitetit makroekonomik. (Elmi Aziri).

Për ta njohur ndërveprimin e shtetit tonë në tregun global duhet që të shohim stadin dhe gjendjen e organizimit dhe të zhvillimit tonë ekonomik dhe vendeve të rajonit në përgjithësi. Një treg privat dhe eficient do të thotë që shteti nuk ka pse ndërhy. Zhvillimet teknologjike në rritje më shumë e rrisin shërbimin dhe pamvarësin e sektorit privat, kështu që për dallim nga shekujt paraprak shteti nuk ka nevojë për ti ofruar shumë shërbime sektorit privat. Ajo që duhet të bëjë shteti për të siguruar një ekonomi stabile është kontrolli i defiçitit buxhetor, politikë fiskale stabile, kurs fiks të disa valutave elemente që u ndihmojnë shteteve në tranzicion. Zhvillimi i përgjithshëm rajonal ndikoi në një masë në ngritjen ekonomike edhe të vendit tonë. Si shembull mund të marrim zhvillimin e porteve detare në Shqipëri dhe Bullgari. Kjo ndikoi që grekët të mos jenë më monopol dhe uli çmimet edhe të porteve greke gjë që të gjitha mallrat e importuara vijnë me një çmim më të lirë. (Tabela 2) në fund të punimit tregon hulumtimin e zhvillimit rajonal nga **Banka Europiane për Zhvillim**

dhe Rekonstrukcion. Globalizimi ndihmoi në zgjerimin e tregjeve përtej kufijëve kombëtar dhe me të rriti edhe të ardhurat e shtetit duke ndikuar pozitivisht në rritjen e PBB, uljen e borxhit si rezultat i ngritjes së eksporteve ejt. Mirëpo nuk do të thotë që globalizimi është perfekt, anët negative janë: transferimi i kapitaleve nga vendet me taksa më të larta tek vendet me taksa më të ulëta, blerjet jasht, paraja elektronike të cilat e vënë shtetin në një pozit më të disfavorshme.

1.2 Mënyra e ndikimit të shtetit në rritjen ekonomike

Tema e diskutimeve dhe debateve të shumta në qarqet akademike koncentrohet në shpenzimet publike të cilat kanë efekt në rritjen ekonomike. Kohët e fundit janë bërë shumë studime empirike dhe në to kemi rezultate të ndryshme. Nga njëra anë disa studime dalin me rezultate të cilat na thonë që investimet publike do të ishte mirë të bëheshin në projekte afatshkurtëra dhe jo në kontinuitet dhe nga ana tjetër studime që mbështesin dhe argumentojnë investimet afatgjata qeveritare.


Kur përmendim investimet afatgjata kemi shembullin e ish Konfederatës Jugosllave e cila në vitet e 70 për nga infrastruktura ishte shumë larg vendeve perëndimore. Infrastruktura ishte e vjetër dhe jo gjithkund e njëjtë. Për ta përmbushur hendekun e lartë infrastrukturor ato ndërthurën një projekt ambicioz shumëvjeçar. Në periudhën e 1973-79 kapitali i investimeve fikse u rrit në 8,2 përqind në vit. Ky program i një ambicie të stërmadhe implikoi një defiçit të madh tregëtar i cili në masë të madhe ishte i financuar nga huazimet e jashtme i cili i dha një pamundësi në kursime. (Zizmond 1992; Babic dhe Primorac 1986).

Kjo rezultoi në akumulimin e borxhit të jashtëm dhe në shterimin e rezervave devizore. Ristrukturimi fiskal filloi më 1980-90 e cila rezultoi në shtukrtim të shpenzimeve kapitale në një mesatare vjetore prej 5 përqind. Pas 1990 shpërthyen luftrat ballkanike dhe pas ndarjes do të vazhdojë financimi i pjesërishëm nga organizatat financiare perëndimore.


Më poshtë kemi Rezervat Publike të Kapitalit 2000-2015

Grafiku 1.1 Fondi i Kapitalit Publik

1. Fondi i Kapitalit Publik, 2000 - 15
(PPP 2011 dollarë për kokë banor)



2. Fondi i Kapitalit Publik, 2015
(PPP 2011 dollarë për kokë banor)



Sources: IMF, FAD database; and IMF staff calculations.

Note: CEE = Central Eastern Europe; CIS = Commonwealth of Independent States; SEE-EU = Southeast Europe EU members; SEE-XEU = Southeast Europe non-EU members.

Masat kthyese të ndërmarra nga shumica e vendeve të OECD-së nuk u treguan aq të forta për ta kthyer ekonominë në trajektoren e vet në vitin 2000. Kërkesa e dobët, investimi i nënshtruar, inflacioni i ulët dhe produktiviteti i dobët ishin simptomat e ekonomisë dhe të mendoje vetëm për politikën monetare zor që bindej ndokush se mund ti jepte impulsin e rritjes. Normat e interesit ishin zero apo nën zero në shumicën e vendeve të zhvilluara dhe masa të pa zakonta siç ishin tërheqje e një sasive të masës monetare dhe normat negative të interesit mund të dëmtojnë kthimet dhe hapin rrugë për rritjen e anormaleve në tregjet financiare.

Normat e ulëta të interesit që i ofrojnë shumica e vendeve të OECD-së janë jashtëzakonisht të favorshme për huamarrje për shpenzimet publike. Këto kushte të favorshme janë më së miri të përdorura për ngrirjen e normave të ulëta të interesit që do të përdoren në kohë afatgjatë huazimi (OECD 2016).

Shpenzimet e bëra në edukatë dhe shëndetësi sjellin përfitime në kushte afatgjata. Veçanërisht infrastruktura është në nevojë dhe konsolidimi fiskal në vitet e fundit ia ka shtuar presionin kah ulja shpenzimeve publike. Në këto kushte investime publike shtesë mund të gjenerojnë norma të larta kthimi nëse politikat qeveritare mbajnë këtë trajektore investimi.

Pas këtyre kushteve Departmenti Ekonomik i vendeve të OECD-së sygjerronte një rritje në investimet publike për ta mbështetur kërkesën dhe punësimin në periudhë afatshkurtër për ti nxitur investimet private me qëllim që ta rrisi outputin

potencial në kohë afatgjatë. Megjithatë ende qëndron pyetja në lidhje me madhësinë e investimeve publike dhe kushtet afatgjata të kthimit të kapitalit publik të cilat determinojnë se si do të evoluon borxhi publik në lidhje me PBB në rast se rriten investimet publike. Objektivi është që të identifikohen kushtet ndër të cilat ngritja e investimeve publike të mund qëndrueshëm të ngrej rritjen pa i përkeqësuar financat publike.

Rezultatet stimuluese na sygjerojnë:

1. Ka hapsirë për një investim publik deficitar në $\frac{1}{2}$ përqind të PBB për një mesatare 3 – 4 vjet në vendet e OECD-së për pa e rritur borxhin në krahasim me normat e PBB në kushte mesatare.
2. Një investim i pandërprerë i $\frac{1}{2}$ përqind i PBB vlerësohet të çon në një output mesatar në kah më të gjatë nga 0,5 deri 2% në ekonomitë e zhvilluara.
3. Vendet ku niveli fillestar i kapitalit publik është i ulët ka të ngjarë të përfitojë më së shumti nga stimuli duke supozuar se investimet shtesë kanë një normë të lartë të kthimit të përshtatur ndaj riskut në këto ekonomi. Duke supozuar se të gjitha projektet e investimeve publike në një vend të caktuar kanë të njëjtat shkallë kthimi në margjinë, efekti mbi prodhimin do të ishte, mes ekonomive të mëdha të përparuara, mbi mesataren në Gjermani dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku vlerësohet gjendja e kapitalit publik të jetë relativisht i ulët. Nga ana tjetër, fitimet e prodhimit mund të jenë negative për Japoninë, duke reflektuar një kapital të madh fillestar të kapitalit publik dhe normat e ulëta dhe madje negative të kthimit në margjinë për kapitalin publik të definuar në mënyrë konvencionale.
4. Nëse dobësia e vazhdueshme e kërkesës gradualisht minon aftësinë prodhuese të ekonomisë, rasti për një stimul të udhëhequr nga investimet përforcohet, pasi stimulimi do të çonte në përfitime afatgjata më të forta në prodhim. Amplituda e këtyre fitimeve varet nga pozicioni fillestar në ciklin dhe, në një masë më të vogël, në shkallën e ngurtësisë së tregut të punës. Ata do të ishin veçanërisht të fortë për Italinë dhe Francën.
5. Veprimi kolektiv midis ekonomive të mëdha të avancuara për të ngritur investime publike me cilësi të lartë vlerësohet të sjellë fitime shtesë të prodhimit prej rreth 0.2 pikë përqindje mesatarisht pas një viti në ekonomitë në fjalë krahasuar me një skenar ku vendet veprojnë individualisht. Si pasojë, raporti i borxhit ndaj PBB-së gjithashtu do të binte më shumë në afat të shkurtër sesa ndryshe. Gjermania do të ishte, në mesin e ekonomive të mëdha të përparuara, vendi që përfiton më shumë nga veprimi kolektiv për të rritur investimet publike në lidhje me ndërmarrjen e investimeve shtesë vetë.
6. Kombinimi i një stimuli të drejtuar nga investimet me reformat strukturore të tregut të produkteve mund të çojë në një ndikim më të fortë rritjeje afatshkurtër dhe të nxjerrë në pah uljen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së. Në veçanti, reformat në shënjestër të fërkimeve që mbajnë prapa kërkesën për investime mund të ulin kostot e mundësive të investimit.

Lehtësimi i rregulloreve të tregut të produkteve sipas përmirësimit mesatar gjatë dy viteve në një vend tipik të OECD mund të shtojë rreth 0.3 pikë përqindjeje ndaj ndikimit të rritjes pas vitit të parë. Reduktimi i barrës rregullatore që rrjedh nga rregulloret anti-konkurruese të tregut të prodhimeve në sektorët në rrjedhën e sipërme do të kishte mesatarisht një ndikim të amplitudës së njëjtë dhe do të ishte veçanërisht e dobishme në Kanada, Francë dhe Itali.

7. Rritja e vazhdueshme e stokut të kapitalit publik dhe e prodhimit potencial zvogëlon raportin e borxhit publik ndaj PBB-së, ndërsa vlera rritet. Kështu zvogëlon rreziqet ndaj borxhit, pasi borxhi aktual ndaj PBB-së shkon më larg nga kufiri i paracaktuar i saj, sidomos në ekonomitë e vogla evropiane. (OECD 2016).

Këtu mund të shohim që ndikimi i shtetit në rritjen ekonomike përmes kapitalit publik nuk është i njëjtë dhe nuk jep rezultate të njëjta në të gjitha vendet, rast kemi Japonin ku një investim në kapitalin publik do të ishte negativ, poashtu edhe disa vende të industrializuara perëndimore do të kishin nese jo efekte negative efekte pozitive shumë të ulëta sa që do të pyesnin a ja vlen investimi.

Sa u përket vendeve të cilat janë në zhvillim, vendet e ish bllokut komunist të cilat kanë hyrë në fazën e tranzicionit, disa vendet në Amerikën Latine dhe gjetkë sigurisht që një investim i tillë do të sillte një fitim shtesë në kapitalin publik, do të nxiste investimet private dhe do të përshpejtonte zhvillimin e ekonomisë.

Krahasimi i bërë ndërmjet ish konfederatës Jugoslave me një investim 8,2% ku pastaj përmirësohet në 5% deri më 1990 dhe kriza botërore e 2000-së ku vërejmë analiza e shteteve perëndimore që çon në një investim deficitar publik prej $\frac{1}{2}$ (0,5%) të PBB na le të mendojmë që investimi publik me deficit të vogël është i shëndetshëm për të nxitur ekonominë, sigurisht nëse bëhet me norma të ulëta interesi.

Maqedonia ndër të tjera vitet e fundit përkrah sygjërimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës për Zhvillim dhe Kooperim dhe Organizatave të tjera perëndimore që masa shtytëse bazë e nxitjes së zhvillimit ekonomik do të ishte një infrastrukturë e mirë. Po shihet vitet e fundit që objektivi shtetëror është përmirësimi i infrastrukturës së vjetër dhe vende vende zëvendësimi i saj me autostrada. Që prej pavarësisë së Maqedonisë u ndërtua autostrada Tetovë – Shkup, tani po ndërtohen autostradat Miladinovci – Shtip dhe Kërçovë – Ohër.

Ndër të tjera në plan për ndërtim janë edhe rripi rrugor që lidh Strugën me Qafë Thanën i cili do përmirësonte aksin rrugor mes Maqedonisë dhe Shqipërisë. Poashtu është në plan edhe autostrada që lidh Ohër me Manastirin dhe autostrada që do të lidh Kërçovën me Gostivarin.

Kur të analizojmë më thellë mënyrën e ndërhyrjes së shtetit në rritjen ekonomike do të vërejmë disa instrumenta: krijimin e një mjedisi institucional i cili

krijon politika mbështetëse ndaj rritjes ekonomike, limitimi i ndërhyrjes së shtetit në funksionet bazë dhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve bazë për ekonominë, promovimi i rritjes së sektorit privat dhe përdorimi eficient i burimeve publike, financimi i aktiviteteve publike dhe rregullimi i sektorit privat nëpërmjet një sistemi tatimor të qëndrueshëm dhe eficient dhe mbështetja e stabilitetit ekonomik nëpërmjet politikave fiskale të qëndrueshme. Kur të gjithë këto instrumenta nëse përdoren me efikasitet do të japin efekt pozitiv të politikave qeveritare mbi variabla të rëndësishëm makroekonomik si puna, kapitali, kursimet, investimet dhe inovacioni, dhe ndikojnë në rritjen ekonomike. Ndërsa Financat Publike ndikojnë në rritjen ekonomike ndërmjet tre kanaleve kryesore: kuadrit institucional, sistemit tatimor, dhe nivelin e shpenzimeve.

1.2.1 Ndikimi i sistemit tatimor në sektorin privat

Efekti i taksave ndikon se çfarë rritje ekonomike do të ketë vendi. Ato bëjnë shpërndarjen e një pjese të burimeve nga sektori privat tek ai publik për rregullimin e sistemit shtetëror. Kur kemi rritje të normave tatimore automatikisht do të thotë që tkurren investimet e kapitalit fizik dhe atij human, poashtu redukton kthimin nga shpenzimet e kërkim-zhvillimit.

Në kushtet e sotme të globalizimit të tregjeve, normat e larta tatimore ndikojnë në uljen e rritjes ekonomike të vendit dhe kjo rezulton në zhvendosjen e kapitalit jashtë në shtetet me norma më të ulta tatimore. Taksat janë barrë e tepërt tatimore edhe pse mund të duken të domosdoshme, ato ndrydhn vendimarrjen private, krijojnë alokim të shtrembëruar të burimeve dhe krijojnë barrë të tepërt tatimore. Këto ndrydhje të shkaktuara nga taksimi reflektohen në funksionin ekonomik dhe ndikojnë në ngadalësimin e rritjes ekonomike. Sistemet tatimore të cilat nuk janë të hartuara me kujdes e shtrembërojnë efikasitetin ekonomik dhe shpërndajnë anomali nëse p.sh: marrin më shumë burime nga sektori privat dhe sigurojnë të ardhura në mënyrë joeficiente, rast kemi kur qeverisë i duhen para për borxhet rrit akcizat e karburanteve të cilën e kanë si shtyllë të tretë më me rëndësi të mbushjes së buxhetit.

Niveli i përgjithshëm i tatimeve reflekton zgjedhjen e shoqërisë ndaj madhësis së sektorit publik, kurse struktura e tatimeve përfaqëson më së shumti një instrument për të realizuar këtë zgjedhje. Qeveria duke i mbajtur të pandryshuara shërbimet publike mund të ndryshojë strukturën tatimore me qëllim të eliminimit të anomalive dhe efekteve negative.

Impakti i tatimeve në ekonomi është i gjerë si në vendimarrjen individuale ashtu edhe në atë sipërmarrëse.

Vendimarrja individuale:

- Në kapital human.- Ky kapital ka rëndësi të veçantë në ekonominë e sotme, për këtë ka trajnime të ndryshme, sholla të ndryshme me qëllim të avancimit

të tij. Tatimet ndikojnë negativisht në pakësimin e trajnimeve dhe shkollimit dhe e tkurrin këtë resurs.

- Kursimi.- Përbën atë pjesë të kapitalit i cili mbetet mbas përmbushjes së nevojave bazë fiziologjike. Rritja e tatimeve do ta pakësonte kursimin dhe firmat dhe kompanitë sipërmarrëse nuk do të mund të merrnin hua për investime, likuiditeti i bankave do të zvogëlohej etj.
- Oferta e punës.- Është oferta e orëve punë të ofruara për një vlerë të caktuar të pagës. Tatimet zvogëlojnë të ardhurat dhe venit interesin e kuadrove të kualifikuara për të ofruar shërbim. Këtu ndodh edhe largimi i kuadrove për tek shtetet e tjera.
- Aktiviteti sipërmarrës.- Është njëri ndër faktorët kryesor ekonomik i zhvillimit në të cilën si bizneset ekzistuese poashtu edhe ato të reja të cilat shoqërohen me përmirësim të teknikave prodhuese, cilësis dhe origjinalitetit të produkteve, forma më të mira të organizimit dhe drejtimit dhe nga gjitha këto përpjekje rritja e tatimeve këput shumë nga këto biznese dhe bën që në vend të shtimit të pakohen bizneset. Sidomos tatimet progresive të cilat më shumë ndikojnë sipërmarrjet e suksesshme sesa ato të pasuksesshme, dhe që nxisin bizneset për nënraportim të të ardhurave .
- Pabarazia.- Rritja e taksave jep më pak akses të varfërve në hua për investim në kapitalin human dhe atë fizik, me këtë uljet besimi dhe siguria në stabilitetin social.

Vendimarrja sipërmarrëse:

Në sektorët e bizneseve të mesme dhe të mëdha kontrollohen shumë variabla të cilët ndikojnë në rritjen ekonomike.

- Investimi në kapitalin fizik.- Pra investimi në kapitalin fizik do të bëhet deri në atë masë kur fitimi marxhinal e tejkalon koston marxhinale të investimit. Politikat tatimore që shpesh ndryshojnë apo janë të pa favorshme e pengojnë ndërmarrjen për të investuar dhe hapur vende të reja të punës.
- Investimet e huaja.- Sidomos në periudhën e tranzicionit kur shtetet të cilat janë në këtë periudhë do të duhej të bënin gjithçka për të përmirësuar politikën tatimore dhe për ta bërë vendin sa më atraktiv për investime.
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME).- Këto janë shtyllat e zhvillimit modern të cilat mundësojnë konkurimin , sipërmarrjen dhe inovacionin. Ky sektor zë një përqindje më të madhe në krahasim me biznesin e madh dhe taksat e pafavorshme do të çonin drejt falimentimit shumicën e këtyre bizneseve ose shpërnguljen në vendet tjera.
- Institucionet e tregut të punës.- Siç janë sindikatat të cilat mbrojnë të drejtat e punëtorit në proporcion me rritjen e taksave bëjnë presion për rritjen e rrogave çka rezulton në uljen e numrit të të punësuarve dhe ngadalësimin e rritjes ekonomike.

- Ndërmjetësit financiar.- Ndikojnë në shpërndarjen e resurseve ndërmjet kompanive dhe ndërmarrësve. Tatimet e favorshme do të ndikojnë që edhe ndërmjetësit të kenë kushte më të favorshme, të mbështesin më shumë sipërmarrës dhe të jenë më shumë likuide.

Me pak fjalë sistemi tatimor ndikon në të gjitha porët e aktivitetit civil dhe atij sipërmarrës. Po të futemi në detaj ka shumë për të thënë mirëpo kjo që cekëm ishte aq sa të shohim impaktin e tatimeve në investimet publike dhe dham një pasqyrim a i jep një shtytje, ngadalësim apo nuk ka efekt fare.

1.2.2 Ndikimi i shpenzimeve publike në sektorin privat


Mbledhja e fondeve për shpenzime publike ka një sfidë të madhe dhe mvaret nga stadi zhvillimor i vendit. Vëndet e vogëla kanë pak mundësi, dhe për projekte të mëdha u drejtohen huazimeve të jashtme sepse ja zënë frymën sektorit privat nëse do të absorbonin shumën e mëdha nga sektori publik.

Sigurisht për projekte të mëdha së pari duhet patur zhvillim ekonomik dhe variablat e një zhvillimi janë: inflacioni, rritja ekonomike dhe papunësia. Për ti mbajtur këto variabla në nivelet e duhura duhet shumë përpjekje. Politika fiskale është një faktor kyç që ndikon në stabilitetin ekonomik, mirëpo edhe defiqiti dhe borxhi publik i ulët janë oazat e shpëtimit për ekonomitë e disa vendeve. Defiqiti dhe borxhi publik i ulët ndikojnë që më shumë para të ketë në dispozicion për sektorin privat dhe me norma të favorshme interesi. Nëse nuk do të kishte huazime nga jashtë dhe për një periudhë kohe do të kishim shpenzime më të mëdha se të ardhura duke krijuar debalansim dhe rritje të borxhit publik. Kjo situatë do të ndikonte në uljen ekonomike pasi zvogëlohen iniciativat e investimit nga sektori privat si një kundërpeshë e taksave më të larta që mund të vendosen në të ardhmen.

Huazimet e jashtme janë më të favorshme në kohët e fundit fal globalizimit të ekonomive dhe kanë norma interesi më të ulëta se sa huazimet vendore. E keqja është që në ndërkohë nëse ndodh ndonjë ngritje interesi atëherë edhe borxhi i jashtëm do të rritet që d.m.th do rëndon projektin.

Sipas një studimi të Fondit Monetar Ndërkombëtar eurobondet janë më të favorshme dhe me kushte të ulëta interesi. Një pjesë të madhe të eurobondeve shfrytëzohen nga Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi dhe më pak nga Shqipëria.

Grafiku 1.2. Lëshimi i Eurobondit në Ballkanin Perëndimor



Duke patur kujdes nga burime të larmishme të financimit të cilat mund të përkeqësojnë gjendjen ngase nuk mund të menaxhohen mirë në raste ndryshimi normash. Në disa raste menaxhimi i kufizuar me borxhin paraqet rrezik të konsiderueshëm për shkak të sfidave të përdorimit siç duhet të Eurobondit, duke menaxhuar rreziqet e rifinancimit dhe duke siguruar kordinim të ngushtë ndërmjet politikave fiskale dhe monetare.

Bonot e diasporës mund të jenë të dobishme duke përfshirë remitancat. Mirëpo obligacionet e diasporës kërkojnë ekspertizë specifike, të jenë të dizajnuara dhe të tregtuara siç duhet, ekspertizë e cila mungon në rajon. Krahatur nga rajone tjera ndonëse të dobishme këto nuk mund të përdoren si burim primar i financimit.

Metoda më e mirë dhe më e favorshme e investimit të projekteve të mëdha sipas FMN-së është investimi IFI (International Financial Institution). IFI siguron një pjesë të konsiderueshme të financimit për projekte infrastrukturore me kosto të favorshme të interesit dhe me maturim më të gjatë. Sa u përket projekteve kapitale IFI është mjeti më i mirë gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e zgjedhjes së kujdesshme të projektit, përgatitjes, riorganizimit, proceset e mbrendëshme si dhe kanalizimin e kapitalit privat.

Mbështetja financiare dypalëshe mund të përfaqësojë një mundësi të rëndësishme, nëse menaxhohet me kujdes. Për shembull financimi kinez ofrohet zakonisht me shkallë të ndryshme të koncesioneve, dhe Azerbejdhanit, Gjermania dhe Rusia kanë financuar gjithashtu projekte në rajon. Megjithatë në vartësi të agjencisë donatore, financimi dypalësh mund të vijë me kërkesa më pak të rrepta për përzgjedhjen e projekteve, një bar i ulët për procedurat e prokurimit, më shumë përkushtim nga kontraktorët e vendeve të donacionit për shërbimet e ndërtimit dhe


inxhinerisë, dhe më pak vëmendje për konsideratat e qëndrueshmërisë së borxhit, kufizojnë ndikimin e përgjithsëm në ekonominë e vendit.

Kështu për të përfituar më së shumti nga mundësia për financimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës është e rëndësishme të sigurohet bashkëpunimi i ngushtë midis donatorëve bilateral, IFI-së dhe qeverisë si pjesë e një programi të kordinuar të investimeve publike, në varësi të përzgjedhjes rigoroze të projekteve, vlerësimeve dhe politikave të prokurimit.

Korniza infrastrukturore e Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë të luaj një rol të rëndësishëm në katalizimin e burimeve në dispozicion. Institucionet financiare dhe donatorët e përfshirë në kornizën Infrastrukturore të Ballkanit Perëndimor do të ishin të aftë të shfrytëzojnë deri 1,5 përqind të PBB-së rajonale në vit të financimit të jashtëm në pesë vitet e ardhëshme.

Grafiku 1.3. Financimi i Institucioneve Financiare Ndërkombëtare

Ballkani Perëndimor: Vlera Vjetore i IFN-ve (Huadhënie dhe Grante)
(Përqindja e PBB-së rajonale 2017)



Sources: EU and IFIs country documents; and IMF staff calculations.

¹Includes European Investment Bank and European Bank for Reconstruction and Development. IFIs = international financial institutions.

Edhe pse shuma në dispozicion mund të duket e madhe, disbursimet aktuale do të varen nga çdo vend progres në financimin e projektit, dhe përfshirë përgatitjen, përzgjedhjen, monitorimin dhe ekzekutimin. Megjithatë, edhe duke marrë përparim të shpejtë në të gjitha këto fronte, këto burime do të mbulojnë vetëm pjesërisht vlerën e vlerësuar të nevojave financiare për të mbyllur boshllëqet ekzistuese të infrastrukturës. Financime plotësuese të IFI-së dhe donatorëve do të nevojiten për financimin e projekteve të infrastrukturës në rajon. (FMN 2018)

1.3 Roli i shtetit në ekonominë në tranzicion

Tranzicioni ka qenë një sfidë për shumë shtete të cilat iu nënshtruan kësaj periudhe. Në fillim ajo u shoqërua me një shuarje drastike të disa ndërmarrjeve. Kjo ndodhi ngaqë ekonomia ishte e planifikuar dhe ndërmarrjet ndihmonin njëra tjetrën. Pas kësaj shumë ndërmarrje nuk mund ti mbulonin shpenzimet dhe ndërprejnë punimin. Ndërmarrjet më të forta filluan procesin e privativizimit me shumë parregullësi ngaqë jurisprudenca gjithashtu ishte në tranzicion dhe mungonin ligje sa i përket të drejtës së pronës private etj.

I gjithë prodhimi në sistemin e mëparshëm kontrollohej nga shteti, nuk kishte konkurrencë tregtare, ndërmarrjet pothuaj ishin monopol, çmimi caktohej nga shteti, marrëdhëniet tregëtare bëheshin ndërmjet shteteve të të njëjtit bllok. Shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore dallonin për nga hapsira që i kishin lënë sektorit privat. Sektori privat dallonte nga 1 përqind e PBB në ish Çekosllovakia, 20 përqind e PBB në Poloni e cila kishte hapjen më të madhe për nga sektori privat. Ndërsa sektori privat në ish republikat Jugosllave varironte nga 10 përqind e PBB dhe më pak.

Meqenëse politikat bazë të të gjitha shteteve postkomuniste ishin identike u krijuan politika të njëjta tranzicioni të cilat u hartuan nga qeveritë e reja me ndihmën e organizatave ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Ekonomike për Ndërtim dhe Zhvillim (institucion i parë i cili u krijua për të asistuar procesin e tranzicionit).

Për të patur sukses periudha e tranzicionit mvaret nga kushtet fillestare dhe mbështetja ndaj reformave, kështu duhet shtuar edhe politikat sociale për të mbrojtur grupet e prekura deri atëherë kur ekonomia ta ketë marrë veten. Pikë kyçe është investimi në kapitalin human ku shohim që edhe shtetet e zhvilluara e përdorin si një aset me rëndësi, si dhe themelimi i institucioneve që do mbështesin tregun privat.

Pikat që determinojnë se jemi në rrugën e duhur të tranzicionit janë:

1. Çdo ndërmarrje si objektiv duhet të ketë maksimizimin e fitimit.
2. Nga shteti duhen financuar aktivitetet që rrisin vetëdijen dhe mirëqenien e qytetarëve.
3. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi duhet të jetë e vogël dhe të sigurojë një treg konkurrence e jo monopoli.

Parë nga kjo perspektivë roli i shtetit në këtë periudhë është i rëndësishëm. Nga njëra anë shteti duhet të sigurojë zhvillimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe nga tjetra anë të sigurojë që tranzicioni të shkojë rrjedhimisht. Shteti duhet të vendosë rregullat e lojës duke mundësuar gjenerimin e të ardhurave fiskale për të financuar aktivitetet të sektorit publik. Pa përshtatje të politikës fiskale nuk kemi zhvillim të mirëfilltë nga ku financohen programet e shpenzimeve publike, rastet sociale etj. Nga tjetra anë tatimet mund ta rëndojnë dhe dekurajojnë sektorin privat.

Për ta marrë kahjen e duhur ekonomia shteti duhet që të vendosë rregulla, të gjeneroj të ardhura fiskale për të financuar aktivitete të sektorit publik, ti shpenzojë të ardhurat në menyrë efektive, të siguroj të drejta të pronës dhe të prodhoj të mira publike. Tranzicioni nuk është kryer me sukses nëse nuk funksionojnë mirë institucionet fiskale dhe programet e shpenzimeve publike.

KAPITULLI II

2.1 Shpenzimet publike në infrastrukturë dhe të ardhurat

Në ekonominë e lirë, ngushtohet fushëveprimi i qeverisë me qëllim që ti lihet hapsirë sektorit privat, na jep një kuptim që shteti duhet të jetë më vigjilent në ndërhyrjet. Më specifikisht ndërhyrja e shtetit duhet të projektohet me shumë kujdes, në mënyrë që të mbështesë sektorin privat e jo ta pengojë atë. Nga ana tjetër një investim i tepërt i shtetit në ekonomi tregon për de-liberalizimin e tregut dhe politikave stimuluese. Pengimi i tregut të lirë rezulton në devijim dhe shtërngim të sektorit privat dhe të qeverisë gjithashtu. Shteti duhet të rregullojë ligjet për mbështetje të grupeve të interesit për mirëfunksionimin e ekonomisë.

Qëllimi kryesor i qeverisë është:

- Zbatueshmëri e ligjit
- Ligje që favorizojnë prodhuesin si dhe konsumatorin vendas.
- Mbrojtja e konsumatorit nga abuzimet
- Zhvillimi i sektorëve më profitabil

Mund të duket që shteti aspak nuk bën investime në ekonominë e zhvilluara ngase favorizohet sektori privat, mirëpo ajo nuk është e sakt. Në realitet ndodh, që investimet publike zënë pjesën më të madhe të totalit të investimeve të kryera në ekonominë në zhvillim. Fokusi i studimeve qëndron në rëndësinë, që kanë investimet publike kundrejt investimeve private, për të stimuluar rritjen ekonomike (Khan, 1996; Coutinho dhe Gallo, 1991; Koti, 2016).

Për të vendosur se cilat projekte infrastrukturore duhen investuar, qeveritë duhen të masin me shumë kujdes peshën e kthimit social përkundrejt kostove të financimit dhe pasojave fiskale. Për këtë duhen marrë parasysh, që investimet në infrastrukturë nuk kanë si qëllim primar rritjen e të ardhurave. Disa projekte infrastrukturore mund të kenë kthim të lartë social, pavarësisht se kostot nuk mund të rikupërohen me vendosjen e tarifave për përdoruesit e investimit ose me rritjen e tatimit mbi të ardhurat nga aktiviteti. Këto situata sjellin mospërputhjen midis

përfitimeve sociale nga njëra anë dhe pasojave negative fiskale nga ana tjetër (Costa et al. 1987; Khan 1996).


Debalansimi i kërkesës dhe ofertës i shkaktuar nga kriza globale (2008 – 2015) botërore ndikoi në stagnimin e rritjes ekonomike në vendet në zhvillim. Kjo situat duhej kapërcyer, investimet private ishin stagnuar, shteti duhej nxitur zhvillimin me anë të investimeve publike me forma të PPP.

PPP asetet publike i përfëshin në pronësi private, të ndërtuara nëpërmjet koncesioneve, të cilat pasi mbaron afati kohor i marrëveshjes i transferohen qeverisë. PPP kanë strukturë të ndryshme, por karakterizohen nga dy elemente kyç:

- ❖ PPP krijojnë flukse paraje të ndryshme dhe drejtojnë prokurime publike. PPP marrin shumë pak ose në disa raste aspak fonde publike për ndërtimin e veprave publike, të cilat kompensohen me taksa direkt nga përdoruesit e infrastrukturës, ose pagesa periodike të paguara nga institucionet publike (të cilat kanë në varësi infrastrukturën e ndërtuar) për gjatë gjith kohës që zgjat koncesioni. Në krahasim me kreditë publike (bonot e thesarit), ripagimi i investimit shtyhet deri në përfundimin e plotë të ndërtimit të infrastrukturës publike. Nga studimet e kryera për PPP, është vërejtur që kombinimi me taksa dhe pagesa vjetore publike është më i përshtatshëm, pasi nuk krijon kosto totale mbi përdoruesit ose institucionet publike.
- ❖ PPP krijon një kontratë të vetme si “mekanizëm për qëllim specifik”, e cila zëvendëson disa kontrata të qeverisë me disa ofrues të përfshirë në ndërtimin dhe financimin e projektit infrastrukturor. Kontrata e vetme specifike është një konsorcium i kompanive financuese dhe ndërtuese, të cialt punojnë sëbashku për të përfunduar projektin publik. Në këtë rast, risku i lidhur me aktivitetet ndërmejt ofruesve transferohen nga qeveria tek Kontrata e Vetme, kështu që përgjegjësia si për ndërtimin edhe për operacionet janë të bashkuara në një të vetme (Irwin et al. 2012, OECD, 2013).

Republika e Maqedonisë kohët e fundit i ka rritur shpenzimet buxhetore në investime publike si rrugë, elektroenergjetikë, shëndetësi, arësim dhe sistemin social. Më poshtë në grafikun 2.1 shohim që pas krizës 2001-2005 ka pasur një rritje në Shpenzimet Kapitale Buxhetore, pas asaj ka një rënie vitin 2009 duke vazhduar ngadalë të rritet secilin vit. Në vitin 2018 Shpenzimet Kapitale Buxhetore kanë arritur në 24.144 milion denarë, ndërsa gjithashtu vitet në vazhdim planifikohet të rriten shpenzimet me tempo të ngadalta duke mos shkaktuar turbulenca fiskale.

Grafiku 2.1: Shprenzimet Kapitale Buxhetore të Republikës së Maqedonisë




Burimi: Ministria e Financave

Për shumë vende në rajon kompletimi i mungesave infrastrukturore do të jetë sfidues për shkak të hapsirës së kufizuar fiskale. Mbulimi i mungesave të mëdha në infrastrukturë kërkon burime të mëdha fiskale, qoft nga të ardhurat buxhetore ose nëpërmjet financimit me borxh. Mirëpo, shumica e vendeve në rajon kanë tashmë nivele të larta të borxhit publik (mesatarisht 55 përqind e PBB-së në 2016), me tre vende mbi 70 përqind të PBB-së. Nivelet e deficitit në 2016 ishin edhe më të larta në Mal të Zi, Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë se bilanci parësor stabilizues i borxhit. Borxhi i lartë ka ndikim negativ mbi ekonominë, ai zvarrit rritjen ekonomike, përkeqëson performancën fiskale dhe e ngre rrezikun. Mbi nivelin maksimal të lejuar, borxhi publik destabilizohet dhe vendi humb qasjen në treg. Ndërsa niveli i borxhit të sigurt mvaret nga rrethanat specifike të vendit. Për vendet në zhvillim FMN përdor një “normë” ose prag prej 65 përqind të PBB-së për borxhin e përgjithshëm. Ky prag është një kufi i arsyeshëm për një nivel borxhi të përgjithshëm. Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi tashmë janë mbi këtë nivel borxhi. Në Bosnje dhe Hercegovinë dhe R. e Maqedonisë borxhi publik sillet nga 35-50 përqind e PBB-së, ndërsa në Kosovë në vitin 2016 borxhi ishte rreth 20 përqind e PBB-së.

Kufizimet e likuiditetit duhet të jenë të detyrueshme. Nevojat e financimit bruto përshkruajnë financimin që një vend duhet të rritë në afat të shkurtër për të mbuluar deficitin e tij dhe pjesën e borxhit publik që duhet të paguhet në vitin e ardhshëm. Nëse nevojat e financimit bruto janë të larta, vendi mund të ballafaqohet me probleme të likuiditetit.

Figura 2.1: Hapësira fiskale dhe mandësitë e infrastrukturës



Burimet: FMN, DSA; FMN, VEE; Baza e të dhënave WDI; VNM; IRF; Eurostat; dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.

Shënim: Madhësia e fluskave është proporcionale me shtrirjen e hendekut të infrastrukturës.

1 Përpunuar si një dallim në mes të balancave primare (të rregulluara ciklike) dhe stabilitetit të borxhit.

2 Borxhet publike dhe bruto nevojat për financimin e fillimit, të përdorura në Indikatorët e Ndjeshmërisë Ekonomike të FMN-së janë 65 përqind e PBB-së dhe 20 përqind e PBB.

3 Balancat primare stabilizuese të borxhit janë publikuar të dhënat e marra nga raporti i stafit të vendit përkatës.

4 Borxhi publik është borxhi i përgjithshëm i qeverisë së përgjithshme.

Në Shqipëri dhe Mal të Zi, nevojat e financimit bruto në vitin 2016 ishin mbi 20 për qind të pragut të PBB të përdorur nga FMN si tregues i dobësisë së likuiditetit dhe aftësisë paguese. Maqedonia dhe Serbia gjithashtu përballen me nevojat e financimit bruto afër nivelit 15 për qind, ndërsa Kosova, pavarësisht borxhit të ulët publik, është afër 10 për qind të PBB-së, kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të borxhit të papaguar.

Disa vende të Ballkanit Perëndimor janë në "zonë të rrezikshme" kur shikojnë të gjithë treguesit e qëndrueshmërisë fiskale. Mali i Zi është mbi të gjitha tre pragjet e qëndrueshmërisë, ndërsa gjithashtu ka një hendek të konsiderueshëm të infrastrukturës. Shqipëria ka nevoja të mëdha financimi bruto dhe një nivel të lartë të borxhit publik, ndërsa Serbia është gjithashtu mbi ose afër limitit në këto dy dimensionet. Këto vende do të kenë vështirësi në financimin e projekteve të infrastrukturës shtesë pa rregullim fiskal. (FMN 2018).

2.1.1 Performanca e aktiviteteve publike dhe efektiviteti

Shpenzimet publike janë një paketë e cila nuk e ka fokusin vetëm në investimet infrastrukturore por në të përfshihen edhe investimet në medicinë, arsim si dhe në resurse humane me trajnime të ndryshme. Matja e përgjithshme e sektorit publik bëhet me performansën e cila është një instrument i vlerësimit të progresit të planifikimit kundrejt qëllimeve të përcaktuara kur tashmë ne i dimë objektivat strategjike. Pra ajo i regjistron të dhënat e procesit të prodhimit nga inputi në output dhe analizimi i rezultateve. Performansa pak a shumë e shpjegon si një dukuri procesin

por pa e analizuar se çfar ndryshimesh mund të bëhen në objektivat apo aktivitetet. Një studim i (OECD, 1994) performancën e trajton sipas këtyre dimensioneve:


1. **Efiçenca** që është marrëdhënia midis burimeve të përdorura dhe maksimumin e mundshëm të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara me këtë sasi burimesh.
2. **Efektiviteti** që është shkalla me të cilën projektet ose programet arrijnë objektivat apo rezultatet e tyre të pritshme.
3. **Përputhshmëria** që do të thotë se institucionet apo agjensitë duhet të veprojnë në përputhje me buxhetin apo akte dhe ligje të tjera përsa i përket menaxhimit të shpenzimeve.

Cilësia e shërbimeve e cila krahas lidhjes direkte që ka me efektivitetin, lidhet edhe me disponueshmërinë, periodicitetin, besueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Më shumë i referohet cilësisë së shërbimeve sesa rezultatit që sjellë ofrimi i shërbimeve.

Performansa nuk merret me detaje se si veprojnë njësitë, ajo cakton objektiva dhe merret me përmbushjen e tyre. Një ndryshim në një ose disa nga dimensionet e lartëpërmendura nuk don të thotë se ndryshojnë të gjith dimensionet p.sh: nëse rritet cilësia e shërbimeve nuk don të thot se rriten edhe çmimet.

Elementet që e rëndojnë performancën dhe e bejnë të marri kahje negative janë shpenzime që i bën shteti në drejtim të transfereve, subvencionet, konsumit qeveritar dhe punësimit në sektorin publik. Rëndim në matjen e vlerave të performancës japin edhe shpenzimet e tepërta të qytetarëve si dhe nivelet e larta të tatimeve të cilat i ngrejnë kostot e mallrave dhe rëndojnë publikun.

Me të vertetë ne vendet e Ballkanit Perëndimor është sfiduese mbajtja e një politike fiskale me shpenzime të mëdha qeveritare në sektorin publik. Mirëpo edhe ajo që është e caktuar për shpenzime publike është inefiçente dhe nuk shfrytëzohet deri në maksimum. Gati në të gjitha vendet e rajonit vërehet një pjesë e paekzekutuar e përqindjes së llogaritur për shpenzime kapitale të buxhetuara, këto fillojnë nga 5 përqind derin në 25 përqind (ose reth 0,1 – 1,0 përqind të PBB-së).(Figura 2,2).



Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-së.


1 Mbulimi i referohet nivelit të qeverisë qendrore.

2 Shpenzimet për Shqipërinë dhe Malin e Zi janë llogaritur gjatë viteve 2013-15 dhe respektivisht 2013-16.

Këto të dhëna janë bazë të marra nga institucionet kyçe shtetërore mirëpo ka nënvlerësim në raportimin e të dhënave shtetërore. Autoritetet mendojnë se hendeuku është edhe më i madh dhe se këto norma janë edhe më të larta në nivelin e qeverisë qendrore. Sidoqoftë këtu kemi një shenjë se duhen përmirësuar kushtet e udhëheqjes me kapitalin shtetëror dhe se siç e përmendëm më lart në rajon mungojnë edhe normat e mirëfillta të udhëheqjes me projekte.


Grafiku 2.3. Struktura e Shpenzimeve Buxhetore dhe Barra Tatimore

1. Shpenzimet aktuale dhe kapitale, 2013-15
(Përqindja e PBB-së)



Burimet: FMN, Databaza e FAD-së; FMN, OBT, dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.


2. Të hyrat totale nga taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, 2015
(Përqindja e PBB-së)



Burimet: Eurostat; FMN, WEO; FMN, GFS; OECD; dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.

Nga figura 2,3 shohim që ka hapsirë për shpenzime më të mëdha kapitale, mirëpo ato duhen mirë menaxhuar. Mund të shohim që shpenzime qeveritare janë të vogla dhe se ato e kapërcejnë 40 përqindshin në Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi. Përgjithësisht të gjitha vendet e rajonit kanë një efikasitet të ulët në investime kapitale, ato mund të shkurtojnë shpenzimet qeveritare dhe të rrisin investimet kapitale. Për të bërë shpenzime në investim duhet llogarit mirë të hyrat, pra dallimi i të hyrave dhe shpenzimeve na jep rezultatin pozitiv apo negativ, aty shohim se a mund ti mbulojë buxheti investimet apo duhet marrë borxh. Më poshtë i kemi figurat e të ardhurave qeveritare. (Figura 2.2).

Figura 2.2. Struktura e të ardhurave totale (Përqindja e PBB-së), 2015





Burime: Eurostat; FMN, WEO; FMN, GFS; OECD; dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.

2.1.2 Efiçenca e sektorit publik , mënyrat dhe faktorët

Efiçenca në ndërmarrjet publike matet si vlerësim i outputit të realizuar dhe kostos së shpenzuar, me një fjalë institucionet publike do të jenë efiçente nëse nëpërmjet përcaktimit të shumës që duhet shpenzuar, sigurohet përfitimi më i madh i mundshëm, përfitim ky që do ja kalonte shumës së shpenzuar. Bazuar në studimet

empirike të kryera në vendet e zhvilluara (Coenen, 2014; Forni dhe Gambetti, 2010; Leeper, Walker dhe Yang, 2013), kanë analizuar nëse efektet e investimeve publike në infrastrukturë variojnë sipas zhvillimit ekonomik të një vendi, efikasitetit të investimeve publike dhe mënyrës sesi investimi është financuar (me borxh apo pjesë e buxhetit). Studimet tregojnë se investimet publike kanë efekt afatgjatë në produktin përfundimtar, si psh. 1% pikë rritje e investimeve publike të PBB rrit me 0,4% produktin përfundimtar po atë vit që kryhet investimi, dhe 1,5% pas 4 viteve që pasojnë. Atëherë nëse do marrim mesataren e investimeve publike si përqindje e produktit përfundimtar (~3% e PBB), kjo do të sillte efekte për periudhën afatshkurtër dhe afat-mesme me 0,4% dhe respektivisht 1,4%. Normal që këto rezultate do të ndryshonin nëse do të rriteshin normat e kamatës, që do shkaktonin rritjen e borxhit të jashtëm, kjo do të ndikonte edhe në ndryshimin e PBB. (Grafiku 2,4 dhe 2,5)



Gjithashtu, studime të tjera (Ben Zeev dhe Pappa, 2014; Leeper, Richter dhe Walker, 2012) tregojnë se investime të larta publike ulin raportin Borxh/PBB si për periudhën afat-shkurtër (0,9% pikë e PBB) ashtu dhe për periudhën afat-mesme (4% pikë e PBB-së).

Efektet makroekonomike të investimeve publike variojnë sipas regjimeve ekonomike të vendeve. Gjatë periudhave me rritje të ulët ekonomike, shpenzimet publike e rrisin nivelin e produktit përfundimtar me 1,5% në vitin e investimit dhe 3% në periudhën afat-mesme. Por, gjatë periudhave me rritje të lartë ekonomike (periudha ekspansioniste), efekti afat-gjatë i investimeve publike nuk është vërtetuar akoma. Gjithashtu, investimet publike sjellin një rënie të raportit Borxh/PBB gjatë periudhave me rritje ekonomike, për shkak të rritjes së madhe të produktit përfundimtar. Për më tepër, efektet makroekonomike të investimeve publike janë më të forta në vendet me efikasitet të lartë të investimeve publike, si në periudhën afat-shkurtër ashtu edhe në periudhën afat-mesme. Në vendet me efikasitet të lartë të investimeve publike, një shpenzim për investime publike rrit nivelin e produktit përfundimtar me 0,8% në atë vit dhe me 2,6% pas 4 vitesh investimi. Por në vendet me efikasitet të ulët të investimeve publike, efekti në produktin përfundimtar është 0,2% në atë vit dhe 0,7% për periudhën afat mesme. Si rezultat, mund të themi se investimet publike sjellin një ulje të ndjeshme të raportit Borxh/PBB për periudhën afat-mesme (rreth 9% pas 4 vjet investimi) në vendet që kanë efikasitet të lartë të investimeve publike, si dhe një rritje të raportit Borxh/PBB në vendet me efikasitet të ulët të investimeve publike (Ostry, Ghosh dhe Espinoza, 2014).

Akitoby dhe Stratman (2008) gjetën se efektet në produktin përfundimtar janë më të mëdha kur investimet publike financohen me borxh sesa nga pjesa e buxhetit të shtetit. Psh. një investim publik i financuar me borxh sa 1% e PBB rrit nivelin e prodhimit përfundimtar me 0,9% në atë vit dhe me 2,9% pas 4 vitesh, ndërsa efektet e investimeve të investuara nga buxheti nuk janë domethënëse për periudhë afat-shkurtër dhe afat-mesme.

Tabela 2.1: Gjendja e borxhit publik (në milion euro)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	30.9.2017
Borxhi publik i jashtëm	1881,9	1941,2	2078,7	2725,1	2847,5	3286,0	3174,0
Borxhi shtetëror	1582,1	1615,9	1597,5	2092,2	2096,7	2446,6	2376,7
Borxhi i garantuar	299,9	325,3	481,2	633,0	750,8	839,4	797,3
Borxhi publik i brendshëm	532,9	967,6	1202,7	1196,2	1379,7	1425,4	1517,5
Borxhi shtetëror	510,8	938,6	1174,1	1170,3	1356,6	1404,9	1499,1
Borxhi i garantuar	22,1	29,0	28,6	25,9	23,2	20,5	18,4
Bor. pub. total sipas Ligj. për Borxhin Publik	2414,9	2908,8	3281,4	3921,3	4227,2	4711,4	4691,5
Borxhi publik total si% e PBB-së	32,0	38,3	40,3	45,8	46,6	48,5	45,8
Borxhi total qeveritar	2092,9	2554,5	2771,6	3262,5	3453,3	3851,5	3875,8
Borxhi qeveritar si% e PBB-së	27,7	33,7	34,0	38,1	38,1	39,6	37,8
Borxhi total i garantuar	322,0	354,3	509,8	658,9	774,0	859,9	815,7
Borxhi i garantuar si% e PBB	4,3	4,7	6,3	7,7	8,5	8,8	8,0

Burimi: Ministria e Financave dhe Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë

Rreziku i kësaj strategjie qëndronte në akumulimin e borxhit dhe në ndryshimin e normave të kamatës që do e rëndonte dhe do e rriste borxhin.

Studime të tjera të analizuara nxorën se investimet publike në infrastrukturë mund të vet-financohen (tarifa dhe taksa për mirëmbajtje dhe përdorim), duke mos shkaktuar rritje të shpejtë dhe të lartë të raportit Borxh/PBB. Ato kontribuojnë në

mirëqenien e një vendi si pasojë e nevojës, që mund të ketë një vend për investime në infrastrukturë. Për më tepër, në vendet me ekonomi të zhvilluar, sektori privat është mjaftueshëm i zhvilluar për të prodhuar mallra dhe shërbime, të cilat në vendet e tjera duhet të sigurohen nga sektori publik. Kështu që, në vendet me të ardhura të ulëta, ndikimi i investimeve publike është më i madh sesa në vendet me të ardhura të larta. Atëherë, pse qeveritë e vendeve në zhvillim nuk investojnë, kur efektet e investimeve supozohen të jenë pozitive dhe efçente? Kur është koha e përshtatshme për investime në infrastrukturë? (Levine dhe Renelt, 1992; Fischer, 1993).

Sipas analizave të BB (1994) dhe FMN-së (2014) gjat studimit erdhën në rezultat që një rritje e investimeve publike në infrastruktur rrit prodhimin në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë, sidomos në peroudhën kur efçenca e investimeve është e lart për shkak të krizave ekonomike. Në vendet në zhvillim, pjesa më e madhe e investimeve në infrastruktur janë shtetërore, në të cilat politikat fiskale në bashkëpunim me kornizat ligjore i bashkojnë aktivitetet e sektorit publik me atë të sektorit privat qoftë në sferën e industrisë apo të prodhimit të produkteve. Studimet tregojnë që ka një mungesë të lartë të investimeve publike dhe infrastrukurore në vendet në zhvillim, atëherë nevoja për një nxitje në investimet publike është e lartë, duke përdorur fonde të vendeve të zhvilluara. Gjithashtu, investimet me borxh rrisin borxhin publik prajndaj konsiderohen si riskante. Mirëpo nëse ka nevojë për një infrastrukturë dhe nëse zbatohen me përpikmëri kriteret e një investimi efçent, në këtë rast projektet e financuara me borxh do të kishin efekt më të madh.

Corong et al. (2012) bëri një studim për shtetin e Filipineve duke analizuar ndikimin e investimeve publike në infrastruktur dhe ndikimi i saj në rritjen ekonomike. U përdor një model dinamik në të cilin kapitali publik u përdor si input prodhimi. Rezultated dolën që shpenzimet e mëdha në kapitalin publik rezultuan në akumulimin e kapitalit publik dhe rritën produktivitetin. Me këtë jo vetëm që ndikuan në rritjen ekonomike por edhe ulën pabarazin dhe varfërin si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë.

2.1.3 Indeksi i efçencës së sektorit publik

Animi i qeverisë kah shpenzimet publike kërkon rregullim fiskal, si dhe vetë plani i shpenzimeve duhet të ketë parasyshë efçencën e atyre shpenzimeve, me qëllim që të nxit rritjen ekonomike dhe rrisë mirëqenien e përgjithshme. Duke qenë se një pjesë e madhe e PBB-së ndahen për shpenzimet publike, përmirësimi i efikasitetit të shpenzimeve publike është një çështje e rëndësishme që mund të ndihmojë në sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike (Barrios dhe Schaechter (2008). Kuptimi se sa larg qeveritë mund të rrisin performancën e tyre në të njëjtat nivele shpenzimi thjesht duke rritur efikasitetin e tyre të shpenzimeve mund të ndihmojnë krijuesit e politikës fiskale që të arrijnë disiplina të qëndrueshme fiskale (Mandl, Dierx dhe Ilzkovitz (2008).

Një studim i kryer nga (Antonio Afonso & Mina Kazemi, 2016) ka vlerësuar efikasitetin e shpenzimeve publike në 20 vende të OECD-së gjatë periudhës 2009-2013. Arsyeja kryesore që e bënë këtë punë ishte të njohin sa mirë dhe me efikasitet përparojnë këto vende, si nga perspektiva e inputit ashtu dhe e outputit. Analiza e performancës nuk na jep asnjë të dhënë për përdorimin efiçent të burimeve të qeverisë. Efiçenca matet nga marrëdhëniet midis burimeve të përdorura dhe maksimumit të mundshëm të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara me këtë sasi burimesh. Për të gjetur vlerat e Performancës së Sektorit Publik (PSP) dhe Efiçencës (PSE) është ponderuar me kategoritë korresponduese të shpenzimeve publike. Supozoni se ka vende me n fusha të performancës, atëherë ne mund të përcaktojmë ecurinë e përgjithshme të vendit i nga:

$$PSP_i = \sum_{j=1}^n PSP_{ij}, i = 1, \dots, p; \text{ me } PSP_{ij} = f(I_k).$$

ku $f(I_k)$ është një funksion i k treguesve ekonomikë të vëzhgueshëm I_k . Dhe

$$PSE_i = \sum_{j=1}^n \frac{PSP_{ij}}{EXP_{ij}}, i = 1, \dots, n.$$

ku EXP_{ij} nënkupton shpenzimet qeveritare të vendit i në zonën j .

Performanca e sektorit publik e matur mësipër përbën koston e shpenzimeve publike të matura në prqindje të PBB-së. Për të matur efiçencën, Performanca e Sektorit Publik (PSP) krahasohet me sasinë e shpenzimeve publike të përdorura, për të arritur atë. Për të llogaritur koston e aktiviteteve publike janë përdorur shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime, transferta, arsim shëndetësi dhe investime publike.

Kur shohim analizën e 23 vendeve më të industrializuara (shih Tabela 4 në fund të punimit) mund të themi se vihen re diferenca të mëdha midis shteteve, në krahasim me indeksin e performancës. Luksenburg (1.85), Zvicra (1.69) dhe Norvegjia (1,56) kanë indeksin më të lartë të efiçencës, duke pasqyruar një nivel të lartë të performancës së sektorit publik kundrejt nivelit të shpenzimeve të kryera. Edhe pse Luksenburg është i pari në listë për nga performanca e sektorit publik, që nuk ka dyshim se është më efiçent. Mirëpo rezultatet e një hulumtimi DEA që do e përmendim më poshtë tregojnë se Zvicra duke zbatuar shumë më të ulët të shpenzimeve publike mund të arrij nivelin më të lartë të performancës në këtë mostër dhe është i vetmi vend që kryen kufirin e efikasitetit me një largësi të konsiderueshme nga vendet e tjera. Italia (0,45), Portugalia (0,37) dhe Greqia (-0,03) janë tre shtetet të renditura në fund të tabelës, niveli i ulët i efiçencës tregon se kostoja për të arritur këtë performancë është mjaft e lartë. Kanadaja dhe SHBA-të nuk janë larg shteteve me performim të mirë, në tabelën 4 Kanadaja një indeks (1,18) kurse SHBA (1,21) që nuk janë keq për nga performimi shkaku që janë shtete të mëdha, nuk mund të kenë indeks si Luksenburg dhe Zvicra. Ndërsa në tabelën 5

të efijencës gjithashut Kanada ka indeks (1,36) kusre SHBA (1,42). Si për nga performimi ashtu edhe për nga efijenca shoim që Kanadaja për të arritur të njëjtën performancë të sektorit publik, asaj do ti kushtojnë më shum shpenzime sesa Shteteve të Bashkuara.

Rasti i Japonisë dhe Belgjikës është interesant, që të dyja kanë indeks (0,98) dhe renditen në vendin e nëntë në tabelë, mirëpo edhe pse Japonia deri në vitin 2006 ishte shteti me një performim më të mirë në botë për nga performimi publik gati 40% dallim nga shtetet tjera. Tani Belgjika është ajo që ka performim më të mirë në krahasim me Japonin, që do të thotë se realizon një aktivitet më të madh shtetëror.

Shpërndarja e vlerave të treguesve të mundësis dhe atyre të Musgrave është pothuajse e njëjtë me shpërndarjen që kishin në treguesin e performancës, por me një përkeqësin të lehtë, ku 55 përqind e vendeve kanë vlera mbi mesataren në krahasim me 65 përqind tek indeksi i performancës.

Shtetet e renditura në fund të listës, një nga nën-treguesit i cili ka vlerë të ulët është ai i Performancës Ekonomike. Pra efekti i shpenzimeve publike në performancën ekonomike të këtyre vendeve nuk ka qenë shumë pozitiv. Shembull kemi Greqinë me indeks performimi (-0,03), e përbashkëta e këtyre është se janë shtete me një nivel shpenzimesh mbi 50 përqind të PBB. Kjo mund të shihet edhe nga indeksi i efijencës për qeveritë e mëdha i cili është 8 përqind poshtë mesatares së 23 shteteve dhe rreth 40 përqind më i ulët se indeksi i efijencës së qeverive të vogla.

Për dallim nga vendet e industrializuara, vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, si dhe Republikat Baltike nuk kanë diferenca të mëdha në indeksin e efijencës së sektorit publik. Indekset e tyre të efijencës janë midis 0.85-0.92. Këto vlera në krahasim me vendet e industrializuara janë relativisht të ulta. Vendet me efijencë të lartë të sektorit publik janë Republika Sllovake (0.92), Estonia (0.91) dhe Letonia (0.91). Krahasuar me shumicën e vendeve të Bashkimit European nuk ka diferenca shumë të mëdha, këto diferenca variojnë nga 5 deri në 10 përqind. Vlerat më të unta treguesi i efijencës, në pothuajse të gjitha këto shtete, i arrin në nën-treguesit e administratës, stabilitetit dhe performancës ekonomike. Më poshtë tabelës ndër këto shtete ndodhet Bulgaria me stabilitetin ekonomik 0.06 dhe performanca ekonomike është shumë e ulët 0.29. Megjithatë edhe për shtetet poshtë tabelës kosto e arritjes së performancës së sektorit publik është e lartë.

Tabela 3.4 Treguesi i Efijencës për Europën Qëndrore dhe Lindore dhe Rep. Balltike

	Treguesit e mundësisë			Treguesit e Musgrave			Indeksi Efijenc
	Adminis trata	Arsimi	Shendet sia	Shpërnd arja	Stabilitet ekonomik	Perform. Ekonomik	
Bullgari	0.79	1.49	1.00	1.01	0.06	0.29	0.77
Rumani	0.69	1.53	1.03	1.05	0.20	0.68	0.86
Rep. Çeke	0.76	1.31	0.66	1.04	0.66	0.66	0.85
Hungari	0.83	1.12	0.75	1.05	0.70	0.63	0.85
Poloni	0.89	0.98	0.97	0.80	0.69	0.68	0.83
Slloveni	0.91		0.68	0.81	1.15	0.84	0.88
Rep. Sllovake	0.82	1.23	0.77	1.18	0.90	0.64	0.92
Estoni	1.09	0.83	0.91	1.21	0.57	0.87	0.91
Lituani	0.83	0.88	0.90	1.27	0.40	0.90	0.86
Letoni	0.82	0.79	1.14	1.11	0.75	0.87	0.91
Mesatarja	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	

Burimi: Burimi: Banka Botërore (2006)


Parametër tjetër i efijencës së shpenzimeve publike është analiza e shpenzimeve input – output (DEA) e cila shërben për të përcaktuar humbjen e shpenzimeve publike. Efijenca input nënkupton, sa është minimumi që duhet shpenzuar nga një shtet për të patur të njëjtin nivel outputi. Nga ana tjetër efijenca e outputit tregon sesa output mund të realizojë një shtet duke përdorur të njëjtin nivel shpenzimesh publike. Analiza e parë e këtyre parametrave duhet bërë duke vendosur indeksin e performancës së sektorit publik kundrejt indeksit të efijencës. Në terminologjin ekonomike njihet me termin “kufiri i mundësive të prodhimit” i cili paraqet maksimumin e outputit të realizuar në kushtet kur janë dhënë faktorët e prodhimit ose inputet. Shtetet të cilat vendosen përgjatë kufirit të mundësive të prodhimit janë shtetet më efijente. Ndërsa shtetet me rezultate inefijente përcaktohen kur rezultatet e tyre krahasohen me shtetet në kufirin e efijencës. (Tabela 6 në fund të punimit).

Duke marrë për analizë 23 vendet më të industrializuara në botë (Tabela 6 dhe 7 në fund të punimit), tek të cilat kemi matur performancën dhe efijencën, shtetet si Zvicra, Japonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndodhen në kufirin e mundësive të prodhimit. Megjithëse Shtetet e Bashkuara nuk rradhitën në tre vendet e para edhe për nga outputi, sikurse për nga inputi, ato cilësohen si një nga shtetet më efijente bashkë me Japoninë. Këtë e kemi si rezultat i krahasimit të indeksit të performancës dhe efijencës midis shteteve, asnjëri prej tyre nuk e arrin performancën e sektorit publik që kanë Shtetet e Bashkuara dhe Japonia me më pak shpenzime qeveritare.

Nga tjetra anë të gjitha shtetet e tjera që kanë një performancë më të ulët të sektorit publik se Shtetet e Bashkuara dhe Japonia dhe shpenzojnë më shumë (si përqindje e PBB) për të arritur atë performancë, janë më pak efijente se to. Kemi

rastin e Finlandës dhe Holandës në këtë situatë. Ato shpenzojnë më shumë se SHBA dhe Japonia, por edhe arrijnë një nivel më të lartë të performancës për këtë nivel shpenzimesh edhe meqenëse asnjë shtet tjetër nuk mund të arrijë nivelin e tyre të performancës me më pak shpenzime, ato ndodhen në kufirin e mundësive të prodhimit së bashku me SHBA-të dhe Japoninë. Shohim që këto tre shtetet e lartëpermndura kanë kombinimet më efikente të performancës së sektorit publik dhe nivelit të shpenzimeve publike. Të gjithë shtetet e tjera ndodhen brenda këtij kufiri. Sa më larg kufirit të jenë pozicionuar shtetet aq më pak efikente janë ato dhe anasjelltas.

Fig. 2.3 Linja e efikencës së Investimeve Publike



Burimi: FMN, 2015

Në grafikun e mësipërm kemi kufirin e efikencës së investimeve publike, në të shohim se sa më larg kufirit të jetë vendi, aq më lartë e ka inefikencën, duke mbledhur edhe pikët më të ulëta në Indikatorin e Efikencës PIE-X. Nga studimet e FMN-së, vendet me efikencë të lartë janë vendet, që ndodhen mbi kufirin e efikencës, ndërsa vendet që ndodhen jashtë linjës, mund të kenë inefikencë në inputet e përdorura ose në produktin përfundimtar. Shumica e ekonomistëve janë të mendimit se vendet me efikencë të lartë të investimeve publike kanë edhe rritjen më të madhe të të ardhurave për frymë. Në figurën 2.3 shohim se këndi i kufirit fillon të zvogëlohet me rritjen e kapitalit publik dhe kjo lidhet me limitin e burimeve për rritjen e infrastrukturës si dhe me limitin e kërkesës për shërbime infrastrukturore.


2.2 Investimet kapitale në infrastrukturë

Infrastruktura e mirë dhe e zhvilluar e një shteti jep impulse për ritëm konstant të ekonomisë, ndihmon në rritjen e ekonomisë dhe sektorëve tjerë më pak të zhvilluar. Gjithashtu infrastruktura ndihmon në alokimin e resurseve nga vendet rurale në vendet urbane, poashtu ajo ndihmon në shpërndarjen e inputeve primare me kohë tek kompanitë e prodhimit. Me një rrjet infrastrukturor mirë të zhvilluar bëhet më lirë transportimi i mallrave dhe shërbimeve në vend dhe rrit mirëqenien e qytetarëve, nga këtu përfitojnë edhe institucionet e arsimit dhe shëndetësisë të cilat institucione me një menaxhim të mirë dhe infrastrukturë të zhvilluar gjithashtu rrisin zhvillimin ekonomik. Kryesisht ajo promovon integrimin e tregut, duke ulur ndjeshëm luhatjet e çmimeve të produkteve dhe rialokimin e burimeve në përputhje me avantazhet krahasimore. Nga ana tjetër, infrastruktura rrugore mund të ndikojë në produktin përfundimtar të ekonomisë, duke ndryshuar kërkesën agregate nëpërmjet krijimit dhe rritjes së kërkesës për inpute imediate nga sektorë të tjerë, duke i matur me multiplikatorë të ndërthurrur në ekonomi. Për më tepër infrastruktura e zhvilluar bën tërheqjen natyrore të burimeve nga vende të ndryshme si dhe stimulon investimet private si dhe inovacionet në teknologji dhe përmirëson kualitetin e forcës prodhuese.

Një prej faktorëve të prodhimit janë edhe forca punëtore si dhe kualifikimet dhe trajnimet e tyre për punë profesionale. Shtetet e zhvilluara e përdorin forcën punëtore si aset me rëndësi dhe shpenzojnë në trajnimin dhe kualifikim, e cila forcë ndikon në rritjen ekonomike.

Qeveria e Maqedonisë përdor programe të ndryshme për stimulimin e rritjes së numrit të të punësuarëve, ajo ndan fonde për rastet sociale të cilët ndjekin kurse të ndryshme në aftësimin tyre. Sipas kalkulimeve të programës shtetërore për reforma ekonomike pritet që periudha 2018-2020 të ketë rritjen në numrin e të punësuarve prej afro 2,0 përqind. Kjo rritje planifikon që të krijoj kushte për rritjen e kërkesës për punë duke e ditur që oferta vjetore për punë është 0,8 përqind. Më poshtë kemi papunësin dhe rritjen e numrit të punësuarëve. (Grafiku 2.6).


Grafik 2.6. Rritja e numrit të të punësuarve (%) dhe shkalla e papunësisë



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ministria e Financave, nga - projekte.

Lëvizja e kësaj lloje të tregut do të ndikojë që të ulet për 19,5% numri i të papunëve deri 2020. Faktori i Përgjithshëm i Prodhimit kishte rënie mirëpo rezultoi me rritjen e numrit të të punësuarëve. Në grafikun 2.7 shohim rritjen e Faktorëve të Përgjithshëm të Prodhimit në periudhën 2010-2020. Në periudhën 2018-2020 rritja e Faktorëve të Prodhimit pritet që të jetë konstante dhe të kalon në zonën pozitive. (Grafiku 2,7).

Grafiku 2.7 Produktiviteti i punës dhe Faktorët e Përgjithshëm të Prodhimit (normat e rritjes)




Burimi: Llogaritja e Ministrisë së Financave, P-projekte

Llogaritja e outputit të potencial është baza për vlerësimin e pozicionit ciklik të ekonomisë. Në vitet e fundit sipas analizave të Ministrisë së Financave vërejmë një rritje të PBB prej rreth 3,2 përqind. Megjithatë tentativat për rritje të Produktit të

Përgjithshëm në vitin 2017 outputi në këtë kohë mbetet në zonën negative. (Grafiku 2.8).

Grafiku 2.8 Kontributi në rritjen e faktorëve të prodhimit (pp.)



Burimi: Llogaritje të Ministrisë së Financave

Më 2018 dhe 2019 hendeku negativ i prodhimit pritet të ngushtohet dhe të kalon në anën pozitive. Pra përqindja e kapitalit është relativisht e njëjtë, ndërsa përqindja e forcës punëtore pritet të ulet vitet e fundit si rezultat i globalizimit dhe migrimit të forcës punëtore në vendet tjera.

Megjithatë është politika fiskale ajo e cila ndërton rregullat e lojës. Sipas studimeve të fundit është mirë që shteti të marrë një borxh të jashtëm të arsyeshmë që tu lej hapësirë bizneseve private për humarje. Mirëpo edhe borxhi i jashtëm ka rrezik në ndryshimin e normave të interesit dhe kostoja e investimit mund të dalë më e shtrenjtë.

2.3 Studime mbi vende të ndryshme

Infrastruktura rrugore gati në të gjithë vendet e botës njihet si element bazë për një jetë normale. Globalisht studimet e kryera për infrastrukturën rrugore ndahen në dy grupe: në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim. Shumica e autorëve infrastrukturës i referohen si burim kryesor për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Prodhimi dhe infrastruktura rrugore janë komplementarë të njëri-tjetrit, sa është shumë e vështirë të imagjinosh procesin e prodhimit të të gjithë sektorëve të ekonomisë, të pavarur nga infrastruktura rrugore. Mirëpo mungesat në infrastrukturë ndjehen lehtë si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, që d.m.th ndihen në medicinë, në arsim si dhe në të gjithë sferat e jetës. Gjithashtu, studimet e kryera për 48 ekonomi të zhvilluara dhe në zhvillim treguan që, rritjet në stokun e kapitalit publik janë të lidhura ngushtë me rritjen ekonomike, duke


regjistruar efekte të forta Afat Shkurtër në vendet e zhvilluara dhe efekte Afat Gjatë në vendet në zhvillim (Gupta, 2011).

2.3.1. Studime të investimeve publike në vendet e zhvilluara

Në vitet e fundit investimet publike në output kanë rënë në shumë vende të OECD. Disa vende të eurozonës nën presionin e tregut, për të përmbushur objektivat e tyre të konsolidimit fiskal kanë ulur ndjeshëm investimet publike. Investimet publike në kapitalin fikse kanë me një mesatare prej 0.6% të PBB-së ndërmjet viteve 2010 dhe 2013 në vendet e OECD-së, duke përbërë një të katërtën e konsolidimit fiskal në këtë periudhë. (Figura 2.4) Rënia ishte shumë më e madhe në disa vende, duke tejkaluar 2.5% të PBB-së në Greqi, Spanjë dhe Irlandë dhe duke llogaritur vetëm rreth gjysmën e konsolidimit në Spanjë. Mesatarisht në vendet e OECD, çdo 1% e PBB-së konsolidohet me një shkurtesë prej 0.3% të PBB-së të investimeve publike (OECD, 2015a).

Megjithatë nivelet e fundit të shpenzimeve të infrastrukturës nuk janë shumë të ulëta në krahasim me shpenzimet kapitale para krizës (Figura 2.5), ka shumë dëshmi në shumë vende të OECD-së, përfshirë Shtetet e Bashkuara, se investimi bruto nuk ka qenë i mjaftueshëm për të kompensuar zhvlerësimin e kapitalit (Dobbs et al., 2013). Si rezultat, shumë investime kanë mbetur të pa realizuara, janë bërë shumë investime për zëvendësim dhe mirëmbajtje dhe cilësia e infrastrukturës publike është përkeqësuar, duke penguar produktivitetin dhe mundësitë socio-ekonomike (OECD, 2016b).

Figura 2.4 Investimet publike në vendet e përzgjedhura të OECD-së




Burimi: Baza e të dhënave ekonomike të OECD-së

Sipas shumë analistëve dhe studimeve të shumë vendeve të OECD-së investime afatgjata duhet bërë duke pasur parasysh ngrohjen globale dhe përmirësimin e kualitetit të ambientit. Forma të tjera të madha të investimit që duhet bërë janë, investime konstante në arsim të cilat investime do të përmirësonin kualitetin e kuadrove profesionale në të ardhmen, si dhe investime afatgjata në medicinë gjë e cila do përmirësonte kualitetin e qytetarëve dhe punëtorëve.


Përfitimet nga rritja e shpenzimeve publike në kërkimin dhe zhvillimin janë potencialisht të mëdha, veçanërisht nëse shpenzimet drejtohen në hulumtimet bazë, ku dështimet e tregut të përhapura çojnë në tërheqje investimesh nga sektori privat (OECD, 2015b).

Figura 2.5 Investimet në infrastrukturë kanë qenë të dobëta në të gjithë OECD-në



Investimet e infrastrukturës ka të ngjarë të kenë kthime të larta në vendet ku inventari fillestar i kapitalit dhe investimeve publike është i ulët (Fournier, 2016). Kjo vlen veçanërisht për Mbretërinë e Bashkuar dhe Gjermaninë. Në të kundërt, shkalla e kthimeve ka të ngjarë të jetë shumë e ulët dhe madje negative, në Japoni, ku gjendja e kapitalit publik siç është përcaktuar tashmë tradicionalisht tejkalon 100% të prodhimit potencial (Figura 2.6).

Figura 2.6 Vlerësimet e kthimit të investimeve



Linja e thyer tregon intervalin 95% të besimit. Masa e kapitalit varet nga supozimet mbi normën e amortizimit të kapitalit dhe në nivelin e ndarjes në të cilën bëhet llogaritja. Baza e të dhënave të FMN-së për seritë e aksioneve publike, të cilat mund të ndryshojnë nga burimet kombëtare, janë përdorur për të llogaritur këto vlerësime. Kjo bazë të dhënash përdoret këtu sepse stoku i kapitalit llogaritet në të gjitha vendet me të njëjtën metodologji. Pjesa gri tregon një efekt pozitiv dhe jo të rëndësishëm të investimeve dhe pjesa e errët tregon një efekt negativ dhe jo të rëndësishëm investimi.


Burimi: Fournier (2016).

Si rrjedhojë, një numër vendesh kanë njoftuar një rritje në shpenzimet e infrastrukturës publike në vitet e ardhshme. Në fund të vitit 2014, Komisioni European paraqiti Planin e tij të investimeve për Evropën i ashtuquajtur Plan Juncker – i cili kishte për qëllim zhblokimin e investimeve publike dhe private. Ajo u zhvlerësua zyrtarisht në shumën prej së paku 315 miliardë euro (rreth 2% të PBB-së së BE-së në vitin 2015) gjatë periudhës 2015-17. Në Kanada, qeveria planifikon të investojë më shumë se 120 miliardë dollarë në infrastrukturë (6% PBB) për 10 vjet (Buxheti Federal i Kanadasë, 2016). Japonia ka shpallur një paketë stimuluese për 2016-17 që përfshin shpenzimet e infrastrukturës për shekullin 21 (rreth 0,3% të PBB-së) dhe shpenzimet e rindërtimit dhe parandalimit pas tërmeteve të fundit (rreth 0,5% të PBB-së). Përveç kësaj, 1.2% e PBB-së është rezervuar për Programin e Investimeve dhe huasë fiskale, jashtë llogarive të qeverisë, për të rritur investimet në infrastrukturën private. Megjithatë, investimet publike si pjesë e PBB pritet të mbesin gjerësisht të qëndrueshme në shumicën e vendeve të OECD-së në vitet në vazhdim (OECD, 2016a).

Investimet qeveritare me deficit, të cilat janë të projektuara për të stimuluar ekonominë kan ndikim mbi PBB-në dhe vlerësohet përmes skenarësh duke përdorur tri modele makro-strukturore të cilat japin një projektim ndryshe mbi çështjen. Modeli Fall dhe Fournier (2015) (modeli F & F); makina fiskale (e ardhshme) e zhvilluar në Botev dhe Mourougane, (modeli FM), modeli makroekonomik NiGEM i zhvilluar dhe mbajtur nga NIESR. Përdorimi i disa modeleve lejon që të theksohen mekanizmat kryesor, si dhe pasiguritë rreth rezultateve.

Në këto hulumtime madhësia e paketës stimuluese është vendosur në 0.5% të PBB-së, gjë që nënkupton një rritje të vëllimit të investimit qeveritar prej rreth 15% në shtetin tipik të OECD-së. Kjo është afër mesatares së rritjes vjetore të investimeve publike të vërejtura gjatë periudhës 1995 - 2015 në vendet e OECD-së në vitet kur investimet publike u rritën (0.6% e PBB-së), (Figura 2.7).

Figura 2.7 Rritja mesatare vjetore e investimeve publike gjatë epizodave të zgjerimit të investimeve




Shënim: Vetëm rritjet e investimeve publike që janë më të larta se ¼ të devijimit standard të nivelit të pjesës së investimeve publike në PBB konsiderohen nëse nuk është pjesë e një episodi investimi më të qëndrueshëm, kështu që ndryshimet shumë të vogla të investimeve në PBB raportet që mund të jenë për shkak të lëvizjeve në emërues, përjashtohen.

Burimi: OECD Economic Outlook database.

Investimet qeveritare për disa vite u financuan me një deficit prej 0.5% përderisa arriten pikën e dëshiruar, me qëllim që deficitin të sillen deri në pikën zero më vonë. Japonia vlerësohet të mos ketë hapësirë fiskale për të financuar një stimul të tillë (Botev et al., 2016) dhe të mos ketë më vend për investime të mëtejshme publike (Fournier, 2016). Simulimet sugjerojnë se ky numër varion nga një vit në Kore në gjashtë në Irlandë ose në Mbretërinë e Bashkuar (Figura 2.8). Ky është një funksion i nivelit fillestar të vendit të rezervave të kapitalit publik, investimeve publike dhe normës së interesit ndaj diferencës së normës së rritjes, si dhe nivelin fillestar të borxhit. P.sh: sa më i ulët të jetë stoku fillestar i kapitalit, aq më e lartë është kthimi i investimeve publike dhe në këtë mënyrë një ndikim më i madh i PBB-së, që ofron hapësirë për një deficit më të gjatë.

Figura 2.8 Numri i viteve gjatë të cilave rritja e përhershme e investimeve mund të financohet me deficite të përkohshme



Shënim: Një skenar i ndryshimit të politikës nuk është krahasuar me një skenar me një rritje të përhershme të investimeve publike me 0.5% të PBB-së dhe një rritje të përkohshme të deficitit të njëjtë të shumës gjatë numrit të viteve të raportuara në këtë shifër. Numri i viteve është vendosur në mënyrë që niveli i borxhit në vitin 2040 të jetë i njëjtë në skenarin e ndryshimeve jo-politike dhe në skenarin e ndryshimeve të investimeve. Investimet publike kanë rënie të kthimeve marginale siç vlerësohet në Fournier (2016), dhe parametrat e tjerë strukturorë të vlerësuar në Fall dhe Fournier (2015) janë homogjene në të gjithë vendet. Parametrat më të rëndësishëm të vendit që mund të ndikojnë në llogaritjen janë niveli fillestar i investimeve publike, niveli fillestar i kapitalit, niveli fillestar i borxhit publik dhe norma e interesit ndaj hendekut të normës së rritjes. Llogaritja supozon se vendet kanë qasje në tregje.

Burimi: F&F model.

2.3.2. Studime të investimeve në vendet në zhvillim

Vendet në zhvillim kanë pak sa një retrospektivë tjetër nga vendet e zhvilluara. Te shumica e vendeve në zhvillim rrjeti rrugor nuk është gjithkund i njëjtë, ku vende vende duhen reparime dhe vende vende rindërtim të infrastrukturës rrugore, duke përfshirë edhe rrugët rurale të cilat nuk janë të asfaltuara fare.

Vendet në zhvillim zakonisht ndjekin rregullimet fiskale të vendeve të zhvilluara të kryera disa dekada më parë për të organizuar politika fiskale të ngjajshme që do të mundësonin të siguronin të ardhura buxhetore për investime publike. Përveç rrugëve magjistrale dhe infrastrukturës qytetare ka shumë munges në rrugët rajonale të cilat lidhin fshatrat me qytetet, të cilat rrugë ndikojnë në lëvizjen e produkteve bujqësore nga fshatrat tek qytetet.

Duke u bazuar në literaturën dhe gjetjet empirike të studimeve të huaja, FMN (2015) gjeti se në vendet në zhvillim, rritjet në investimet publike do të sillnin një rritje

të produktit përfundimtar me 0.25% në vitin që bëhet investimi dhe 0.5% pas 4 vitesh. Mirëpo për të patur rezultate të këtilla duhet që të forcohen institucionet të cilat merren me investime publike. Forcimi i këtyre institucioneve dhe të ndihmonte në përmirësimin e situatës dhe do të mbyllte gropën e ineffiçencës së investimeve publike. Prioriteti për të forcuar institucionet, që kanë për detyrë menaxhimin e investimeve publike, varet nga zhvillimi i vendeve. Vendet të cilat kanë menaxhim të lartë të investimeve publike, kanë investime më të parashikueshme, më të besueshme, më efikente dhe produktive si dhe e kundërta. Vendet e zhvilluara duhet të sigurojnë, që planet fiskale dhe buxhetore të jenë të stabilizuara dhe të konsoliduara, në nivele të larta për mbështetjen e investimeve publike. Kurse vende në zhvillim, duhet të adoptojnë rregulla dhe ligje më rigorozë për vlerësimin, përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve investuese. Me tjera fjalë tek të gjitha vendet duhet të ketë një plan strategjik kombëtar dhe buxhetim kapitali.

Duke pasur parasysh që të dhënat statistikore për vendet në zhvillim janë të limituara, janë përdorur tre qasje, të cilat japin evidencë plotësuese për efektet makroekonomike të investimeve publike në infrastrukturë për vendet në zhvillim.

1) Qasja e parë bazohet tek studimi i Warner (2014), i cili identifikon investimin si një raport domethënës të rritjes së shpenzimeve qeveritare. Njëherësh kur identifikohet viti i parë i investimit, në të njëjtën kohë fillon të zhvillohet edhe gjurmimi i variablave kryesorë makroekonomikë për periudhën një vit pas investimit. Analiza gjurmon zhvillimin e borxhit publik pas fillimit të investimit. Nga studimet nuk ka evidencë se rritet raporti Borxh/PBB në periudhën fillestare të investimit publik në infrastrukturë.

2) Qasja e dytë e studiuar nga Corsetti, Meier dhe Muller (2012) mbështetet në idenë se pjesë të rëndësishme të investimeve publike qeveritare përcaktohen nga informacioni i së shkuarës dhe nuk i përgjigjen lehtësisht rrethanave aktuale ekonomike. Kështu që, nëse parashikohen politika fiskale për investimet publike, mund të parashikohen edhe efektet e tyre. Kjo është e ngjashme me strukturën vektoriale autoregresive, që lidh ndryshimet e investimeve me hapësirat kohore, që të japin efektet dhe pritshmëritë për vitin që vjen.


3) Qasja e tretë e ndërtuar nga Kraay (2012); Eden dhe Kraay (2014) aplikohet kryesisht në vendet me nivel të ulët të ardhurash. Në shumë nga këto vende, kreditë zyrtare të dhëna nga Banka Botërore ose nga agjensitë multilaterale ose bilaterale, financojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve qeveritare. Disbursimi i kredive të dhëna për investim janë të shpërndara në shumë vite, kështu që, luhatjet e investimeve qeveritare janë të paracaktuara, dhe reflektojnë miratimet e kredive në vitet e mëparshme.

Qasjet e mësipërme sugjerojnë, që investimet publike në infrastrukturë mund të kenë efekte pozitive në produktin përfundimtar. Efekti i 1% pikë të PBB rritje në

investimet publike do të sjellë një rritje prej 0.25% të produktit përfundimtar, duke u rritur gradualisht në 0.5% pas 4 vitesh të investimit. Multiplikatori afat-mesëm është ndërmjet 0.5 dhe 0.9, pak më ulët se multiplikatori. Gjithashtu, një diferencë e rëndësishme ndërmjet këtyre dy grupeve është se efienca e investimeve publike në infrastrukturë është më e lartë se në vendet në zhvillim, por nëse krahasohen me investimet private, studimet kanë treguar se sektori privat ka investime më efiente se sektori publik. Nga kjo, del shqetësimi në lidhje me eficientësinë e investimeve publike në lidhje me investimet private dhe kontributin e tyre në rritjen afat-gjatë për vendet në zhvillim. Për këtë arsye, investimet publike në infrastrukturë, duke u bërë plotësuese e investimeve private, mund të rritë produktin marxhinal të kapitalit privat. (OECD, 1980; Blejer dhe Khan, 1984; Buffie et al. 2012; Eden dhe Kraay, 2014).

Mirëpo investimet private në infrastrukturë në Maqedoni kanë qenë të vogla. Sektori privat nuk ka qenë faktor investues shkaqë krize ekonomike, mungesë fondesh dhe prioritetesh, mungesë stimuli qeverie etj. Rezultatet empirike për Maqedoninë do na tregojnë edhe nivelin e ndikueshmërisë së investimeve publike kapitale në rritjen ekonomike.

Grafiku 2.9 Cilësia e infrastrukturës



Burimi: WEF's Global Competitiveness Index.

Nga grafiku i mësipërm shohim që Maqedonia në krahasim me vendet e tjera të rajonit qëndron mirë në cilësinë e infrastrukturës, mirëpo kjo nuk do të thotë se gjendet në pikë të mirë të zhvillimit. Dallimi ndërmjet vendeve të zhvilluara, vendeve në zhvillim dhe vendeve me të ardhura të ulëta, është se niveli real i stokut të kapitalit/frymë është shumë herë më i lartë, por niveli i investimeve publike ka qenë i ulët dhe me trend zbritës. Nga ana tjetër vendet në zhvillim kanë pasur një rritje me të ndjeshme të kapitalit publik, por mbetet ende larg standardeve për popullësinë që

jeton në këto vende. Këto vende kanë ende nevojë për investime publike pasi sektori priva nuk mund të mbulojë këto investime.

Një studim i kryer nga Kayode et al. (2013) për Nigerinë, një vend në zhvillim, i cili është zhvilluar sipas modelit të rritjes së brendshme, në të cilin investimet publike në transport hyjnë në funksionin e prodhimit si input, duke përdorur teknikën e parashikimit OLS (teknika e katrorëve të vegjël). Rezultatet e studimit treguan që transporti nuk luan rol vendimtar në përcaktimin e rritjes ekonomike. Nga ana tjetër investimet publike dhe private kanë treguar që kanë një efekt pozitiv në rritjen ekonomike afat-gjatë, por në periudhën afat-shkurtër vetëm investimet private kanë lidhje pozitive me rritjen ekonomike.

Brenneman dhe Kerf (2002) bënë një studim për të parë rritjen ekonomike të Kinës, studimi u krye midis viteve 1986-2005. Rrjeti i transportit që ato panë kishte ndikim direkt, në të ardhurat për frymë banori, në produktivitetin ekonomik dhe zhvillimin demografik.

Ndërsa (Corsetti dhe Roubini, 1997) vërtetojnë se në praktikë investimet publike në infrastrukturë nuk udhëhiqen nga prioriteti ekonomik. Raste të investimeve joefikase mund të miratohen nga qeveritë për afera korruptive apo për pikë politike. Nevoja për infrastrukturë rrugore është ende e lartë në vendet në zhvillim dhe në ato me nivel të ulët të ardhurash, si mënyrë për të suportuar zhvillimin ekonomik. Mirëpo, rritja e investimeve publike mund të sjellë një rritje të limituar të produktit përfundimtar, nëse efienca nuk përmirësohet në procesin e investimit.

KAPITULLI III

3.1 Analiza e sektorëve dhe të Ardhurat Buxhetore

Si vendë i cili gjendej në një proces tranzicioni Maqedonia u kap edhe nga kriza globale që kaploi botën. Kriza preku të gjitha sektorët shtetërorë për shkak se ato janë të lidhura me njëra tjetrën e sidomos nga buxheti qeveritar. Kriza ndikoi në uljen e prodhimit, uljen e kreditimit, rënies së likuiditetit si dhe shtrëngimit të politikave nga ana e qeverisë, uljes së remitançave, uljes së prodhimit etj.

Në këtë gjendje krize Maqedonia filloi që të marrë hapa për ripërtirjen ekonomike dhe sjelljen e investitorëve të huja në disa sektorë duke i shitur disa kompani jolikuide qeveritare. Nga ana tjetër arriti që të privatizonte disa kompani të mëdha qeveritare, duke i ndarë në aksione me qëllim që të bliheshin nga investitor vendas, dhe të stabilizonte sadopak politikën fiskale. Një tjetër problem, që lidhet me investimet publike është borxhi publik, pasi një pjesë e investimeve kryhet me financim të jashtëm, duke shkaktuar rritje të borxhit. Ku në të shumtën e rasteve nga

paqartësitë e preferencave të qeverisë në të ardhmen, mund të ndikoj politikë-bërësit që të kalojnë në deficit buxhetor.

3.1.1 Përshkrim i përgjithshëm i sektorëve

Për të përshkruar sektorët duhet parë se çfarë politikash investimi ka qeveria, si dhe cili është raporti i investimeve publike në krahasim me investimet private. Investimet publike për të qënë efikase duhet që të analizojnë edhe gjendjen e kapitalit privat dhe të ruajnë interesin e investitorëve privat duke u ofruar kushte të volitshme dhe duke mos i penguar.

Investimet publike mesatarisht janë në 3,2% të PBB, kushtet investimet në infrastrukturën rrugore sillen 70 – 80% të investimeve publike. Investimet publike kryhen me fonde nga buxheti shtetëror sipas sektorëve prioritarë, fondet janë nga borxhi i jashtëm dhe i mbrendshëm. Financimi i investimeve me borxh sjell deri tek rritja e shpejt e borxhit. Si rrugëdalë nga borxhi i pakontrolluar ekonomistët (Dur et al. 1997), të cilët si lehtësim vendosën që të imponojnë një rregull kufizues për borxhin. Ata argumentojnë se luhatjet e borxhit nuk eliminohen me vendosjen e rregullit kufizues, gjë që u mundëson sjellje të ndryshme strategjike politikanëve me hapësirën e këtyre luhatjeve. Me këtë hap manipulimi strategjik zhvendoset nga borxhi publik në investimet publike. Autorët testuan efektet e një rregulli për huamarrje kapitale, i cili lejon qeverinë të kalojë në një **deficit buxhetor, të barabartë me sasinë e investimeve publike**. Ky kufizim eliminon borxhin e keq dhe tejkalimin e deficitit e sidomos në mënyrë efikase eliminon sjelljet strategjike të politikanëve.

Shumë ekonomistë janë munduar të sqarojnë se pse politikë-bërësit sillen në mënyrë kaq të pa përgjegjshme në lidhje me shpenzimet buxhetore. Studimet tregojnë se, akumulimi i borxhit mund të ekzistojë nga luhatjet në procesin e politikë-bërjes. Argumenti bazë është, që borxhi publik mund të përdoret nga partia në pushtet për të siguruar pozitë favorizuese në të ardhmen. Mirëpo autorët, Tabellini dhe Alesina (1990) tregojnë se, nëse qeverisja e partisë në pushtet është e paqartë, për mandatin pasardhës, atëherë kjo qeveri tenton të akumulojë borxh. Duke pasur dorë të lirë në deficit partia në pushtet mund të shpenzojë për mallra publik tani, në kurriz të konsumit publik në të ardhmen. Pasiguria për mandatin e ardhshëm i shtyn partitë politike që të shpenzojnë shumë. Nëse do të caktoheshte ndonjë kufi deficitit, ku niveli i borxhit të ishte i barabartë me vlerën e tij optimale sociale, atëherë partia në pushtet do të frenonte shpenzimet e saja. Kështu që, pas caktimit të rregullit kufizues, politikë-bërësit nuk mund të përdorin më deficitin për financime strategjike. Megjithatë politikë-bërësit do të përdorin instrumenta të tjerë, si psh. uljen e investimeve publike, për të zbutur shtërngimin e buxhetit në kurriz të të ardhurave në të ardhmen. Pra shohim që me vendosjen e rregullit kufizues, mund të ndodhë reduktim i investimeve.

Autorë të tjerë si (Milesi dhe Ferreti, 1997; Alesina dhe Perotti, 1996) ishin kundër rregullit kufizues të borxhit, shkaku që ky rregull nuk i merrte parasysh stabilizuesit e borxhit dhe ndalonte qeverin për luhatje taksash si përgjigje të goditjeve të paparashikuara. Caktimi i një rregulli ku deficietet buxhetore do të kishin hapësirë të luhaten brenda disa kufijëve të caktuar ishte e pranueshme, mirëpo kjo mund të sillte probleme në monitorimin e kufizimit dhe deficitit.

Rregulli alternativ i cili u gjet për këtë është ai i cili lejon **deficit i cili do ishte i barabartë me investimet**, dhe ky rregull u quajt **“rregulli i artë i financimit qeveritar”**, i cili përdoret në SHBA dhe komunat e Gjermanisë. Praktikisht rregulli është kështu: çdo dollarë shtesë borxh, duhej të shoqërohej me po aq dollar shtesë investime, dhe çdo dollar investim më pak, duhej të nivelizohej me po aq dollar më pak borxh. Nga kjo politikanët nuk mund të rrisin borxhin e konsumit aktual në kurris të kpnsumit në të ardhmen për pa i rritur investimet me po atë vlerë të borxhit të marrë. Kështu që me një politikë fiskale të caktuar mirë, rregulli i huamarrjes kapitale mund të rrisë mirëqenien e qytetarëve në të ardhmen. Kjo mvaret nga kostot e lidhura me luhatjet politike të cilat duhet të jen përcaktuar lart që të tejkalojnë çdo krizë dhe të kompensojnë për çdo rënie të mirëqenies. Ky rregull më së shumti i përshtatet atyre shteteve me sistem politik jo të stabilizuar dhe me një shkallë të lartë të polarizimit të partive politike.

Studime të tjera tregojnë se, deficitit dhe borxhi publik vijnë si rezultat i shpenzimeve qeveritare të pa mbuluara financiarisht, si dhe ç’balancimit financiar të llogarive të subjekteve ekonomike. Për shkak të hapjes ekonomike dhe krizës globale, problemi i borxhit dhe deficitit mori përmasa shqetësuese. Ndërsa për vendet e Ballkanit, autorët argumentuan se lidhja e shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike ende mbetet e paqartë. Ndërkohë, shpenzimet kapitale publike, grantet, investimet private dhe hapja e tregut kanë lidhje pozitive me rritjen ekonomike, ndërsa forca punëtore nuk ka efekt sinjifikativ në rritjen ekonomike (Sever et al. 2009; Alexiou, 2009).

Për të eksportuar vendet e ballkanit nuk kan cilësinë konkurente të prodkteve që kanë shtet e zhvillura shkaku i teknologjisë së vjetëruar. Poashtu edhe normat e larta të huave dhe burimet e financimit janë reduktuar në mënyrë drastike.

3.1.2 Analiza e sektorëve

Vetë strukturimi ekonomik në çdo shtet është i ndar në sektorë të ndryshëm, të cilët ndikojnë në ekonomi për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Prioriteti i çdo qeverie është rritja e mirëqenies dhe reduktimi i varfërisë. Maqedonia si vend në tranzicion ka ndjekur politika shtërnguese makroekonomike për rritjen e ekonomisë vendore dhe numri i varfërisë gjithnjë ka qenë i theksuar. Krizat e mëdha ishin ajo e viteve 90-ta kur hyri në procesin e tranzicionit dhe ajo e krizës globale (2007-08). Më pas ekonomia filloi ta marrë veten nga (2009-2016) u ulë disi varfëria, megjithatë

edhe përsëri uljes së varfërisë prap mbeten rreth 100,000 që edhe sot e kësaj dite jetojnë në varfëri ekstreme.

Tabela 9. Konsolidimi i Buxhetit të përgjithshëm (në miliona denarë)

	2018	2019	2020
Buxheti i konsoliduar i qeverisë së përgjithshme - Të ardhurat	206,262	216,040	228,225
% e PBB	31.1	30.7	30.5
Buxheti i konsoliduar i qeverisë së përgjithshme - Shpenzimet	224,495	233,969	245,100
% e PBB	33.8	33.3	32.8
Buxheti i konsoliduar i Qeverisë së Përgjithshme - Deficiti	-18,233	-17,929	-16,875
% e PBB	-2.7	-2.5	-2.3
Buxheti qendror - të ardhurat	116,545	122,616	131,125
% e PBB	17.6	17.4	17.5
Buxheti qendror - shpenzimet	134,778	140,545	148,000
% e PBB	20.3	20.0	19.8
Buxheti qendror - deficiti	-18,233	-17,929	-16,875
% e PBB	-2.7	-2.5	-2.3
Fondet e Buxhetit - të ardhurat	57,420	60,772	64,323
% e PBB	8.6	8.6	8.6
Fondet e Buxhetit - shpenzimet	57,420	60,772	64,323
% e PBB	8.6	8.6	8.6
Fondet e Buxhetit - deficiti	0	0	0
% e PBB	0.0	0.0	0.0
Buxheti i qeverisë lokale - të ardhurat	32,297	32,652	32,778
% e PBB	4.9	4.6	4.4
Buxheti i qeverisë lokale - shpenzimet	32,297	32,652	32,778
% e PBB	4.9	4.6	4.4
Buxheti i qeverisë lokale - deficiti	0	0	0
% e PBB	0.0	0.0	0.0

Burimi: Ministria e Financave

Më lartë (Tabela 9) kemi konsolidimin e Buxhetit të Përgjithshëm në milion denar, Buxhetin Qendror, Fondet e buxhetit dhe Buxhetin e Qeverisë Lokale, ku në të gjitha këto shpjegohen me të ardhurat e çdo buxheti shpenzimet dhe deficiti apo suficiti i çdo buxheti në veçanti.

Kohëve të fundit pas krizës globale kemi një rritje të ngadalshme ekonomike, rritja nuk është sipas analizave të parashikuara mirëpo është më e ulët. Megjithatë rritja e ngadaltë rezulton edhe në rritjen e numrit të të punësuarëve e cila ndërmjet periudhës 2018-2020 pritet që të arrihet mesatarisht në 2.0%. Ndërsa mesatarja e rritjes së kërkesës për forcë punëtore do të jetë mesatarish 0.8%. (Grafiku 2.6).

Nga (Grafiku 2.6 nga kapitulli paraprak) shohim që 2010 periudha menjëherë pas krizës globale papunësia ka qenë e lartë deri më 2016 ku rritet numri i të punësuarëve dhe bie papunësia. Viti 2017 dhe 2018 vazhdojnë të kenë rritje të ngadaltë ekonomike dhe ulje të papunësis dhe gjithashtu pritet që edhe 2019 dhe 2020 të vazhdohet me këtë tempo të uljes së papunësisë.

Çdo shtet kur bën analiz makroekonomike është i interesuar se a shkon në zhvillim ekonomia vendore. Një nga elementet e shtumta me të cilat bëhen analizat makroekonomike të një vendi është edhe eksporti i produkteve vendore në vendet e jashte, duke e ditur se nëse importi është më i madh se eksporti atëherë shteti çdo dit e më shumë thellohet në borxhe dhe se në një të ardhme duhet kontrolluar kjo situatë.

Nga këtu shteti i Maqedonisë është i interesuar që të inicojë rritjen ekonomike dhe të rrisë standardin jetësor të qytetarëve duke i mbështetur kompanitë vendore si dhe duke ndihmuar në nxitjen e kërkesës si dhe duke përmirësuar sistemin e sigurisë sociale. Situata që u parapa që ekonomia të pëson rritje më 2018 përkundër vitit 2017 gjë që do të stabilizonte faktorin politik dhe do u jepte siguri investitorëve. Rritja e pagave dhe punësimit në sektorin privat, mbështetur nga masat e qeverisë, të shoqëruara me pritjet e inflacionit të ulët dhe të qëndrueshëm në vend, do të kontribuojnë në rritjen e konsumit privat.

Tabela 10. Krahasimi i parashikimeve për rritjen e PBB-së dhe inflacionin për Maqedoninë


Institucioni	Rritja reale e PBB-së (%)				Shkalla e inflacionit (%)			
	2017	2018	2019	2020	2017	2018	2019	2020
Fondi Monetar i Maqedonisë (FMM)	1,9	3,2	3,4	3,6	1,2	1,7	1,9	2,0
Banka Botërore	1,5	3,2	3,9	/	0,9	1,6	2,0	/
Komisioni European	1,7	2,7	3,2	/	1,2	2,0	2,4	/
Banka Europiane për Financ-Zhvillim	1,5	2,5	/	/	/	/	/	/
Instituti i Vienës	1,8	3,1	3,4	/	1,0	1,5	2,0	/
Baka Popullore e RM	0,5	3,2	3,5	/	1,3	2,0	2,0	/
Ministria e Financave	1,6	3,2	3,5	4,0	1,4	1,7	2,0	2,0

Burimi: FMM (Article IV Consultation, tetor 2017), **Banka Botërore** (Southeast Europe Regular Economic Report, nëntor 2017), **Komisioni European** (European Economic Forecast, nëntor 2017), BEZHF (Regional Economic Prospects, nëntor 2017), **Instituti Venez** (Forecast Report, nëntor 2017) dhe **BPRM** (Raporti tremujor, nëntor 2017).

Nga (Tabela 10) shohim që rritja reale e PBB më 2018 është 3.2% dhe që është shumë mirë në krahasim me vitin 2017 që ishte 1.9%. Nga parashikimet shohim që vitin 2019 pritet që të kemi rritje të ngadaltë prej 3.4% dhe 3.6% në vitin 2020.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tjetra anë janë pjesë kyçe e politikës fiskale duke rregulluar politika monetare dhe instrumenta të tjerë për harmonizimin e këtyre parametrave dhe mbajtjen e një suficiti apo defici të vogël. Rregullimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore solli në një rritje të PBB-së prej 3.2% më 2018, poashtu sipas analizave pritet një rritje prej 3.5% më 2019 dhe 4.0% më 2020. Më poshtë kemi (Grafikonin 3.1) të fakëtorëve të rritjes së PBB-së.

Grafiku 3.1 Struktura e rritjes së rrjedhës PBB (kontribut në rritje)



Burimi: Llogartija e Ministrisë së Financave, duke u bayuar nga të dhënat e Entit Shtetëror për Statistikë

Të tjerë parametra për tu përmendur janë: totali i të ardhurave buxhetore, bilanci fiskal (borxhi i brendshëm dhe i jashtëm), bilanci i pagesave dhe kursi i këmbimit, totali ishpenzimeve dhe rritja ekonomike, shpenzimet kapitale dhe rritja ekonomike, Shpenzimet kapitale dhe burimet e financimit, shpenzimet publike sipas sektorëve etj, mirëpo këto detaje do ti përmendim ne një studim tjetër.


3.2 Plani i Investimeve Publike në infrastrukturën rrugore të Maqedonisë

Investimet dhe zhvillimi i infrastrukturës janë të lidhura ngushtë me qëndrueshmërinë e borxhit dhe efikasitetin e investimeve. Maqedonia sikurse edhe shumë vende të Ballkanit Perëndimor janë nën fokusin dhe asistimin e vendeve Perëndimore Europiane për zhvillim infrastrukturor, që do u ndihmonte këtyre vendeve në integrimin në tregjet Europiane dhe zhvillimin ekonomik. Një numër i madh i ekonomistëve që janë marrë me faktorin e investimeve publike mendojnë që kufiri minimal dhe maksimal i investimeve publike duhet të sillet nga 15 – 25% të të ardhurave kombëtare. Mirëpo pjesa më e madhe e ekonomistëve bashkëkohor mendojnë se nuk mundet të vendoset kufi dhe se norma e investimit varion gra shteti në shtet dhe nga kushtet makroekonomike, shkalla e zhvillimit dhe nevoja për investime publike.

Të ardhurat e projektuara të buxhetit të konsoliduar të qeverisë në periudhën trevjeçare tregojnë një rënie relative në raport me PBB-në, nga 31.1% e PBB-së në 2018 deri në 30.5% në vitin 2020. Si rezultat i vazhdimësisë në zbatimin e politikës buxhetore të disiplinuar dhe kontrollit të shtuar të shpenzimeve publike, shpenzimet totale në periudhën 2018-2020 do të arrijnë një reduktim, nga 33.8% në 2018 në

32.8% në 2020. Politikat themelore fiskale të vendosura në periudhën e ardhshme ofrojnë një reduktim gradual të nivelit të deficitit të përgjithshëm buxhetor dhe pozicionimit të tij në nivelin 2.5% të PBB-së së planifikuar në 2019 dhe 2.3% të PBB-së në 2020. (MF- Ministria e Financave 2018). Foto 1 kemi strukturën buxhetore të Republikës së Maqedonisë.

Figura 3.0 Struktura e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë



Përgatiti: Të punësuarit e Bankës Botërore

Është interesante që zhvillimi i shumë sektorëve mvaret nga çështje strukturore të cilat e pengojnë aktivitetin privat si psh, taksat të cilat nga ana tjetër ndihmojnë në zvoglimin e deficitit buxhetor mirëpo japin efekt negativ në investimet private. Maqedonia vuan nga taksimi i lartë me qëllim të avancimit të disa sektorëve të cilët janë të nevojshëm për zhvillim, mirëpo nga ana tjetër dekurajon shumë sektorë të tjerë të investimit dhe punësimit. Gjithashtu është me rëndësi fakti se Maqedonia ka mundësi për zhvillimin dhe efikasitetin e investimeve publike shkaku që është vend kyç në ballkan ku shumica e rrugëve tranzite kalojnë pikërisht nëpër Maqedoni sidomos ato nga portet Greke drejt Sërbisë dhe nga ana tjetër lidh Shqipërinë me Bullgarinë, pra udhëkryqi i Ballkanit gjendet pikërisht në Maqedoni.

Që nga viti 1995 Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë themeloi bazën e të dhënave të projekteve investive për infrastrukturën publike, në bazë të të dhënave të informatave që jepen nga ministritë përgjegjëse dhe të cilat vazhdimisht inovohen. Mirëpo përgjat përgatitjes së programës për investim publik, për shkak të tranzicionit që përjetonte vendi gjithashtu reformimi i proceseve të sektorit publik kërkonin që të ndërrohet metodologjia e planifikimit të investimeve publike dhe ndjekjes së zhvillimit të tyre, për çka Banka Botërore dhe Unioni European nëpërmjet programit PHARE siguruan mbështetje të përshtatme teknike për Maqedoninë.

Që nga viti 2007 Qeveria e Maqedonisë rriti investimet publike prej 3% deri më 5% të PBB-së, përafërsisht sa ishte mesatarja e vendeve të posa antarësuar në Unionin European. Investimet në infrastrukturë janë me rëndësi vitale për:

- ❖ Uljen e papunësis dhe varfërisë
- ❖ Rritjen e konkurrencës së ekonomisë nacionale
- ❖ Rritje më të madhe ekonomike
- ❖ Balansim në zhvillimin rajonal dhe rritja e shancës së vendit për integrimin European.


Kështu Qeveria e Maqedonisë duke i parë investimet publike si gjeneratorin kryesor të zhvillimit, bëri reforma në sistemin juridik dhe përshtati ligje anti monopol. Duke parë rëndësinë e infrastrukturës rrugore Qeveria e Maqedonisë viteve të fundit është munduar që të riparoj dhe ndërtojë një infrastruktur më të mirë për të përmirësuar kushtet për një zhvillim më të shpejtë, të cilat investime është dashur që të kryhen me optimalizimin e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese, si dhe më shpejt të mbarojë projektet e nisura deri më tani duke pasur parasushë shpenzime më të vogla. Vështirësia e problemeve me të cilat ballafaqohet vendi dhe thellësia e ndikimeve që duhet të realizohen, në kushtet e mungesës së fondeve të veta dhe mundësive të kufizuara për huamarrje jashtë vendit, kërkojnë më shumë angazhim intenziv të kapitalit të huaj, mbi të gjitha, me investime direkte, investime të përbashkëta, koncesione, donacione, si dhe huamarrje selektive jashtë vendit, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik. Për këtë qëllim është krijuar Agjensia për Investime të Huaja.

Gjatë përgatitjes së Programit të Investimeve Publike për Republikën e Maqedonisë 2007-2009, në përcaktimin e nevojave prioritare, Qeveria mori parasysh politikat e zhvillimit sektorial, dokumentacioni i disponueshëm i projekteve dhe mundësitë reale për sigurimin e fondeve për investime kapitale nga:

- 1) Buxheti i Shtetit
- 2) Fondet
- 3) Fondet e investitorëve
- 4) Donacione
- 5) Kreditë e huaja, në përputhje me strategjinë afatmesme për menaxhimin e Borxhit Publik.

Koheve të fundit fokusi i politikës fiskale është që të përmirësojë gjendjen ekonomike të vendit dhe me atë edhe të rrisë standardin jetësor të qytetarëve. Me qëllim për të mbajtur efekte pozitive të rritjes ekonomike, vitet e ardhshme pritet që një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të shkonë në investime publike. Investimet publike të cilat përfaqësojnë komponentën e zhvillimit të politikës fiskale, do të vazhdojnë të kenë rëndësi prioritare. Në vitet e kaluara investimet kapitale nga Buxheti i R.Maqedonisë plotësisht e treguan efektivitetin e tyre, dhe ndjeshëm ndikuan në përmirësimin e krizës ekonomike. Në kuadër të fondeve buxhetore të alokuara për shpenzime kapitale, investime të konsiderueshme janë investuar për përfundimin e pjesës së mbetur të autostradës dhe infrastrukturës hekurudhore, infrastrukturës energjetike dhe komunale, si dhe investime kapitale për të përmirësuar kushtet në arsimin, sistemin social dhe shëndetësor, bujqësinë, mbrojtjen e mejdisit hapsinor dhe sistemit gjyqësor. Grafiku 3.2 kemi shpenzimet kapitale të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2005 – 2018.


Grafiku 3.2 Shpenzimet kapitale të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë



Burimi: Qeveria e Maqedonisë - Strategjia fiskale e R.Maqedonisë 2015

Qeveria e Maqedonisë menjëher pas zgjedjeve 2014 filloi me të shpejtë zbatimin e komponentave kyçe të investimeve publike. Investimet gjithpërfshirëse të Qeverisë së Maqedonisë kapën vlerën prej rreth 4.5 miliardë EUR gjegjësisht rreth 8% të PBB-së seicilin vit prej 2014 – 2019. Përfituesi kryesor i programit të investimeve është infrastruktura e transportit, e cila përbën rreth gjysmën e të gjitha investimeve (Qeveria e Maqedonisë , 2015). (Grafiku 3.3).


Grafikoni 3.3 Shpenzimet sektoriale të programit qeveritar (në milion EUR)



Burimi: Programi i Qeverisë, Prill 2014 dhe llogaritjet e Bankës Botërore.

Përviç investimeve publike në infrastrukturën e shkatrruar rrugore, të cilat ndërtim janë planifikuar dhe filluar prej fillimit, Buxheti i Qeverisë së Maqedonisë ka ndërrmarë masa paraprake për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese.

Grafiku 3.4 Struktura e punimeve publike të realizuara



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe punonjësit e Bankës Botërore

Grafiku 3.4 na tregon strukturën e punimeve publike ku shohim që prej 2002 – 2014 investimet në infrastruktur dhe industri kanë tërënjekur pjesën më të madhe të investimeve publike.

3.3 Shpronësimet / Koncesionet

Shpronësimet dhe koncesionet janë një ndër pjesët më të ndjeshme të projekteve infrastrukturose sepse vonojnë skedulet e ndërtimit dhe shtojnë koston e ndërtimit të projektit. Problematika që lidhet me nivelin e investimeve publike në infrastrukturën rrugore është pikërisht shpronësimi dhe mos-regjistrimi i plotë i investimeve publike të financuara me burime të huaja, duke ulur transparencën dhe mos llogaritjen e saktë të burimeve financiare të buxhetit. Ligjet për shpronësimet të publikuara në “Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 95/2012, 131/2012, 24/2013, 27/2014, 104/2015, 192/2015, 23/2016 и 178/2016 janë ligje në bazë të të cilave kryhen procedurat e kalimit të pronës prej personave juridik në pronësi të shtetit, ku i shpronësuar duhet të sistemohet dhe të kompensohet për të shmangur varfërimin e tij dhe humbjen e jetesës së mëparshme. Procedurat e shpronësimit kanë fazën e konsultimeve dhe kontaktimeve, fazën e përgatitjes së planit të kompensimit dhe shpronësimit dhe fazën e rënies dakord. Por, një nga problemet kryesore ishte nisja e fillimit të disa projekteve infrastrukturore, pa i kaluar dhe verifikuar të gjitha fazat e shpronësimit dhe kompensimit. Kjo situatë solli edhe ngërçin e vazhdimin të punimeve dhe bllokimin e kompensimeve. Në shumë zona, ku shpronësoheshin toka bujqësore, pati reagime të forta nga ana e të prekurve, duke lënë pezull ndërtimin e rrugëve (p.sh Autostrata Kërçovë-Ohër dhe Milladinovci-Shtip).

Problemet më të shumta gjatë shpronësimit janë përmendur më poshtë:

- Shpronësimet në zonat e banuara apo zona bujqësore
- Ofrimi i çmimeve të ulëta nga ana e përfaqësuesve qeveritar
- Vonesat në dëmshpërblimin e pronave (tokë+banesë)
- Mungesa e Çertifikatave të pronësisë i kanë privuar fermerët nga e drejta e shpronësimit

Një mënyrë për të rritur efikasitetin, cilësinë dhe sasinë në shërbim të infrastrukturës, është promovimi i Konçensioneve ose Partneritetit Publik-Privat, si mënyrë për të ulur kostot. Kur PPP përdoren efektivisht, ato mund të sjellin ulje të shpenzimeve dhe rritje të kursimeve. Nën përcaktimin e një PPP, një firmë mund të ofrojë financim, ndërtim, mirëmbajtje të veprës publike në shkëmbim të një tarife ose pagese të kryer nga qeveria përgjatë viteve të nënshkruara në kontratë. PPP mund të ofrojnë avantazhe sinjifikative në krahasim me prokurimet tradicionale publike, në terma të përdorimit të fondeve private financiare, promovimin dhe përdorimin më eficient të fondeve publike si dhe përmirësimin e cilësisë së investimeve. Edhe pse financimi privat është tipikisht më i shtrenjtë se huamarrja qeveritare, duhet një përpilim i kontratës me kushte, ku detyrimet e firmës private dhe të shtetit të jenë efikente për të rimarrë investimin e kryer gjatë viteve të ardhshme. Gjithsesi, jo të gjitha investimet mund të jenë efikente, duke përdorur PPP. Përfitimi nga përdorimi i

PPP vjen nga aftësia e qeverisë të menaxhojë riskun efektivisht, nëpërmjet palëve publike dhe private, në mënyrë që të sigurojë nxitësit e duhur, duke ulur kostot e përgjithshme të projektit të investimit. Për ta bërë këtë, duhet që produkti përfundimtar dhe cilësia e shërbimeve të jetë e parashikueshme dhe e matshme përgjatë zhvillimit të projektit. PPP kërkon ligje të forta, vlerësim, aprovim dhe marrëveshje monitorimi, në mënyrë që negocimi i kontratës të sigurojë dhe të qartësojë palët për detyrimet e tyre (FMN, 2015).

Evidenca se kur PPP kanë qenë të suksesshme dhe efikente në krahasim me tenderimet publike është mikse. Përfitimet nga PPP varet ndjeshëm nga vendet dhe llojet e projekteve të investimit. Në shumë vende ndodh, që prokurimi të jetë si PPP, jo për arsye efieçence, por për të frenuar zgjatjen e procedurave dhe koston financiare për shërbimet që do ofrohen. PPP shihet si mënyrë më e shpejtë dhe më pak e kushtueshme për ofrimin e shërbimeve sociale, edhe pse në disa raste, PPP mund të rezultojë me kosto të larta fiskale, për shkak të hartimit të dobët të kontratave, supozimeve tepër optimiste për realizimin e të ardhurave nga tarifat, që do të vendosen për shërbimin publik, si dhe minimumin e garancisë të dhënë nga qeveria (Schwartz et al. 2008; Engel et al. 2014).

Në rastin e Maqedonisë do të ishte më mirë sikur të silleshin ligje me adekuate të shpronësimit dhe të formohej një komision adekuat qeveritar për vlerësim të pronave që të evitoheshin shumë raste gjyqësore dhe të shkurtohej koha e pritjes në shumë pika të caktuara, në të cilat pika pronarët nuk pranojnë çmimet e ofruara nga përfaqësuesit shtetëror, rasti është paraqitur në gjyq dhe seancat gjyqësore vonojnë në zgjidhjen e shpejtë të rastit.

3.4 Partenriteti Publuk Privat

Mungesa e efikasitetit në sektorin publik dhe hapsira e pamjaftueshme fiskale e bëjnë tërheqës financimin privat të investimeve në infrastrukturë. Interesi i PPPsë u rrit gjatë krizës ekonomike dhe pamundësis së shteit në investim në infrastrukturë për plotësimin e kërkesës për standard më të mirë jetësor. Iniciativat e partneritetit publik-privat (PPP) mund të jenë një opsion i mundshëm për të mobilizuar kursimet private, për të rritur efikasitetin dhe për të siguruar fonde. Në masën që PPP-të vetëm vonojnë shpenzimet buxhetore, ato nuk ndryshojnë vlerën aktuale neto të shpenzimeve qeveritare. Sidoqoftë, PPP-ja mund të ofrojë përfitime të tjera nëse është mirë planifikuar dhe menaxhuar. Në mënyrë të veçantë, PPP-të kombinojnë shkathtësitë dhe burimet e sektorit publik dhe privat nëpërmjet ndarjes së rreziqeve dhe përgjegjësiive. Kjo u mundëson qeverive të përfitojnë nga ekspertiza e sektorit privat dhe u lejon atyre të përqëndrohen në politikë, planifikim dhe rregullim duke deleguar operacionet e përditshme. PPP-të vijnë në lloje të ndryshme me shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes së sektorit privat në projekte, duke filluar nga menaxhimi dhe kontratat operative në sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndarjen e pjesshme të aseteve publike. (FMN, 2018). (Figura 3.1 më poshtë).


PPP mund të arrijnë ulje të kostos nëpërmjet teknikave të inovacionit, të cilat mund të ndryshojnë projektimin e veprave publike dhe të përdorin teknika të ndryshme ndërtimi. Në këto raste kërkohet një liri në kontratën e nënshkruar, e specifikuar me detaje për ndryshimet që ofrohen. Në shumë raste, kostot e projekteve janë ulur me 1/3 për shkak të inovacioneve, që PPP sjell në ndërtimin e veprave publike, edhe pse qëllimi për të ulur kostot dhe përdorur inovacionet në disa projekte është shumë i vogël (OECD, 2013).

Një tjetër faktor, që ndikoi në ekonomi dhe sektorin privat është kriza financiare, e cila detyroi sektorin bankar për rikapitalizim. Kjo do të thotë se bankat, kryesisht ato të investimit, kanë më pak kapital të vlefshëm për kredi financimi të projekteve publike me ndërmjetësimin e PPP. Kjo ka sjellë dhe një reduktim të pjesëmarrjes së PPP në investimet publike. Në këto kushte, kur Banka Qëndrore ka ulur ndjeshëm normat e interesit për të stimuluar kreditimin e ekonomisë, kërkesa nga ana e sektorit privat mbetet në nivele të ulëta. Kjo do të thotë, që stimuli nga politika monetare nuk dha efektet e parashikuara dhe kërkohet detyrimisht ndërhyrje qeveritare me anë të politikës fiskale për reduktim të barrës fiskale të sektorit privat, si një nxitës për rritjen e investimeve private dhe pjesëmarrjen e tij në ndërtimin e veprave publike.

Nga ana tjetër, qeveritë kanë kufizimet e tyre për shpenzimet publike, për shkak të defiçitit të lartë dhe borxhit publik tej normave të lejuara. Në këto kushte, qeveritë kërkojnë rritje taksash dhe tarifash, ulje të shpenzimeve publike, si mënyrë për të reduktuar defiçitin dhe borxhin. (Sorina Koti, 2016).


Megjithatë, investimet e PPP-së, përfshijnë rreziqet fiskale në të gjitha fazat e ciklit të projektit, duke përfshirë përgatitjen e buxhetit, prokurimin, financimin dhe menaxhimin e kontratave të bazuara në performancë. PPP-të mund të gjenerojnë detyrime kontingjente të qarta dhe të nënkuptuara (për shembull, garancitë), dhe inkurajojnë jashtë bilancit operacionet që reduktojnë transparencën.

Figura 3.1 Llojet e Marrëveshjeve të Partneritetit Publiko-Privat



Është e dukshme që në Studimet e Vlerësimit të Menaxhimit të Investimeve Publike për Ballkanin Perëndimor, rezultatet për menaxhimin e PPP-ve ishin ndër më të këqijat (Figura 3.2).

Figura 3.2. Vlerësimi i Menaxhimit të Investimeve Publike



Burimet: Baza e të dhënave FAD PIMA; dhe FMN EUR REI, nëntor 2016.

Shënim: CEE = Europa Qendrore dhe Lindore; SEE-EU = Anëtarët e BE-së në Evropën Juglindore; SEE-XEU = Jo-anëtarë të BE-së në Evropën Juglindore.


Do të jetë e rëndësishme që qeveritë të marrin drejtimin në planifikimin dhe menaxhimin e PPP-ve për të siguruar që përfitimet e tyre të mundshme të realizohen, duke i menaxhuar shpenzimet dhe rreziqet e tyre fiskale. Pesë elementet kyçe për sigurimin e suksesit të qeverisë në PPP-në përfshijnë:

- 1) Planifikimi i shëndoshë dhe përzgjedhja e projektit.
- 2) Institucione të forta fiskale me kontroll të mjaftueshëm të ministrisë së financave në secilën fazë të procesit të PPP-së, duke përfshirë rinegociimin e mundshëm të kontratës.
- 3) Korniza ligjore të forta.

- 4) Buxhetim të fortë, kontabilitetit të mirë dhe praktika të raportimit.
- 5) Analizën e duhur të rrezikut fiskal në nivel projekti. (FMN, 2018).

Përvoja e rajonit me partneritetet publike-private ka qenë e kufizuar, por ka të ngjarë të rritet në periudhën në vijim. Përvoja me projektet e PPP-së ka qenë e kufizuar për shkak të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë madhësinë e vogël të tregjeve kombëtare, kornizat e papërshtatshme ligjore dhe institucionale dhe rreziqet rajonale të perceptuara politike (Gjebrea dhe Zoto 2014). (Figura 3.3)

Figura 3.3 Iniciativat e PPP në Ballkanin Perëndimor



Burimet: FMN, baza e të dhënave FAD; dhe llogaritjet e stafit të FMN-së.
Shënim: PPP = Partneritet publik privat.

Kapaciteti i kufizuar i qeverisë për të bërë angazhime të besueshme afatgjate gjithashtu është fajësuar për "shkallën e lartë të shuarjes së PPP-së", siç tregohet nga tendenca për të nisur PPP për projekte që nuk janë mjaft të pjekura ose janë përgatitur dobët (shih Epec 2014). Në të ardhmen procesi i integritetit në EU mund të eliminojë shumë rreziqe politike, ndërsa integrimi rajonal mund ta bëjë tregun më fleksibil dhe të hapen tregje të reja të bashkëpunimit rajonal. Planifikimi i integruar për Ballkanin perëndimor në sektorët e rrugëve, transportit dhe enegjisë mund të rezultojë në tërheqjen e investitorëve të huaj dhe vendas. (FMN, 2018).

3.5 Dividendët ekonomik të zhvillimit të Infrastrukturës


Kur kemi investime në infrastrukturë në shtete të cilat gjenden ende në fazën e zhvillimit, nuk mund ti paramendojmë pa rritje të borxhit. Së pari ne do të shohim shkakum e rritjes së përgjithshme të borxhit kur kemi iniciativë të investimeve

publike. Gjithashtu me regres panelin do shohim boshllëqet e investimeve publike në infrastrukturë.

Stimulimet e bëra gjat viteve të fundit kanë dhënë rezultat në iniciativën e ndërmarrë nga qeveria për investim në infrastrukturë me 15% të PBB-së. Për investimet në infrastrukturë në Ballkanian Përrëndimor Buffe 2012 themeloi një kuadër për të studiuar ndërveprimet dinamike të variabëve kryesor në skenarë të ndryshëm. Kostot e huamarrjes së jashtme supozohet të pasqyrojnë përhapjen aktuale të rajonit dhe kushtet normale të likuiditetit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Financimi i mbrendshëm i këtyre projekteve ka çmim më të lartë se financimi i jashtëm, si dhe financimi i mbrendshëm paraqet rrezik për huadhënësin kur kemi projekte afatgjata.

Në këto kushte të ekonomisë me një hendek të prodhimit, ekonomia është e detyruar që ti drejtohet borxhit të jashtëm që është një përgjigje e qëlluar tatimore. Nga grafikonët e mëposhtëm një skenar bazë na është paraqitur me nivele të ndryshme të produktivitetit. (Figura 3.4).

Figura 3.4 Efekti i zvogëlimit të mangësive në infrastrukturën publike: simulime të modeleve, skena të përmirësuar të politikave



Burimi: Staf i FMN-së


Në bazë të analizimit të skenarëve të ndryshëm do të shohim mundësitë e ndryshme të investimit:

- **Skenari bazë** supozon se rritja financohet vetëm nga huamarrja e bankave vendore. Nën këtë skenar, dividendët e rritjes për një ekonomi që tashmë operojnë me një hendek të mbyllur të prodhimit, janë gjetur të zhvendosur (rritje me 0.1% pikë në normën vjetore krahasuar me vlerën e parashikimeve aktuale), pasi rritja e kërkesës agregate që rrjedh nga investimet më të larta publike është zvogëluar nga grumbullimi i investimeve private dhe konsumi i dobët i vendit (dobësuar nga rritja e tatimit të konsumit të nevojshëm për të shërbyer borxhin e ri). Barra e borxhit publik rritet me shpejtësi (duke arritur kulmin në rreth 60% të PBB-së, duke filluar nga mesatarja e tanishme e

Ballkanit Perëndimor e cila është 51% e PBB-së), duke lënë dobësitë e borxheve të larta gjatë të gjithë parashikimit të ardhshëm.

- **Skenari i përmirësuar i politikave** supozon se rritja e investimeve publike shoqërohet në mënyrë të vazhdueshme me efikasitet të përmirësuar të shpenzimeve publike (duke sjellë kornizat e menaxhimit të investimeve publike në krahasim me ato të vendeve të EQL dhe duke kanalizuar tre të katërtat e shpenzimeve të investimeve publike në ndërtimin e kapitalit) dhe kordinim më të madh rajonal të investimeve në infrastrukturë (që do të përmirësonte kthimin e investimeve publike, duke përmirësuar lidhshmërinë me forcimin e rrjetit të transportit regional). Sipas këtij skenari, dividendët e rritjes do të jenë më të larta (rritje me 0.3% pikë në normën vjetore të rritjes krahasuar me parashikimet aktuale), me rreth gjysmën e përmirësimit për shkak të rritjes së efikasitetit dhe gjysmës së fitimeve të produktivitetit (Figura 3.5).

Figura 3.5 Efekti i zvogëlimit të mangësive të infrastrukturës publike: Simulimet e Bazuar në Modele, Skenarët e Financimeve Alternative



Burimi: Llogaritjet e stafit të FMN-së.

Megjithatë, efekti i zbutjes së rritjes së taksave është ende mjaft domethënës. Raportet e borxhit publik bien vetëm ngadalë dhe nivelet e borxhit mbeten të larta gjatë gjithë periudhës afatmesme.

- **Skenari i financimit të jashtëm** supozon se politikat e brendshme të përmirësuar - sipas skenarit të mëparshëm - lehtësojnë qasjen në financimin e jashtëm (për shembull, eurobonotët) me kosto më të ulëta dhe maturime më

të gjata. Nën këtë skenar, largimi i investimeve private largohet në masë të madhe, duke përmirësuar ndjeshëm situatën ekonomike (rreth 0.6% pikë në rritjen afatmesme të rritjes vjetore krahasuar me parashikimet aktuale). Megjithatë, në periudhën afatshkurtër, investimet publike ende konkurrojnë me sektorin privat për inputet e punës, pasi hendeku i prodhimit supozohet të jetë plotësisht i mbyllur. Kostot e ulëta të financimit të jashtëm kërkojnë rritje më të ulëta të taksave gjatë një periudhe afatgjatë. Opinioni për borxhin gjithashtu përmirësohet më tej, por përsëri, dobësitë mbeten.

- **IFI dhe skenari i financimit të granteve** supozon se, përveç politikave të përmirësuar, rritja e investimeve publike financohet nga një përzierje e barabartë e granteve dhe financimit të IFI. Ky është skenari më i favorshëm, pasi do të eliminonte si shtyrjen nga investimet private ashtu edhe nevojën për të rritur ndjeshëm barrën e taksave mbi ekonominë për të shërbyer borxhin. Ky kombinim i granteve dhe financimit të IFI rezulton në një rritje më të lartë (0.8% në kulm), e cila së bashku me financimin e favorshëm pengon në mënyrë efektive çdo rritje të ndjeshme të borxhit. (FMN, 2018).

Mbyllja e hendeqeve në infrastrukturë do të sillte një ngritje të PBB-së prej më tepër se 3.5% dhe do të përmirësonte jetën e qytetarëve, mirëpo kjo do të ndodhte me një zhvillim rajonal të kordinuar dhe të përgjithshëm të infrastrukturës publike. Duhet ta kemi të qartë se për tu mbyllur të gjitha boshllëqet do të duheshin investime shtesë, mirëpo do të lidhej i gjithë rajoni dhe shpejtimi i konvergencës së të ardhurave të rajonit mund të jetë më shumë se dy herë më i shpejtë.

3.6 Çështje politikash dhe rekomandime

Përveç Maqedonisë boshllëqet në infrastrukturë vërehen në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Mungesa e investimeve në infrastrukturë po ndrydhn sektorin privat dhe e ngadalësojnë zhvillimin e tij. Politika fiskale nga tjetra anë është shumë e kufizuar për të planifikuar investime të mëdha dhe kjo çon në një disbalanc dhe ngadalsimin e procesit të integritetit në tregjet Europiane.

Vendi ynë duhet që resurset vendore ti shfrytëzojë me kujdes duke shfrytëzuar edhe hapësirën e pakët fiskale që të rrisë investimet publike në infrastrukturë, si rrjedhojë mund të përdoren edhe huazime të jashtme për të përmbushur nevojat e mëdha të investimeve. Mirëpo gjithmonë duhet patur kujdes sa dhe prej ku merren huazimet, si shembull kemi rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar për rajonin tonë. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në uljen e rreziqeve për qëndrueshmërinë e borxhit dhe uljen e kostove të financimit

Një pjesë e të ardhurave mund të mbëlidhen nga brenda duke mobilizuar tatim më të fortë. Kjo mund të arrihet duke zgjeruar bazën tatimore nëpërmjet eliminimit të përjashtimeve dhe stimulimeve tatimore, ndërkohë që ekziston edhe hapësirë për të rritur pranimin e të ardhurave nga tatimi në pronë në shumicën e

vendeve. Edhe pse kjo do ti lëndonte shumë bizneset e privileguara, mirëpo do sigurohej një e ardhur e mirë për investimet e mëtutjeshme publike.

Si pikë me rëndësi që duhet përmirësuar është struktura e menaxhimit të investimeve publike për të përmirësuar efikasitetin e investimeve publike e sidomos kapacitetet e planifikimit, shpërndarjes dhe zbatimit. Kjo do ti mundësoj vendit që të shfrytëzojë maksimalisht shfrytëzimin e investimeve private, duke ulur koston dhe rrezikun e investimit, të maksimizojë fitimin me investimin e partneritetit publik-privat. Rekomandimet kryesore nga vlerësimet e Menaxhimit të Investimeve Publike të kohëve të fundit përfshijnë:

1. Koordinimin më të madh të të gjitha organeve publike të përfshira duke sqaruar rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Përgatitjen dhe publikimin e një strategjie kombëtare të zhvillimit, që mbulon të gjitha shpenzimet kapitale dhe ato aktuale.
3. Proceseve të përmirësuara të vlerësimit për projektet kryesore të investimeve publike.
4. Mbikëqyrje gjithëpërfshirëse e qeverisë mbi PPP-të dhe ndërmarrjet shtetërore.
5. Transparenca e qeverisjes, dokumentacionin e buxhetit duke mbuluar operacionet e PPP dhe të gjitha detyrimet kontigjente jashtë buxhetit.
6. Vlerësime të pavarura ex post dhe auditime që duhet të kryhen në baza të rregullta. (FMN, 2018).

Si një strategji kombëtare duhet formuar nga politikanët renditja e projekteve më me rëndësi e sidomos ajo e infrastrukturës. Mirëpo duhet gjetur metoda që keto projekte të mos nëpërkëmben apo projektet prioritare të hiqen nga plani i investimeve për shkak të pikëve politikë dhe zgjedhje të ardhshme që vijnë. Pra projektet nuk duhet anuluar për pa iu përshtatur analizës kosto-përfitim që do ishte një transparencë e projekteve me profitabile dhe mund të ndihmonte në mbrojtjen e prioritetëve të projektit nga cikli politik.

Investimet në sektorin publik duhet të bëhen kryesisht nga burime të jashtme duke llogaritur kushtet e borxhit dhe koncesionit. Ky lloj investimi do lironte burimet vendore për investime private, çka nud to ta pengonte zhvillimin e sektorit privat dhe do të kishim një qëndrueshmëri borxhi. Maksimizimi i rritjes së investimeve do të ndihmonte vendin në zhvillim më të shpejtë, në integrimin europian dhe ndihmën e financimit nga BE-ja, institucionet financiare ndërkombëtare dhe nga donatorë bilateral. Meqënëse Maqedonia i ka të limituara burimet e mbrendëshme dhe për të mos ia zënë frymen sektorit privat, kjo do të ishte metoda më efikase e investimeve publike infrastrukturore me borxh të jashtëm.

Implikimet e mundshme të investimeve në infrastrukturë në balancat e jashtme gjithashtu duhet të konsiderohen me kujdes. Ndërsa rritet investimi i infrastrukturës, importet e mallrave të investimit do të rriteshin, duke rezultuar në një

përkeqësim të bilancit të llogarisë korrente. Një zgjerim i mprehtë i llogarisë korrente mund të paraqesë sfida makroekonomike, veçanërisht nëse fitimet nga investimet në terma të PBB-së potenciale më të mëdha kërkojnë kohë për të materializuar. Kështu, ndërhyrjet ndërmjet rritjes ekonomike dhe pabarazive të brendshme dhe të jashtme duhet të jenë një element kyç i çdo diskutimi politik mbi shkallëzimin e infrastrukturës publike në rajon. (FMN, 2018).

Duke dhënë përfundim investimet publike infrastrukturore nuk janë element i vetëm nga të cilat mvaret zhvillimi i ekonomisë vendore. Shumica e ekonomistëve eminent botëror mendojnë se ky është damari kryesor i ekonomisë mirëpo krahas kësaj duhet gjithashtu zhvilluar edhe elementët tjerë si arsimi, shëndetësia etj për të arritur standardin e vendeve të BE-së dhe për tu integruar në tregjet Europiane. Kështu investimet në infrastrukturë nuk duhet parë si një zëvendësim i një game të gjerë reformash strukturore e politike, ekonomike dhe financiare që duhet shteti të ndërmerr për ta vënë vendit në trajektoren e zhvilluar.

KAPITULLI IV

Kapitulli i fundit përmbledh pjesën empirike të punimit dhe analizon rezultatet e modelit të cilat rezultete na japin pasqyrën e studimit tonë. Në kapitullin e katërt diskutohen rezultatet të cilat përkojnë me punimin ekonomik të investimeve publike, nëse përputhen apo jo, si dhe argumenton efektet dhe pasojat ekonomike nga rezultati. Rezultatet e këtij kapitulli janë në bazë llogaritjeve të të dhënave me programin STATA 12 mirëpo variablat janë përzgjedhur nga autori i punimit.

Si problem kryesor na paraqitet zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, papunësia, standardi i ulët jetësor, për atë shum ekonomistë kanë përpiluar teori se çka më së shumti ndikon në cytjen drejt një zhvillimi ekonomik. Duke parë këtë neve jemi qasur problemit të investimeve publike kryesisht në infrastrukturën rrugore gjë që edhe ekonomistët më eminent botëror si ato amerikan por edhe të vendeve tjera të zhvilluara i japin një rëndësi të madhe kësaj teorie. Nga këtu e marrim edhe hipotezën bazë të studimit tonë.

Ngritja e hipotezave:

H_0 : Investimet publike sjellin rritje ekonomike

H1: PBB ndikon në rritjen ekonomike

H2: Ndryshimi i normave të interesit sjell rritje ekonomike

H3: Eksporti sjellë rritje ekonomike

Si hipotezë të parë kemi vënduar edhe vet titullin e temës ngase i gjith studimi ynë fokusohet mbi ndikimin e investimeve publike në rritjen ekonomike. Pra neve na

intereson se a ka dhe sa e kanë impaktin investimet publike krahas PBB, Normës së interesit dhe Eksportit ngase dimë nga tekstet e shumta ekonomike se këto kanë ndikim në zhvillimin ekonomik. Rezultatet tona sikundër rezultatet e studimeve të fundit të autorëve të ndryshëm që i kemi potencuar në tekstin lartë argumentojnë një impakt të madh të investimeve publike në rritjen ekonomike.

Si hipotezë të dytë kemi krahasuar PBB-në. **Norma e investimeve private ndaj PBB** – gjatë periudhës së marrë në analizë, ky variabël ka ardhur duke u rritur në kontributin e tij në rritjen ekonomike. **Norma e inflacionit** – duke qënë se pjesë e analizës është njohja se në cilat rrethana shpenzimet ndikojnë mbi rritjen ekonomike, ky variabël është përfshirë në model si një tregues i qëndrueshmërisë makroekonomik. **Norma e produktit të brendshëm bruto në periudhën (t – 1)** – është e rëndësishme për të diferencuar efektet afatshkurtra në rritjen ekonomike. **Indeksi i hapjes tregtare** – cili jepet si raport i shumës së importeve dhe eksporteve ndaj produktit të brendshëm bruto. **Pritshmëria e jetgjatësisë dhe Kapitali human** – sipas teorisë së shpjeguar mësipër ky variabël ka një rol të rëndësishëm në normën e rritjes ekonomike. (Olta Milova).

Hipoteza e tretë Normat e Interesit është poashtu një nga ndikuesit më të mëdhej të rritjes ekonomike sepse të gjitha bizneset vendore janë të mvarura nga interesi në një farë mënyre dhe se shumica e tyre kanë marrë kredi. Interesi pikë së pari kur është i ulët rrit interesimin për investime të ndryshme. Interesi i lartë ulë investimet, largon një pjesë të madhe të investitorëve jashtë vendit dhe paraqet inflacion. Inflacioni i ulët është i shëndetshëm por jo ai i larti. Prandaj si parametër duhet marrë parasyshtë sepse ndikon në zhvillimin ekonomik.

Eksporti është një indikator i mirë mirpo për vende të vogëla siç është Maqedonia Veriore nuk ka nonjë ndikim të madh përveç që i ndihmon pak ekonomisë.

Viti	Public Investimet Publike	PBB – GDP (Real)	Normat e Interesit	Eksporti
2009	4,4	-0,9	2,2	-15,7
2010	3,9	2,9	2,6	24,2
2011	0,6	2,9	3,2	10,4
2012	1,1	-0,3	2,6	-0,5
2013	2,5	2,0	2,6	8,4
2014	1,8	3,0	2,6	10,5
2015	2,1	3,5	2,7	10,0
2016	2,6	4,0	2,7	9,0
2017	2,9	4,0	2,6	8,4
2018	3,2	4,0	2,7	8,2

4.1. Modeli linear (me konstantë)

$$Y=B1+B2X1+B3X2+B4X3+Ui$$

Regresioni linear i thjeshtë është një metodë statistikore që na lejon të përmbledhim dhe studiojmë marrëdhëniet midis dy ndryshoreve të vazhdueshme (sasiore):

- Një ndryshore, e shënuar x, vlerësohet si variabël parashikuese, shpjeguese ose e pavarur.
- Variabla (apo variablat) tjetra, e shënuar y, vlerësohet si ndryshimi i përgjigjes, rezultatit ose varësisë.

Regresioni linear i thjeshtë merr mbiemrin e tij "të thjeshtë", sepse ka të bëjë me studimin e vetëm një ndryshoreje parashikuese. Në të kundërt, regresioni i shumëfishtë linear, të cilin ne e kemi përdorur, merr mbiemrin e tij "të shumëfishtë", sepse ka të bëjë me studimin e dy ose më shumë variablave të parashikuara.

. regress Inv_Pub PBB Nor_Inter Eksp

Source	SS	df	MS	Number of obs = 10		
Model	8.11289175	3	2.70429725	F(3, 6) =	3.74	
Residual	4.33610899	6	.722684831	Prob > F =	0.0794	
				R-squared =	0.6517	
				Adj R-squared =	0.4775	
Total	12.4490007	9	1.3832223	Root MSE =	.85011	

Inv_Pub	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
PBB	.2202218	.2437427	0.90	0.401	-.3761951	.8166387
Nor_Inter	-4.662687	1.421646	-3.28	0.017	-8.141329	-1.184046
Eksp	.0123766	.0431093	0.29	0.784	-.0931081	.1178614
_cons	14.22326	3.584209	3.97	0.007	5.45302	22.99351

- Inv_Pub=14,22; Shpreh koeficientin e vlerësimit, nëse PBB, Nor_Inter dhe Eksp janë 0, atëherë Inv_Pub do të jenë 14,22%.
- PBB=0,22; Nëse PBB rritet për 1% atëherë Inv_Pub do të rriten mesatarisht për 0,22%.
- Nor_Inter= -4,66; Nëse Nor_Inter rritet për 1% atëherë Inv_Pub do të biejn mesatarisht për -4,66%.
- Eksp=0,012; Nëse Eksp rritet për 1% atëherë Inv_Pub do të rriten mesatarisht për 0,012%.

Ui- 0,0% janë faktorët që ndikojnë në model por nuk janë përfshirë në observim .

Nga rezultatet e lartëpërmendura shohim që investimet më së shumti ndikohen nga Investimet direkte Publike, pastaj nga PBB (prodhimi i brendshëm vendor), nga ana tjetër pamë që eksporti ka fare pak ndikim ne rritjen e Investimeve, ndërsa norma e interesit ndikon dukshëm ngaqë përfëshin të gjithë ekonominë.

Rezultati i parë i mësipërm përcakton se në kushte të abstrahimit të ndikimit të eksponentëve tjerë atëherë PBB, Norma e Interesit dhe Eksporti p.sh nëse këto do të ishin 0 atëherë Investimet Publike to të arrinin vlerën e 14,22%. Rezultati i dytë kemi kur PBB-ja rritet për 1% atëherë Investimet Publike do të rriteshin për 0,22%. Rezultati i tretë kemi kur Norma e interesit rritet gjë e cila ndikon negativisht në ekonomi, paraqet inflacion pra kur norma e interesit rritet për 1% Investimet Publike do të bienin për -4,66% që është një shifër signifikante për një shtet si Maqedonia Veriore. Dhe se fundmi eksporti nese rritet për 1% atëherë investimet publike do të rriteshin për 0,012% shifer e cila është shumë e vogël që tregon se eksporti ka shumë pak ndikim në Investimet Publike.

T-statistics = $0,9 - 3,28 + 0,29 + 3,97 = 1,88$. T-testi=1,833 i sqaron a ka shifër koeficientet e vleresimit. Df=n-1=10-1=9

T-statistiks është më e madhe se vlera kritike $T > T_{\text{kritike}}$ ($1,880 > 1,833$), në këtë rast kemi shifër koeficientet. 1,833 caktohet nga tabela e t-statistics për gjetjen e vlerës kritike në bazë të konfidencialitetit 95% në model dhe numrit të observimeve duke ja minusuar 1 formula lart. F-testi = 3,74.

Krahasimi me vlerën kritike të testit, për nivel rëndësie të dhënë, (zakonisht 5% ose $\alpha = 0.05$) dhe shkallë lirie (n-k), $t_{kr} = t_{\alpha/2; n-k}$. Nëse $t_f > t_{kr}$ (që të ne $1,880 > 1,833$), hipoteza bazë bie poshtë dhe thuhet se koeficienti përkatës është statistikisht i rëndësishëm.

Krahasimi me probabilitetin që testi të marrë vlera më të mëdha se vlera faktike $P = P(t > t_f)$. $P(t_f > t_{kr})$ llogaritet; nëse $P < \alpha$ (që të ne $0.007 < 0.5$), hipoteza bazë bie poshtë dhe thuhet se koeficienti përkatës është statistikisht i rëndësishëm.

4.2. Korelacioni

```
. correlate Inves_pub PBB Nor_intere Ekspo
{obs=10}
```

	Inves_~b	PBB	Nor_in~e	Ekspo
Inves_pub	1.0000			
PBB	-0.0906	1.0000		
Nor_intere	-0.7295	0.5206	1.0000	
Ekspo	-0.1601	0.7360	0.5313	1.0000

Në bazë të këtij koeficienti (nëse është më e vogël se 0.5) tregon se ka lidhje lineare pozitive nën mesatare në mes dy variablave.

. pwcorr Inv_pub PBB Nor_inter Eksp, star(0.5) sig

	Inv_pub	PBB	Nor_inter	Eksp
Inv_pub	1.0000			
PBB	-0.0906 0.8034	1.0000		
Nor_inter	-0.7295* 0.0166	0.5206* 0.1229	1.0000	
Eksp	-0.1601 0.6587	0.7360* 0.0152	0.5313* 0.1140	1.0000

Në këtë rast do të themi se me disa variabla kemi korelacion pozitiv për shkak që me rritjen e variablës së mvarur rriten edhe variablat e pamvarura. Korelacion negativ kemi me disa variabla të tjera kur p.sh rritet variabla e mvarur siç është në rastin tonë Inv_pub mirëpo zvogëlohet variabla e Nor_inter që në rastin tonë është e pranueshme sepse norma interesi që zvogëlohen do të thotë zhvillim ekonomik.

Variablat me yllë janë signifkante, kurse ato pa yllë nuk janë signifkante. Siç kemi rastin e PBB me Inv_pub dhe Eks me Inv_pub të cilat nuk janë signifkante ndërmjet veti. Mirëpo programi llogarit lidhjet direkte në mes variablave, siç pamë edhe në diskutimet e mësipërme ky parametër (Investimet publike) japin impakt indirekt në zhvillimin ekonomik dhe këtë e vërteton edhe metoda më lart me stata si regresioni linarë. Inv_pub janë signifkant sa i përket Normës së interesit dhe e afektojnë njëra tjetrën instrument ky i cili ndikon shumë në zhvillimin ekonomik.

REFERENCA

Akitoby, B. & Stratman, Th. (2008) Fiscal policy and Financial Markets. *Economic Journal*, Vol.118(533), fq. 1971-1985.

Antonio Afonso & Mina Kazemi, (2016). "Assessing Public Spending Efficiency in 20 OECD Countries". Lisbon School of Economics & Management.

Alesina, A. & Perotti, R. (1996) Fiscal Discipline and the Budget Process. *American Economic Review*, Vol.86, fq.401-407

Alexious, C. (2009) Government Spending and Economic Growth: Econometric Evidence from the South Eastern Europe (SEE). *Journal of Economic and Social Research*, Vol.11(1).

Aschauer, A. (1989) Is Public Expenditure Productive? *Journal of Monetary Economics*, Vol.23(2), fq.177-200.

- Barrios, S., and Schaechter, A., (2008). “*The Quality of Public Finances and Economic Growth*”. 337 European Commission, Economic and Financial Affairs Economic Papers.
- Babic, M., and E. Primorac. 1986. Causes of the Growth of the Yugoslav External Debt. *Soviet Soviet Studies*, vol. 38, no. 1, 1986, pp. 69–88.
- Ben Zeev, N. & Pappa, E. (2014) Chronicle of a War Foretold: The Macroeconomic Botev, J. and A. Mourougane (forthcoming), “Fiscal Consolidation: What are the Breakeven Fiscal Multipliers?”, *OECD Economics Department Working Papers*.
- Effects of Anticipated Defense Spending Shocks. CEPR Discussion Paper 9948. Centre for Economic Policy Research, London.
- Canning, D. & Bennathan, E. (2000) The Social Rate of Return on Infrastructure Investments. World Bank Research Project, RPO 680-89, Washington D.C.
- Canning, D. & Pedroni, P. (2004) Infrastructure and Long-Run Economic Growth. Working Paper No.99-09. Centre for Analytical Economics, Cornell University, New York.
- Coenen, G. Et al. (2010) Managing Resource Revenues in Developing Economies. IMF Staff Papers, 57(1), fq. 84-118.
- Corsetti, G. & Roubini (1997) Politically Motivated Fiscal Deficits: Policy Issues in Closed and Open Economies. *Economics and Politics*, Vol.9, fq.27-54.
- Corsetti, G. et al. (2012) What Determines Government Spending Multipliers? IMF Working Paper 12/150. International Monetary Fund, Washington.
- Countinho, R. & Gallo, G.(1991) Do Public and Private Investment Stand in Each Other’s Way. WDR Background Paper, World Bank, October 1991.
- Dobbs, R. H. Pohl, D. Lin, J. Mischke, N. Garemo, J. Hexter, S. Matzinger, R. Palter and R. Nanavatty (2013), “Infrastructure Productivity: How to save \$1 trillion a year”, *McKinsey Global Institute Report*, January.
- Dur, R. & Peletier, B. & Swank, O. (1997) The Effect of Fiscal Rules on Public investment if Budget Deficits are Politically Motivated. Working Paper, Erasmus University Rotterdam, Tinbergen Institute, The Netherlands.
- Eden, M. & Kraay, A. (2014) Crowding In and the Returns to Government Investment in Low-Income Countries. World Bank Policy Research Working Paper 6781, Washington.
- Elmi Aziri-2009. “Ndikimi i investimeve publike në rritjen ekonomike”
- Engel, E. & Fisher, R. & Galetovic, A. (2014) *The Economics of Public Public-Private Infrastructure PPPs: A Basic Guide*. Cambridge University press.
- Enti Shtetëror i Statistikës,
<http://www.stat.gov.mk/GSearch.aspx?cx=005984792435174779271%3Av7t0sn->

[wula&cof=FORID%3A10&ie=UTF-8&q=%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8+%D0%B8%D0%BD%D0%B2%D0%B5%D1%81%D1%82%D0%B8%D1%86%D0%B8%D0%B8&sa=%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0%D1%98](#)

Epec. 2014. "Overview of the PPP Legal and Institutional Framework in the Western Balkans." European PPP Expertise Centre, European Investment Bank, Luxembourg.

European Commission. 2012. *ERAWATCH Analytical Country Report 2011: Former Yugoslav Republic of MACEDONIA*. Annual Country Report (2011).

European Commission. 2012. *ERAWATCH Analytical Country Report 2011: Former Yugoslav Republic of MACEDONIA*. Annual Country Report (2011).

European Commission. (no date) *Private Sector Interaction in the Decision Making Processes of Public Research Policies: Country Profile: Macedonia*. Available at: http://ec.europa.eu/invest-in-research/pdf/download_en/psi_countryprofile_macedonia.pdf

European Union. 2010. Progress Report for FYR Macedonia. EBRD TAM/BAS Program Macedonia available at: http://www.ebrd.com/pages/workingwithus/tambas/where/fyr_macedonia/focus.shtml

Forni, M. & Gambetti, L. (2010) Fiscal Foresight and the Effects of Government Spending. CEPR Discussion Paper 7840. Centre for Economic Policy Research, London.

Fournier, J.M. (2016), "The positive effect of public investment on potential growth", *OECD Economics Department Working Paper*, forthcoming.

Fournier, J.M. and A. Johansson (2016), "The Effect of the Size and the Mix of Public Spending on Growth and Inequality", *OECD Economics Department Working Paper*, No. 1344.

Fischer, S. (1993) The Role of Macroeconomic Factors in Growth. National Bureau of Economic Research, Working Paper No.4565.

Ghani, E. dhe Din, M. (2006) The Impact of Public Investment on Economic Growth in Pakistan. *The Pakistan Development Review*, Vol.45 (1), Spring 2006, pp.87-98.

Gjebrea, E., and Zoto. O. 2015. "Infrastructure Private Partnership Investments: A Comparative Analysis of Western Balkan and Emerging Countries", in: Karasavoglou A., Ongan S., Polychronidou P. (eds) *EU Crisis and the Role of the Periphery*.

Irwin, T. & Funke, K. & Rial, I. (2012) Budgeting and Fiscal Reporting for Public-Private-Partnerships. Fiscal Affairs Department, IMF. International Forum Discussion Paper 2012-8, OECD 2012.

Jacques Miniane, Nhu Nguyen, Martin Petri, Jens Reinke, and James Roaf. “Public Infrastructure in the Western Balkans Opportunities and Challenges”. (*International Monetary Fund* 2018).

Kayode, O. & Adegbeni, B. & Abiodun, F. (2013) An Empirical Analysis of Transport Infrastructure Investment and Economic Growth in Nigeria. *Social Science*, Vol.2, No.6, 2013, pp.179-188.

Koti, S. (2016) Kërcënimi nga Mbirregullimi. UET Press, Mars 2016.

Koti, S. (2016) Përcaktuesit e Kapitalit Publik: Rasti i Shqipërisë 1990-2015. Konferenca II Kombëtare për Financën, 27 Maj 2016, Tiranë-Shqipëri.

Khan, M. (1996) Government Investment and Economic Growth in the Developing World. *The Pakistan Development Review*, Vol.35(4), fq.419-439.

Lepper, E. et al. (2012) Quantitative Effects of Fiscal Foresight. *American Economic Journal: Economic Policy*, Vol.4(2), fq.115-144.

Lepper, E. et al. (2013) Fiscal Foresight and Information Flows. *Econometrica*, Vol.81(3), fq. 1115-1145.

Levine, R. & Renelt, D. (1992) A Sensitivity Analysis of Cross-Country Growth Regressions. *American Economic Review*, September.

Mandl, U., Dierx, A., and Ilzkovitz, F. (2008). “*The Effectiveness and Efficiency of Public Spending*”. European Commission, Economic and Financial Affairs Economic Papers.

Mandl, U., Dierx, A., and Ilzkovitz, F. (2008). “*The Effectiveness and Efficiency of Public Spending*”. European Commission, Economic and Financial Affairs Economic Papers.

Milesi-Ferreti, G. (1997) Fiscal Rules and the Budget Process. CEPR Discussion Paper No.1664.

Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë (2018) Програма на економски реформи 2018-2020.

Munnell, A. (1990) Why Have Productivity Declined? Productivity and Public Investment. Investment, Federal Reserve Bank of Boston, 1990.

Moomay, R. & Mullen, J. & Williams, M. (1995) The Interregional Impact of Infrastructure Capital. *Southern Economic Journal*, fq.830-848.

Munnell, A. () How Does Public Infrastructure Affect Regional Economic Performance?

Munnell, A. (1992) Policy Watch: Infrastructure Investment and Economic Growth. *Journal of Economic Perspectives*, Vol.6(4), fq.189-198.

OECD (2016a), *Economic Outlook*, forthcoming.

- OECD (2015b), *OECD Economic Outlook*, Vol. 2015/2, OECD Publishing, Paris.
- OECD (2016b), *OECD Economic Surveys: United States 2016*, forthcoming.
- OECD. 2011c. *The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Review of the National Innovation System*. OECD Development Center, Paris.
- Ostry, J. et al. (2014) Public Debt, Public Investment and Growth: Normative Considerations. IMF Working Paper, Washington.
- Oum, T. & Waters, W. & Chunyan, Y. (1998) Development of an Econometric Model Linking Public Transportation Investments to Economic Growth in British Columbia. The Centre for Transportation Studies, the University of British Columbia.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë (Извештај бр. 93913- МК, 2015) Преглед на јавните расходи во Република Македонија- Фискална политика за раст.
- Ruben Atoyan, Dora Benedek, Ezequiel Cabezon, Giuseppe Cipollone, Polenakovik, R. and R. Pinto. 2010. *The National Innovation System and its Relation to Small Enterprises: The Case of the Republic of Macedonia*. World Review Science, Technology and Sustainable Development.
- Seetanah, B. (2009) Using GMM Framework to Analyse the Role of Transport Infrastructure in Economic Growth: The African Case. Discussion Paper at the 9th Conference on Business and Economics.
- Sever, I. and associates (2009) Starting Point New Economic Policy in the Cause of Recession, *Proceedings of Rijeka Faculty of Economics*, Vol.27(2).
- Schwartz, G. & Corbacho, A. & Funke, K. (2008) Public Investment and Public-Private Partnerships: Addressing Infrastructure Challenges and Managing Fiscal Risks. IMF, Palgrave Macmillan.
- Tabellini, G. & Alesina, A. (1990) Voting on the Budget Deficit. *American Economic Review*, Vol.80, fq.37-49
- Warner, A. (2014) Public Investment as an Engine of Growth. IMF Working Paper 14/148, International Monetary Fund, Washington.
- William E. Cullison. “Public Investment and Economic Growth”
- Warner, A. (2014) Public Investment as an Engine of Growth. IMF Working Paper 14/148, International Monetary Fund, Washington.
- World Bank (1994) Overview and Infrastructure: Achievements, Challenges and Opportunities. In World Development Report 1994: Infrastructure for Development, 1-26, Oxford; Oxford University Press.

TABELA .2. Treguesit e nivelit të sektorit në 2015: vendet dhe rezultatet e përgjithshme në shikim pozitiv/negativ

	Sektorët e Korporatave				Energjia		Infrastruktura			Sektorët Financiar					
	Agrobiznesi	Industria e përgjithshme	Pasuria e patundshme	Teknologjia e informimit dhe telekom	Resursat natyrore	Energjia elektrike	Ujit dhe ujërat e zeza	Transporti urban	Rrugët	Hekurudhat	Biznesi Bankar	Sigurimi dhe shërbime tjera financiare	Financat e ndërm vog	Kapitali privat	Tregjet e Kapitalit
Europa Qendror dhe shtete Baltike															
	3	3+	3+	4	4-	3	3+	3+	3+	3-	3+	3+	3-	2+	3+
Croatia	3+	4+	4+	4	4	4+	4	3+	3	4	4	3+	3+	3-	3
Estonia	4	4-	4-	4	4-	3	3+	3+	3+	3+	3	3	3	3	3+
Hungary	3	4-	4	3+	4-	3+	3+	4	3	4	3	3+	3	2+	3+
Latvia	3+	4	4	4	4-	3+	3+	4	3	3	3+	3+	3	2+	3
Lithuania	3+	4	4	4	4-	3+	3+	4	3	3	3+	3+	3	2+	3
Poland	3+	4-	4	4	3	3+	4	4	4-	4	4	3+	3	3+	4
Slovak Republic	3+	4+	4	4-	4-	4	3+	3+	3+	3+	4-	3+	4-	2+	3
Slovenia	4-	3+	4	3+	3+	3	3+	3+	3	3	3	3+	3-	3-	3+
Europa Juglindore															
	3-	2+	3-	3+	3-	2+	2+	3-	3-	2	3-	2	3-	1	2-
Albania	3-	2	2-	2	2	2+	2	2+	3	3+	3-	2+	2+	2-	2
Bosnia and Herzegovina	3	3+	3+	4	3+	3	3	3+	3-	3+	3	3+	3	3-	3-
Bulgaria	3	3+	3	4	3-	3	3+	3+	3	Not applicable	3-	Not available	Not available	Not available	3+
Cyprus	3-	4+	3	4	2+	3	3+	3+	3	3	3-	3-	3	1	2-
PR Macedonia	3-	3	3-	4-	4-	3	2+	3-	3-	3-	3-	3-	3	2	2-
Kosovo	2+	2-	2-	2	2	2+	2+	2+	2+	3-	2+	2	3-	1	1
Montenegro	2+	2+	2+	3+	3+	2+	2	3	2+	2+	3-	2+	3	1	2
Romania	3	3+	3+	3+	4-	3+	4-	3+	3	3+	3	3+	3	3-	3-
Serbia	3-	3-	3-	3	2	2+	2+	3-	3-	3	3-	3	3	2	2
Turqia	3-	3	3+	3+	3+	3	3-	3	3-	3	3+	3	3	3-	4
Europa Lindore dhe Kaukazi															
	3-	3	3-	3	2+	3+	3-	2+	3-	2+	2+	2	2+	1	2
Ameria	3-	3	3-	3	2+	3	3-	2+	3-	2+	2	2	2	1	2
Azerbaijan	2+	2	2	2-	2+	2+	2-	2	2+	2	2	2	2	1	2-
Belarus	2+	2	2	2	1	1	2-	2	2	1	2	2	2	1	2-
Georgia	3-	3-	3-	3-	2	3+	2	2+	2+	3	3-	2	3-	1	2-
Moldova	3-	2-	2+	3	3	3	2	3	3	2	2+	2+	2	2-	2
Ukraine	3-	2+	3-	3-	2-	3	2+	3-	3-	2	3-	2+	2+	2	2
Rusia	3-	3-	3-	3+	2	3+	3	3	3-	4	3-	3-	2	2+	4
Azia Qendrore															
	3-	2	3	3	2-	3	2+	2+	3-	3	2+	2	2	2-	2
Kazakhstan	3-	2	3	3	2-	3	2+	2+	3-	3	2+	2+	2	2-	2
Kyrgyz Republic	2+	2	2+	3	2-	2+	2	2	2-	1	2	2-	2-	1	2-
Mongolia	3-	2+	2	3	2	2+	2	2	2-	3-	2+	2	2+	2-	2-
Tajikistan	2	2-	2-	2+	1	2	2	2	2-	1	2	2-	2-	1	1
Turkmenistan	1	1	1	2-	1	1	1	1	1	1	1	2-	1	1	1
Uzbekistan	2	1	2	2	1	2+	2-	2	1	3-	1	2	1	1	1
Mesdheu Jugor dhe Lindor															
	2	2	2+	3	1	2+	1	2	2+	2-	2+	2+	2-	2	2+
Egypt	2	2+	3-	3	2+	3	2-	2+	3-	2	3	2+	2	2	2
Jordan	2	3-	3-	3+	2-	2	2+	3	3-	2	3	3-	2+	2	3
Monocco	2+	3-	3-	3	2-	2	2+	3	3-	2	3	2+	2	2	3
Tunisia	3-	3+	3-	3	2	2	2	2+	2+	2	2+	2+	2	2-	2+

Burimi: EBRD.
 Mbushja e gjelbërt tregon vendin / sektorin në shikim pozitiv
 Mbushja e kafe tregon vendin / sektorin në shikim negativ

91
 Notë: Treguesit e tranzicionit nga 1 në 4+, me 1 që përfaqëson pak ose aspak ndryshim në një ekonomi të ashpër qendrore të planifikuar dhe 4+ që prezanton standardet e një ekonomitë të tregut të industrializuar. Për një ndarje të hollësishme të secilës nga fushat e reformës, shih metodologjinë në versionin online të këtij Raporti të Tranzicionit (tr.ebrd.com).
 Një vend / sektor që vendoset në shikim pozitiv ose negativ është treguar me kodin e ngjyër: jeshileja tregon zhvillim pozitiv gjatë vitit të kaluar dhe kafeja tregon zhvillim negativ.

TABELA 4
Treguesit e Performancës së Sektorit Publik (PSP), 2009-2013

Vendi	Treguesit e Mundësive					Treguesit Musgrave				Performanca Totale e Sektorit Publik	
	Administrata	Edukimi	Shëndetësia	Infrastruktura	Mundësia e PSP-së	Distribrimi	Stabiliteti	Performimi Ekonomik	PSP e Musgrav-it	Peshat e Barabarta	Peshat e Ndryshme
Austria	1.11	0.97	1.00	1.09	1.04	1.03	1.27	1.24	1.18	1.11	1.13
Belgjika	0.88	1.08	1.00	1.01	0.99	1.05	1.17	0.98	1.07	1.03	1.04
Kanada	1.09	1.05	1.00	1.02	1.04	0.97	1.75	1.18	1.30	1.17	1.21
Danimarka	1.07	1.06	0.99	1.04	1.04	1.03	0.84	0.88	0.92	0.98	0.96
Finlanda	1.16	1.11	1.00	1.11	1.09	1.06	0.69	0.90	0.88	0.99	0.95
Franca	0.95	0.98	1.00	1.10	1.01	0.99	1.23	0.85	1.02	1.02	1.02
Gjermania	1.02	1.01	1.00	1.07	1.02	1.01	1.11	0.96	1.03	1.02	1.03
Greqia	0.61	0.85	1.00	0.78	0.81	0.95	0.01	-0.03	0.31	0.56	0.48
Irlanda	1.04	1.08	1.00	0.84	0.99	1.00	0.63	1.06	0.90	0.94	0.93
Italia	0.63	0.88	1.01	0.74	0.81	0.97	0.46	0.45	0.63	0.72	0.69
Japonia	1.09	0.98	1.01	1.04	1.03	0.95	1.00	0.98	0.98	1.00	0.99
Luksemburgu	1.18	0.95	1.00	1.04	1.04	1.02	1.13	1.85	1.33	1.19	1.23
Holanda	1.13	1.10	1.00	1.06	1.07	1.06	1.21	1.09	1.12	1.09	1.10
Norvegjia	1.04	1.02	1.00	0.90	0.99	1.10	1.43	1.56	1.36	1.18	1.24
Portugalia	0.77	0.94	0.99	1.05	0.94	0.94	0.29	0.37	0.53	0.73	0.67
Spanja	0.76	0.95	1.00	1.01	0.93	0.95	0.70	0.66	0.77	0.85	0.82
Suedia	1.08	1.00	1.00	1.03	1.03	1.08	0.96	1.17	1.07	1.05	1.06
Zvicra	1.24	1.06	1.01	1.15	1.12	1.01	1.75	1.69	1.48	1.30	1.36
Britania e Madhe	1.08	0.99	1.00	0.94	1.00	0.97	1.09	0.97	1.01	1.01	1.01
SHBA	1.10	0.94	0.99	0.99	1.00	0.87	1.28	1.21	1.12	1.06	1.08
Qever. Mesatare	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Qever. e Mëdha	1.24	1.11	1.01	1.15	1.12	1.10	1.75	1.85	1.48	1.30	1.36
Qever. e Vogëla	0.61	0.85	0.99	0.74	0.81	0.87	0.01	-0.03	0.31	0.56	0.48

BURIMI: António AfonsoS, Mina Kazemi - 2016

TABELA 5

Treguesit e Efikasitetit të Sektorit Tublik (PSE), 2009-2013

Vendi	Treguesit e Mundësive					Treguesit Musgrave				Efienca e Përgjithshme e Sektorit Publik	
	Administrata	Edukimi	Shëndetësia	Infrastruktura	Mundësia e PSE-së	Distribuimi	Stabiliteti	Performimi Ekonomik	PSE e Musgrav-it	Peshat e Barabarta	Peshat e Ndryshme
Austria	1.15	0.94	0.94	1.25	1.07	0.81	1.14	1.11	1.02	1.05	1.04
Belgjika	0.77	0.94	0.94	1.56	1.05	0.89	1.03	0.87	0.93	1.00	0.97
Kanada	1.06	1.11	1.02	1.13	1.08	1.36	2.02	1.36	1.58	1.30	1.41
Danimarka	0.83	0.69	0.84	1.13	0.87	0.89	0.72	0.75	0.79	0.84	0.82
Finlanda	1.02	0.94	1.18	1.01	1.04	0.95	0.61	0.79	0.78	0.93	0.87
Franca	0.82	0.93	0.86	0.94	0.89	0.79	1.04	0.71	0.85	0.87	0.86
Gjermania	1.10	1.15	0.88	1.72	1.21	0.91	1.13	0.98	1.01	1.12	1.08
Greqia	0.60	1.18	1.18	0.63	0.90	0.85	0.01	-0.03	0.28	0.63	0.49
Irlanda	1.20	1.09	1.24	0.85	1.09	1.25	0.69	1.17	1.04	1.07	1.06
Italia	0.65	1.06	1.06	0.87	0.91	0.81	0.43	0.43	0.56	0.76	0.68
Japonia	1.14	1.42	0.97	1.07	1.15	1.12	1.18	1.16	1.15	1.15	1.15
Luksemburgu	1.45	1.41	1.20	0.87	1.23	0.98	1.23	2.02	1.41	1.31	1.35
Holanda	0.92	1.10	0.84	0.93	0.95	1.40	1.23	1.11	1.25	1.08	1.15
Norvegjia	1.04	0.79	0.97	0.79	0.90	1.18	1.53	1.67	1.46	1.14	1.27
Portugalia	0.77	0.98	1.07	0.99	0.95	0.91	0.28	0.35	0.51	0.76	0.66
Spanja	0.81	1.13	1.15	0.87	0.99	1.03	0.75	0.71	0.83	0.92	0.88
Suedia	0.87	0.81	0.94	0.82	0.86	1.09	0.86	1.04	1.00	0.92	0.95
Zvicra	2.31	1.09	1.09	1.33	1.46	1.20	2.44	2.37	2.00	1.69	1.82
Britania e Madhe	1.05	0.98	1.00	1.18	1.05	1.09	1.11	0.98	1.06	1.06	1.06
SHBA	1.40	0.94	0.94	0.89	1.04	1.01	1.51	1.42	1.31	1.16	1.22
Qeve.Mesatare	1.05	1.03	1.01	1.04	1.03	1.03	1.05	1.05	1.04	1.04	1.04
Qeve. e Mëdha	2.31	1.42	1.24	1.72	1.46	1.40	2.44	2.37	2.00	1.69	1.82
Qeve. e Vogëla	0.60	0.69	0.84	0.63	0.86	0.79	0.01	-0.03	0.28	0.63	0.49

BURIMI: António Afonso\$, Mina Kazemi - 2016

Tabela 6
Rezultatet e DEA (Modeli 1), 2009-2013

Modeli 1 - 1 Input (Shpenzimet Totale të Normalizuara), 1 Output (Rezultatet Totale të PSP)								
Vendi		CRS	INPUTI I ORIENTUAR			OUTPUTI I ORIENTUAR		
			VRS	BARAZIME	RANGU	VRS	BARAZIME	RANGU
Austria	AUT	0.554	0.649	CHE	14	0.854	CHE	5
Belgjika	BEL	0.505	0.637	CHE	16	0.792	CHE	9
Kanada	CAN	0.745	0.828	CHE	4	0.9	CHE	4
Danimarka	DNK	0.464	0.615	CHE	19	0.754	CHE	15
Finlanda	FIN	0.485	0.637	CHE	16	0.762	CHE	14
Franca	FRA	0.475	0.605	CHE	20	0.785	CHE	10
Gjermania	DEU	0.576	0.735	CHE	9	0.785	CHE	10
Greqia	GRC	0.272	0.632	CHE	18	0.431	CHE	20
Irlanda	IRL	0.572	0.791	CHE	5	0.723	CHE	16
Italia	ITA	0.376	0.679	CHE	13	0.554	CHE	19
Japonia	JPN	0.652	0.847	CHE	2	0.769	CHE	13
Luksemburgu	LUX	0.724	0.791	CHE	5	0.915	CHE	2
Holanda	NLD	0.616	0.735	CHE	9	0.838	CHE	6
Norvegjia	NOR	0.695	0.766	CHE	8	0.908	CHE	3
Portugalia	PRT	0.389	0.692	CHE	12	0.562	CHE	18
Spanja	ESP	0.512	0.783	CHE	7	0.654	CHE	17
Suedia	SWE	0.519	0.643	CHE	15	0.808	CHE	8
Zvicra	CHE	1	1	CHE	1	1	CHE	1
Britania	GBR	0.565	0.727	CHE	11	0.777	CHE	12
SHBA	USA	0.691	0.847	CHE	2	0.815	CHE	7
Mesatarja		0.569	0.732			0.769		
Minimumi		0.272	0.605			0.431		

BURIMI: António Afonso, Mina Kazemi - 2016

Tabela 7
Rezultatet e DEA (Modeli 2), 2009-2013

Modeli 1 - 1 Input (Shpenzimet Totale të Normalizuara) 2 Outputi (Mundësitë dhe rezultatet PSP të Musgrave-it)								
COUNTRY	CRS	INPUTI I ORIENTUAR			OUTPUTI I ORIENTUAR			
		VRS	BARAZIME	RANGU	VRS	BARAZIME	RANGU	
Austria	AUT	0.602	0.649	CHE	14	0.929	CHE	4
Belgjika	BEL	0.563	0.637	CHE	16	0.884	CHE	15
Kanada	CAN	0.768	0.828	CHE	4	0.929	CHE	4
Danimarka	DNK	0.571	0.615	CHE	19	0.929	CHE	4
Finlanda	FIN	0.62	0.637	CHE	16	0.973	CHE	2
Franca	FRA	0.546	0.605	CHE	20	0.902	CHE	12
Gjermania	DEU	0.669	0.735	CHE	9	0.911	CHE	11
Greqia	GRC	0.457	0.632	CHE	18	0.723	CHE	19
Irlanda	IRL	0.699	0.791	CHE	5	0.884	CHE	15
Italia	ITA	0.491	0.679	CHE	13	0.723	CHE	19
Japonia	JPN	0.779	0.847	CHE	2	0.92	CHE	8
Luksemburgu	LUX	0.735	0.791	CHE	5	0.929	CHE	4
Holanda	NLD	0.702	0.735	CHE	9	0.955	CHE	3
Norvegjia	NOR	0.704	0.766	CHE	8	0.919	CHE	10
Portugalia	PRT	0.581	0.692	CHE	12	0.839	CHE	17
Spanja	ESP	0.65	0.783	CHE	7	0.83	CHE	18
Suedia	SWE	0.591	0.643	CHE	15	0.92	CHE	8
Zvicra	CHE	1	1	CHE	1	1	CHE	1
Britania	GBR	0.649	0.727	CHE	11	0.893	CHE	13
SHBA	USA	0.756	0.847	CHE	2	0.893	CHE	13
Mesatarja		0,657	0.732			0.894		
Minimumi		0,457	0.605			0.723		

BURIMI: António Afonso & Mina Kazemi - 2016

Tabela 8
Rezultatet e përmbledhura të modeleve të ndryshme DEA

		Modeli 1	Modeli 2	Modeli 3	Modeli 4	Modeli 5	Modeli 6
Inputet		Shpenzimet totale publike	Shpenzimet totale publike	Konsumi Qeveritar	Shpenzimet e Arsimit	Shpenzimet e Shëndetësisë	Investimet Publike
Outputet		PSP	PSP e Mundësisë PSP Musgraviane	PSP e Administratës	PSP e Arsimit	PSP e Shëndetësisë	PSP e Infrastrukturës
Vende në kufi		CHE	CHE	CHE	FIN, JPN, LUX, NLD	IRL, JPN, LUX, CHE	DEU, CHE
Rezultatet mesatare	Inputi	0.732	0.732	0.56	0.812	0.839	0.673
	Outputi	0.769	0.894	0.808	0.933	0.992	0.876
Rezultatet minimale	Inputi	0.605	0.605	0.422	0.586	0.684	0.493
	Outputi	0.431	0.723	0.492	0.854	0.972	0.644
Gjithësej vende		20	20	20	20	20	20
Vendet efiçente		1	1	1	4	4	2

BURIMI: António Afonso & Mina Kazemi - 2016